


Matematika 1

Libër mësuesi

Përshtatur nga: Zenepe Shkoza
Diana Starja



BOTIMET "DITA PRINT"

**Përshtatën: Prof. As. Dr. Zenepe Shkoza
Msc. Diana Starja**

**LIBRI I MËSUESIT
MATEMATIKA**

1

Për klasën e 1-rë të arsimit fillor

Tiranë 2015

Matematika 1 - Libri i Mësuesit, është publikuar në origjinal në anglisht në vitin 2010. Ky botim publikohet në marrëveshje me Oxford University Press.

Nelson International Mathematics Teachers Guide 1 was originally published in English in 2013. This translation is published by arrangement with Oxford University Press.

Nelson International Mathematics Teachers Guide 1
© Nelson Thornes 2010

© i botimit në shqip Dita Print
Përshtatën: Msc Diana Starja
Prof.As.Dr Zenepe Shkoza

Redaktore Shkencore: Prof.As.Dr Bederiana Shyti

Shtypur në shtypshkronjën "Dita Print"
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta" (pranë Fakultetit të Shkencave Sociale)
Fax/Tel: +355 4 22 73 745 Cel: 068 20 42 171
E-mail: ditaprint@hotmail.com

Tiranë 2015

PASQYRA E LËNDËS

Hyrje	5
Krahasimi i madhësive	9
Krahasimi i gjatësive	11
Krahasimi i trashësisë	13
Plot dhe bosh	16
Numërimi deri në 5	18
Zero	23
Trupat dhe figurat	25
Vetitë e numrit dhe formës	29
Më shumë se, më pak se	31
Numërimi deri në 10	34
Klasifikimi	38
Fletore Pune 1B. Numërimi dhe krahasimi i numrave, dhe hyrja tek mbledhja	40
Mbledhja dhe Zbritja	44
Numrat dyshifrorë dhe vendvlera	47
Matja e masës	52
Matja e kohës	55
Koha në orë	59
Matja e vëllimit	61
Njësitë jostandarde të masës	64
Numrat deri në 30	66
Libri i nxënësit 1C. Modelet dhe figurat	69

Klasifikimi	71
Vendndodhja, lëvizja dhe drejtimi	73
Numërimi dhe krahasimi i numrave deri në 30	75
Mbledhja dhe zbritja	77
Trupat dhe figurat	80
Paratë	82
Vendndodhja dhe lëvizja	84
Njësitë standarde të gjatësisë, masës dhe vëllimit	86
Koha	91
Zgjidhja e problemave dhe llogaritjet	92
Të dhënat	94

HYRJE

Ky Libër Mësuesi është formuluar për të mbështetur Matematikën 1A, 1B, 1C të botimeve **Dita Print**.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive – pasqyrimi i temës që nënvizon njohuritë që duhet të përvetësojë nxënësi në këtë temë.

- **Fjalori** - nënvizon fjalët kyçe që duhet të përdorni gjatë mësimdhënies. Përdorimi i terminologjisë së saktë dhe inkurajimi i nxënësve për të përdorur të njëjtën terminologji luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e mendimit të shëndoshë matematikor.
- **Mjetet** - një listë mjetesh që ju dhe nxënësit mund të përdorni gjatë aktiviteteve të sugjeruara.
- **Ide për mësimdhënien** janë të renditura tek ushtrimet praktike (sugjerime për aktivitete që i paraqesin temat në mënyrë të gjallë dhe përfshirëse përpara se nxënësit të marrin punën teorike ose me shkrim) dhe **Librit të nxënësit** (shënime që ju shpjegojnë Librin e nxënësit dhe sugjerime për punën në klasë dhe në grup). Këtu përfshihen edhe pyetje që do të bëhen, këshilla për të përforcuar mësimin dhe shembuj konkretë nga jeta e përditshme për t'i ndihmuar nxënësit të lidhin konceptet me përvojat e tyre.
- **Pyetje vlerësuese** – një listë pyetjesh standarde që ju ndihmojnë për të paraqitur temat, përfshirë edhe pyetje që sfidojnë nxënësit e shkëlqyer ose që u japin më shumë praktikë nxënësve jo aq të përqendruar. Ka pyetje të ndryshme: disa janë të përshtatshme për diskutim në klasë dhe disa për punë individuale me shkrim.
- **Keqkuptime dhe gabime të zakonshme** – ju sugjeron të përqendroheshi në pjesë që nxënësit hasin vështirësi, në mënyrë që të përgatishni paraprakisht materiale shtesë.

Nxënësit kanë nevojë për shumë praktikë për të mësuar Matematikën. Asnjë nuk mund të ofrojë të gjithë shembujt e nevojshëm; duhet të jeni të gjithë të ndërgjegjshëm për mundësitë e shumta që ofron bota reale që fëmijët të përftojë eksperiencë matematikore. Ju si mësues, jeni gjyqtari më i mirë për nevojat e

nxënësve. Kjo kolanë me tre libra, do të shërbejë si ndihmë për mësimet tuaja teksa ndihmoni nxënësit të përftojnë njohuri për një koncept të caktuar dhe për të identifikuar situata ku ata kanë nevojë për shembuj shtesë për të konsoliduar kuptimin e një koncepti.

Shenjat kryesore – Në libër do të shihni ikona që identifikojnë elementet kryesorë të silabusit të mbështetur nga një ushtrim i posaçëm ose nga një numër ushtrimesh.

Figurat, hapësira dhe masat

Numrat

Organizimi dhe përdorimi i të dhënave

Kini parasysh se silabusi identifikon zgjidhjen e problemeve si një element të veçantë. Gjithsesi, meqenëse zgjidhja e problemit shtrihet edhe në secilën prej tre elementeve të tjerë, zgjidhjen e problemit e kemi identifikuar si një prej llojeve të ndryshme të ushtrimeve që do t’i gjeni në librin e nxënësve.

Në Librin e Nxënësit dhe në Librin e Mësuesit do të shihni shenja të vogla pas disa prej ushtrimeve praktike të sugjeruara pas çdo teme. Këto shenja tregojnë një lloj të veçantë ushtrimi.



Kjo shenjë tregon ushtrime praktike që zhvillojnë arsyetimin matematikor nëpërmjet përdorimit të manipulimit. Manipulime të posaçme të përdorur në këtë nivel përfshijnë: bllloqet, zaret, numërorët, vizoret, sende që përdoren për masa jo standarde, për shembull: kapëse letrash apo libra për së gjati; shishe apo kuti, e kështu me radhë. Ndonjëherë ushtrimet praktike nuk përmbajnë manipulime, për shembull, ndonjëherë mund t’ju kërkojnë nxënësve të shqyrtojnë lëvizjet dhe veprimet e tyre.



Kjo shenjë tregon ushtrime që përfshijnë formimin, krijimin apo punën me dorë. Për shembull, nxënësit mund të presin figura gjeometrike, krijojnë me plastelinë trupa gjeometrikë, të presin figura simetrike e kështu me radhë.



Kjo shenjë tregon një ushtrim që përfshin diskutimin, debatin ose çdo ushtrim tjetër me gojë. Për shembull, nxënësit mund të flasnin se cilën metodë e shohin më të lehtë dhe më të shpejtë për të zgjidhur një problemë të veçantë. Mund ta shihni të njëjtën shenjë edhe për këndimin, duartrokitjen apo çdo lloj ushtrimi tjetër që zhvillon aftësitë dëgjuese.



Kjo ikonë tregon ushtrime që përfshijnë shkrimin dhe vizatimin. Për shembull, nxënësit mund të plotësojnë fjali ose pyetje.

Ushtrime para – numerike

Klasifikimi i objekteve në grupe

Elementi matematikor: Numri

Tema matematikore: Para – numri

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Nxënësi klasifikon objektet në grupe.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Nxënësit duhet të marrin dhe grupojnë një numër të përzgjedhur objektesh konkretë, në mënyrë që të zhvillojnë fjalorin që u duhet për të përshkruar vetitë cilësore të objekteve. Emërtojnë objektet, mësojnë ngjyrat dhe pohojnë vetitë e përbashkëta të objekteve, duke përfshirë formën, madhësinë dhe përbërjen. Nxënësit përdorin njohuritë e tyre duke bërë grupe, identifikuar elementet e grupeve dhe duke përcaktuar nëse një objekt i përket një grupi apo jo. Më pas i kalojnë njohuritë e tyre nga veprimet konkrete tek pasqyrimi i grupeve në letër në forma nga më të ndryshmet.

Fjalor

Grupe, ngjyra, të mbyllura, komplet, figurë, i përket, i njëjtë, i madh, i gjatë, i shkurtër, i kuq, blu, i gjelbër, i verdhë.

Mjetet

Rruaza, kuba dhe shufra, kopsa, kunjja, numëror, lodra të vogla (kafshë, makina etj.), kartonë me ngjyra, kuti.

Ide për mësimdhënien

Filloni me objekte konkrete në mënyrë që fëmijët të zhvillojnë kuptim konceptual të shëndoshë se si të klasifikojnë objektet.

Ushtrime praktike

Jepuni nxënësve disa objekte. Lërin i t'i zgjedhin vetë objektet duke nxjerrë jashtë goglat, kopsat, kukullat e kështu me radhë. Bëjuni pyetje për të parë nëse nxënësit mund të pohojnë vetitë e përbashkëta të secilit grup dhe të përcaktojnë nëse një objekt i përket grupit ose jo.

Duke vijuar me grupet që kanë bërë, paraqitu zgjedhje të tjera dhe pyeti se në cilin grup përshtatet objekti. Për shembull: “kam një arushë lodër. Në cilin grup do ta vendosnit? Përse?”

Jepuni nxënësve disa gogla dhe një fije peri. U thoni t’i zgjedhin rruazat sipas ngjyrës. Duhet t’i vendosin të gjitha rruazat e kuqe në një fije, blutë në një tjetër, e kështu me radhë.

Jepuni fëmijëve një komplet kopsash dhe dy kuti për t’i vendosur. Kërkoju t’i vendosin të gjitha kopsat e mëdha në një kuti dhe të voglat në një kuti tjetër. Mos ua tregoni se cilat janë, por lërin ta përcaktojnë vetë në bazë të madhësisë. Mund t’u kërkonin nxënësve shumë të vëmendshëm për ta përmirësuar grupimin dhe t’i përzgjedhin kopsat sipas dy cilësive: ngjyrës dhe madhësisë, ose madhësisë dhe numrit të vrimave.

Sillni disa fruta të ndryshme në klasë. Jepuni nxënësve nga një. Kërkoju të përshkruajnë frytin e vet. Kërkoju të flasin për ngjyrën e lëkurës, si duket, madhësinë e frytit dhe nëse duan apo jo ta hanë. Jepu pak kohë ta zgjidhin si t’i ndajnë frutat në grupe. Lërin nxënësit t’i tregojnë klasës se si i zgjedhën frutat.

Vijoni me ushtrime praktike, konkrete derisa të jeni të sigurt që nxënësit janë në gjendje ta veçojnë një grup bazuar mbi një cilësi; të bëjnë koleksione bazuar në dy cilësi dhe të ribëjnë koleksione sipas cilësive të tyre. Kontrolloni nëse nxënësit mund të gjejnë vetitë e përbashkëta të sendeve në një grup dhe nëse mund të përcaktojnë nëse një objekt i përket një grupi apo jo.

Pyetje vlerësuese

- Të çfarë ngjyre/forme/madhësie janë objektet në këtë grup?
- Përse e keni vendosur këtë objekt në atë grup?
- Çfarë është «e njëjtë» për këto objekte në grup?
- Si mund t’i gruponi ndryshe këto objekte?
- A është ky objekt i përshtatshëm për këtë grup? Përse, ose përse jo?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Nxënësit mund ta kenë të vështirë të vendosin në të njëjtin grup objekte me nuanca të ndryshme të së njëjtës ngjyre. Nëse e bëjnë këtë, harxhoni pak kohë duke ndarë objekte me ngjyra të ndryshme në grupe të ngjyrave. Për shembull, gjej çdo gjë blu në klasë. Pyesni: “Sa nuanca të blusë mund të gjejmë?”

Nxënësit mund ta kenë të vështirë të dallojnë dy cilësi në një koleksion. Ju mund ta zgjidhni këtë në kohën e duhur duke i ndarë objektet sipas dy cilësive. Për shembull, fusni në një kuti të gjitha kopsat e mëdha blu. Flisni për pak kohë për faktin se këto kopsa janë edhe të mëdha, edhe blu.

KRAHASIMI I MADHËSIVE

Libri i nxënësit faqe 3

Elementi matematikor: Figurat, hapësira, masat

Temat matematikore: Masat

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Nxënësi krahason dy ose më shumë gjatësi, masa ose vëllime nëpërmjet krahasimit të drejtpërdrejtë.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Nxënësit fillojnë të zhvillojnë fjalorin e krahasimit (i madh, më i madh, i vogël, më i vogël).

Fjalor


I madh, më i madh, i vogël, më i vogël


Mjetet


Koleksione objektesh të mëdha dhe të vegjël, pipëza.

Ide për mësimdhënien

Ushtrime praktike

 Jepi nga një objekt secilit nxënës. Sigurohu që disa prej objekteve janë të mëdhenj, disa të vegjël. Për shembull: topa të mëdhenj, topa të vegjël; libra të mëdhenj, libra të vegjël; kuba të mëdhenj, kuba të vegjël; shkumësa të mëdhenj, shkumësa të vegjël. Jepu kohë nxënësve ta eksplorojnë objektin dhe të përcaktojnë nëse është i vogël apo i madh. U thoni t’i shkëmbejnë objektet, nëse e kishin të madh, ta marrin të madh; nëse e kishin të vogël, ta marrin të vogël. Më pas u thoni që ta shkëmbejnë atë objekt me një objekt të madhësisë së kundërt.

 Nxirri përpara dy nxënës: Njëri me objekt të vogël, tjetri me objekt të madh. Përdori për t’u mësuar termin “më i madh se...” dhe “më i vogël se...”. Nxënësit të praktikohen duke i përdorur këta terma në krahasimin e objekteve të tyre me të tjerë objekte në grupe.

 U thoni nxënësve të vizatojnë një objekt ose një figurë në fletoren e ushtrimeve. Më pas të vizatojnë një që është më e vogël se e para dhe një më të

madhe se e para. Më pas mund të vizatojnë një objekt që është i njëjtë me të parin dhe më pas një të ndryshëm me të parin.



Si ushtrim shtesë, mund t'i ngarkoni nxënësit të gjejnë pesë objekte të mëdhenj në klasë dhe më pas t'i vizatojnë. Më pas mund të gjejnë pesë objekte që janë më të vegjël dhe t'i vizatojnë edhe ato. Mund të shkëmbejnë fletoret dhe të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit si formë e vlerësimit në çift.

Ushtrimet në Librin e nxënësit

Thuaju nxënësve të plotësojnë faqen 2. Ata duhet të shohin tek secili prej çifteve të objekteve dhe të thonë se cili nga të dy është më i madh dhe cili më i vogël. Më pas vizatojnë një rreth përçark objektit më të madh në secilin çift.

Faqja 3 kërkon që nxënësit të vizatojnë figurat e tyre që janë më të vogla se ato që janë dhënë. Ju mund ta kufizoni numrin ose mund t'i lejonit të vënë aq figura të vogla sa i lejon hapësira. Kjo detyrë kërkon përqendrim të mirë dhe mund të marrë pak kohë.

Pyetje vlerësimi

- Cili objekt është më i madh/më e madhe?
- Cili objekt është më i vogël?
- Cili objekt është i madh dhe rrethor?
- Cili objekt është i gjatë dhe blu?
- Cili objekt është i lartë dhe i verdhë?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Disa nxënësve u duken të ngatërruara termat e madhësisë dhe termat krahasimorë. Është e rëndësishme të filloni me terma të thjeshtë, si “i madh” dhe “i vogël” përpara se të shkoni tek krahasimi. Është e rëndësishme të filloni me objekte që janë dukshëm të ndryshëm në madhësi.

Në këtë nivel mund të shihni që disa nxënës kanë arsytim konceptual të përcaktuar qartë dhe të sofistikuar, ndërsa të tjerët jo. Ndoshta do t'ju duhet të përshtatni ushtrimet për të sfiduar nxënësit e vëmendshëm. Për nxënësit që e kanë të vështirë me këto, është mirë të shpenzoni më shumë kohë në nivelin konkret. Lërimi të marrin objekte të mëdhenj dhe të vegjël dhe flisni me ta.

Disa nxënës e kanë të vështirë ta konceptojnë relativitetin e gjatësisë dhe do ta kenë të vështirë të përcaktojnë se çfarë është i gjatë e çfarë i shkurtër pa ndonjë send krahasimi. Për këtë arsye, është e rëndësishme të filloni me dy objekte qartësisht të ndryshëm në gjatësi, në mënyrë që t'ua mësoni termin.

Fëmijët mund ta kenë të vështirë edhe renditjen e gjatësive të ngjashme. Bëni shumë praktikë me pipëza dhe kërkoju të thonë me fjalë se çfarë po bëjnë. Për shembull: “Ky është më i shkurtri, ky është më i gjati”. Ose: “Ky është i shkurtër, ky është më i shkurtër, ky është më i shkurtër”.

KRAHASIMI I GJATËSIVE

Libri i nxënësit faqe 4

Elementi matematikor: Figurat, hapësira dhe masat

Temat matematikore: Masat

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Krahasoni dy ose më shumë gjatësi, masa ose vëllime me krahasim të drejtpërdrejtë.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Nxënësit në këtë pjesë do të zhvillojnë fjalorin e termave krahasimorë (i gjatë, i shkurtër etj).

Fjalor


I gjatë, më i gjatë, i shkurtër, më i shkurtër.

Mjetet


Shkopinj të gjatë dhe të shkurtër; pipëza të ndara në të gjata dhe të shkurtra.


Ide për mësimdhënien

Ushtrime praktike


 “I/e gjatë” dhe “i/e shkurtër” mund të mësohet pak a shumë në të njëjtën mënyrë si të kundërtat e tjera, si “i/e madh” dhe “i/e vogël”. Është e rëndësishme t’u shpjegoni nxënësve të kuptojnë se gjërat mund të jenë njëkohësisht edhe të mëdha dhe të shkurtra, edhe të gjata dhe të vogla. Është e rëndësishme gjithashtu ta veçoni konceptin matjet lineare, duke krahasuar sende të ngjashme. Për shembull, shkop të gjatë dhe të shkurtër ose vizore, në vend të një fustani të gjatë me një laps të shkurtër. Koncepti “i lartë” është po ashtu i rëndësishëm për

të kuptuar gjatësinë dhe lartësinë. Nxënësit duhet ta kuptojnë se lartësia është gjatësi e matur nga lart poshtë. Nxënësit nuk pritet që të masin formalisht që tani, por pritet të vlerësojnë me sy në mënyrë që të krahasojnë dhe rendisin gjatësitë.

 Mësoju në klasë fjalën “i/e shkurtër” dhe “i/e gjatë”. Këtë mund ta bëni duke përdorur një shkop të gjatë dhe një shkop të shkurtër, ose dy objekte të tjerë të çfarëdoqshëm që janë të ndryshëm në gjatësi. Shpjego se ne flasim për njerëzit e shkurtër, por themi njeri “i gjatë” jo njeri “i lartë”. Kërkoju nxënësve të vendosen në rresht nga më i shkurtri tek më i gjati. Le të gjejnë vetë se cili është më i shkurtri dhe cili më i gjati. Mos ndërhyini derisa e shihni se nuk ja dalin dot. Kur të jenë vendosur në rresht, kërkoji secilit të thotë: “jam më i shkurtër se ..., jam më i gjatë se ...”. Paraqisni termat i shkurtër dhe i gjatë duke përdorur nxënësit në rresht.

 Jepi secilit nxënës nga një pipëz (disave të gjata, disave të shkurtra). Ndajini nxënësit në grupe me nga tre dhe kërkojuni të vendosin pipëzat në rresht, nga më e shkurtra tek më e gjata. Kërkoji secilit nxënës të marrë lapsin. Le të gjejnë tre sende në klasë që janë më të shkurtër se lapsi. Këto mund t’i vizatojnë në fletoren e ushtrimeve. Përsëriteni me nxënësit duke u kërkuar të gjejnë sende po aq të gjatë sa lapsi dhe më të gjatë se lapsi.

Ushtrime me Librin e nxënësit

 Përsërisni fjalën “më i/e shkurt” dhe “më i/e gjatë” përpara se t’u kërkonit nxënësve të plotësojnë faqet 4 . Lërinë të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Pyetje vlerësuese

- Cili objekt është më i shkurtër?
- Cili objekt është po aq i shkurtër?
- Cili objekt është më i gjatë?
- Cili është më i lartë?
- Çfarë është gjëja më e lartë në shkollën tonë?
- Çfarë është gjëja më e shkurtër e shkollës sonë?
- Çfarë është gjëja më e gjatë në shkollën tonë?

KRAHASIMI I TRASHËSISË

Libri i nxënësit faqe 5- 6

Elementi matematikor: Figurat, hapësira dhe masat

Temat matematikore: Masat

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të krahasojmë dy ose më shumë gjatësi, masa apo vëllime me anë të krahasimit të drejtpërdrejtë.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Konceptet e i/e gjerë dhe i/e ngushtë, ose i/e hollë dhe i/e trashë mund të mësohen në të njëjtën mënyrë si të kundërtat e mëparshme. Fëmijët në thelb po merren ende me konceptin e masës lineare, por duhet të zhvillojnë fjalorin që të flasin për aspekte të ndryshme të saj. Trashësia duhet të jetë term i njohur për ta; gjerësia është disi më e vështirë të rrokët, veçanërisht sepse ndryshon.

Fjalor


I/e trashë, më i/e trashë; i/e hollë, më i/e hollë; i/e gjerë, më i/e gjerë; i/e gjerë, i/e ngushtë; më i/e ngushtë, më i/e ngushta.


Mjetet


Kuba formues, kuti, cilindra, kartonë të ndryshëm, ngjitës, fleta me tabelë, copë për lidhjen e syve, katërkëndësha të prerë me të njëjtën gjatësi, por me gjerësi të ndryshme, enë mbajtëse të larta dhe të ngushta, kovë dhe letër tualeti, brumë loje ose plastelinë e shtypur në copa të trasha dhe të holla, sende me trashësi të ndryshme, si për shembull: libra, shkumësa dhe lapsa.


Ide për mësimdhënien


Ushtrime praktike

 Tregoju nxënësve një kallëp druri të trashë dhe një të hollë. Trego me gisht se cili është njëri dhe cili tjetri. Bëni një diskutim mbi gjërat e trasha dhe gjërat e holla. Ndajeni klasën në çifte. Jepi secilit çift një kallëp të trashë, një të hollë dhe një lidhëse të syve. Ta vendosin me radhë lidhësen e syve dhe të përpiqen të dallojnë kallëpin e trashë dhe atë të hollë.

 Përdorni një gamë artikujsh. Filloni me çiftet me kallëpe. Pyesni nxënësit të thonë se cili është më i trashë në secilin çift. Përsëriteni disa herë për të mësuar fjalën “më i trashë”. Bëni të njëjtën gjë për më i hollë. Më pas vendosni tre ose katër kallëpe në tavolinën tuaj. Thirr nxënës të ndryshëm të thonë se cili është më i hollë dhe cili më i trashë. Përsëriteni derisa të jeni të sigurt se nxënësit i kuptojnë termat “më i/e trashë” dhe “më i/e hollë”.


 Jepu të gjithë nxënësve një numër objektesh të trashë dhe të hollë, ngjitëse, fije, shirit ngjitës dhe materiale të tjera ndërtimore. Lërimi të ndërtojnë një kështjellë me objekte të trashë dhe të hollë. Kështjella nuk duhet të rrëzohet.

 Kërkojuni të gjejnë një numër objektesh të trashë dhe të hollë në klasë dhe t’i sistemojnë sipas radhës nga më i trashë tek më i hollë.

 Vizatoni në dërrasë një kuti të ndarë me katërkëndësha si kjo këtu:

--	--	--	--	--

Pyesni nxënësit të thonë se si ndryshojnë figurat. Mësojuni fjalët “i/e gjerë” dhe “i/e ngushtë” duke përdorur terma më familjarë, si “ i/e trashë” dhe “i/e hollë”. Shkruani fjalët në tabelë për të përforcuar fjalorin. Kërkoju nxënësve t’i klasifikojnë figurat në dy grupe: të gjera dhe të ngushta. Ata do të duhet të përcaktojnë se si ta bëjnë këtë dhe kjo do t’i ndihmojë të kuptojnë se termat përdoren për krahasim. Pasi t’i keni grupuar, kërkoju nxënësve t’i sistemojnë në radhë, nga më e ngushta tek më e gjera.

 Tregojuni fëmijëve grykën e një kove dhe një rulon letre tualeti. Diskutoni se cili është më i gjerë dhe cili më i ngushtë. Shpjegoju se kova është e gjerë sepse ka hapje të madhe dhe se ruloni i letres është i ngushtë sepse ka hapje të

vogël. Diskutoni për sende të tjera që janë të gjera dhe të ngushta dhe vizatoni disa prej tyre.



Bëni disa lojëra me lëvizje në oborrin e shkollës. U thuaj nxënësve të bëjnë një rreth të gjerë. Pastaj thuaju ta bëjnë të ngushtë. Shihni se sa gjerë mund t'i shtrijnë krahët ose këmbët dhe sa ngushtë mund t'i bëjnë, e kështu me radhë.



Përdorni brumë lojërash ose plastelinë për të demonstruar termin “i/e trashë” dhe “i/e hollë” dhe se si diçka mund ta ndryshojmë nga “i/e trashë” në “i/e hollë”. Për shembull, mund të tregoni një copë plastelinë të trashë dhe një të hollë. Pyesni nxënësit se cila është më e trashë. Më pas shtype dhe bëje më të hollë dhe pyesni se cila tashmë është më e trashë. Gjithashtu, mund të tregoni edhe çifte artikujsh që mund të krahasohen duke përdorur këta terma (si libra të trashësisë së ndryshme: shkumësa, lapsa, të trashësisë së ndryshme, e kështu me radhë).



Shpjegoni se ne zakonisht përdorim “i gjerë” dhe “i ngushtë” për të përshkruar hyrjet, si: hapësirën e derës, kalimin, tubat, qafën e shishes etj. Kërkojuni nxënësve të mendojnë për shembuj të tjerë në shkollë dhe pyetini se çfarë është më i ngushtë dhe çfarë më i gjerë.

Ushtrime me Librin e nxënësit



Përsërisni fjalët: “i/e trashë”, “i/e hollë”, “i/e gjerë”, “i/e ngushtë”. Nxënësit të plotësojnë vetë faqen 5 dhe 6. Vëzhgoji ndërsa punojnë që të sigurohesh se po qarkojnë objektet më të hollë.



Shpjegoni po ashtu udhëzimet dhe më pas vendosini të plotësojnë faqen 6.

Pyetje vlerësimi

- Çfarë është më i/e gjerë?
- Çfarë është më i/e ngushtë?
- Çfarë është më i/e trashë?
- Çfarë është më i/e hollë?
- Thoni tre objekte të hollë? Thoni tre objekte të trashë?
- Nga këta të tre, cili është më i gjeri?
- Gjeneri objektin më të gjerë në këtë grup.
- Cili është më i gjerë, korridori i shkollës apo dhoma e tualetit? Një rrëshqitëse lodër, apo një trotuar? Ndenjësja e biçikletës apo karrigia e shkollës? etj.

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Nxënësit mund ta kenë të vështirë që të kapin relativitetin e termave. Për shembull, katërkëndëshi më i gjerë i grupit të katërkëndëshave të ngushtë, është prapë më i ngushtë se më i ngushti i katërkëndëshave të gjerë. Kjo mospërputhje në dukje mund t'i fusë nxënësit në vështirësi dhe nuk duhet pritur që nxënësit t'ia dalin me përdorimin e këtyre termave menjëherë. Gjithsesi, është shumë e rëndësishme që t'i vetëdijesoni për fjalorin në mënyrë që të fitojnë siguri duke e përdorur gjatë kohës dhe në mënyra të ndryshme.

PLOT DHE BOSH

Libri i nxënësit faqe 7

Elementi matematikor: Figurat, hapësira dhe masat

Temat matematikore: Masat

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të krahasojmë dy ose më shumë gjatësi, masa ose vëllime nëpërmjet krahasimit të drejtpërdrejtë.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Në mënyrë që të zhvillojnë konceptin e vëllimit, nxënësit duhet të kuptojnë termat “plot” dhe “bosh”. Ata duhet të jenë në gjendje të krahasojnë sasi të mbahen në një enë për të zhvilluar konceptin që ena mund të jetë plot, bosh dhe në shumë gjendje ndërmjet tyre. Duhet të siguroheni se nxënësit kanë përvojë të mbushjes dhe derdhjes. Përdorni lloje të ndryshme enësh dhe lejoni nxënësit të mbushin dhe derdhin apo t'i kalojnë tek njëra-tjetra. Kjo është e rëndësishme sepse mund të ndihmojë nxënësit për të zhvilluar konceptin e ruajtjes së masës kur derdhin një lëndë nga një enë e ngushtë dhe e lartë në një enë të thellë dhe të gjerë, sepse shohin ndryshimin, por e kuptojnë se nxë të njëjtën sasi.

Fjalor


Plot, bosh, ca, më shumë, më pak, enë, nxë, mbush, derdh, sasi.


Mjetet


Enë plastike dhe kanaçe të madhësive të ndryshme, ujë ose kripë, gjashtë shishe ose gota.

Ide për mësimdhënie

Ushtrime praktike

 Tregojtu nxënësve një enë plot dhe një enë bosh. I pyesni se cila është plot e cila bosh. Emërtoji dy enët “plot” dhe “bosh”. Bëni një tabelë për “plot” dhe “bosh”.

 Ndani klasën në grupe të vegjël. Jepi secilit nxënës një enë. Kërkoju të fusin ujë ose rërë në enët e tyre. Një nxënës duhet të ketë një enë plot, njëri duhet ta ketë bosh, të tjerët duhet të kenë enë që janë të mbushura në shkallë të ndryshme. Pasi ta keni bërë këtë, u thoni që t’i rendisin enët nga ai bosh tek ai plot.

 Nxirrni një grup me 6 shishe ose gota. Hidhni të njëjtën sasi uji ose rërë në të tre çiftet, por përziejini me njëri–tjetrin. Kërkoju nxënësve të vendosin enët me të njëjtën sasi pas njëri–tjetrit. Diskutoni që të tjerët nxënë më pak ose më shumë se grupi në mes.

Ushtrime me Librin e nxënësit



Nxënësit ta plotësojnë vetë faqen 7.

Pyetje vlerësimi

- Cila enë është plot?
- Cila enë është bosh?
- Cila enë nxë më shumë?
- Cila enë ka më shumë ujë?
- Cila enë ka më pak ujë?
- Cilat enë kanë të njëjtën sasi?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Nxënësit me përqendrim më të ulët mund ta kenë të vështirë ta kuptojnë se një enë e ngushtë e lartë nxë të njëjtën sasi uji sa një enë e thellë e gjerë. Do të duhet t’u jepni shumë përvojë praktike që të mund të zhvillojnë konceptin e tyre për ruajtjen e masës.

NUMËRIMI DERI NË 5

Libri i nxënësit faqe 13

Elementi matematikor: Numri

Temat matematikore: Numrat dhe sistemi i numrave

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të numërojmë, lexojmë dhe shkruajmë numrat deri në 20.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Shumë nxënës janë në gjendje të numërojnë në mënyrë mekanike. Kjo nuk do të thotë se ata e kuptojnë se çfarë po numërojnë. Është e rëndësishme që kur nxënësit thonë “një”, të kuptojnë një objekt, kur të thonë “dy” të kuptojnë dy objekte, e kështu me radhë. Kjo njohuri e numrit kërkon lidhjen e gjërave me sasinë. Nxënësve u duhet dhënë mundësia t’i numërojnë gjërat në ambientin e vet, përfshirë edhe pjesët e trupit të tyre. Gishtat janë në veçanti të dobishëm për të numëruar.

Nxënësit duhet të jenë në gjendje të njohin dhe shkruajnë numrat 1, 2, 3, 4, 5 dhe t’i lidhin në mënyrë të saktë me emrin e numrit dhe me grupin. Ata duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë grupe objektësh, duke lidhur emrat e numrave një, dy, tre, katër, pesë me grupet, dhe të formojnë grupe nga një deri me pesë objekte.

Shkrimi i numrave kërkon që të mësohet me kujdes – nxënësit duhet të dinë se ku të fillojnë kur shkruajnë numrat dhe se si të shkruajnë secilin prej tyre. Ka metoda nga më të ndryshmet për të mësuar këtë. Disa ide që mund t’ju duken të dobishme janë:

- shkrimi i numrave në ajër, rërë ose me bojë;
- përdorimi i një gishti për të ndjekur një numër të madh;
- përdorimi i letrës së kalkut për të kopjuar, ndjekur numrin;
- plotësimi i tabelave me variante të numrave me pikë;
- kopjimi i vargjeve numerikë;
- ndërtimi i modeleve me numra.

Fjalor


Një, dy, tre, katër, pesë, numëro, një më shumë, numri


Mjetet


Një varg numrash me numra nga 1 në 5; kartonë me fjalët një, dy, tre, katër, pesë; gurë, tapa shishesh; kuti vezësh; objekte te ndryshme.


Ide për mësimdhënie


Ushtrime praktike


 Ngri gjithë klasën të qëndrojë në fund të dhomës. Kërkoju të vijnë përpara një nga një teksa i numëron kur vijnë. Vendosi në grupe me nga pesë përpara klasës. Sa herë që mbërrin tek pesë, fillo nga njëshi. Kërkoju anëtarëve të secilit grup të numërojnë veten teksa ulen.


 Kërkoju nxënësve të hapin gishtat e dorës dhe të numërojnë bashkë me ju. Sa herë që ju thoni një numër, ata duhet të ngrenë një gisht. Tundni kokën kur arrini tek pesa. Përsëriteni këtë duke treguar numrat në vargun numerik. Më pas, tregojuni numrat, por mos i thoni ato – kërkoju të ngrenë gishtat në përputhje me atë që ju keni treguar. Bëjeni këtë për disa herë.

 Përdorni vargun numerik. Tregoni njërin prej numrave. Ngrini një nxënës dhe kërkoji që të përplasë duart aq herë. Pjesa tjetër e klasës duhet të numërojë përplasjen e duarve për të parë nëse është i saktë apo jo. Përsëriteni disa herë duke përdorur numra të tjerë.

 Zgjidhni një numër fillestar. Ngrini një nxënës të duartrokasë aq herë sa numri. Pyesni klasën se cili është numri i radhës dhe tregojeni me dorë. E gjithë klasa të duartrokasë aq herë. Përsëriteni duke i përdorur të gjithë numrat si pika nisjeje. Pastaj bëjeni sërish në radhë, nga numri një tek pesa.

 Mësoni nxënësit të shkruajnë numrin 1, duke përdorur secilën ose të gjitha teknikat e përshkruara më lart.

 Përforconi konceptin e numrit një duke u kërkuar nxënësve të vizatojnë objekte të vetme. Për shembull: vizatoni një lule, shkruani sa janë. Ju mund t'i vendosni të ngjyrosin objekte të vetme brenda një grupi objektesh. Për shembull, në një grup me pesë kopsa, i udhëzoni të ngjyrosin një të kuqe, një blu, një të verdhë dhe një të gjelbër.

 Vendosini të punojnë në çift. Jepi secilit çift nga një grumbull gurësh . Thuaju që të marrin në fillim nga një secili dhe më pas t'i grupojnë për t'i bërë 2. Lëri ta përsërisin këtë derisa t'i kenë përdorur të gjithë gurët.



Përgatitni disa fletë pune të lidhura me pjesët e trupit të njeriut, për shembull, një fytyrë pa elementët e saj. Udhëzoni nxënësit të vizatojnë një gojë, një hundë, dy sy, dy vetulla, dy veshë, dy vëthë etj. Përsëriteni këtë me kokë kafshësh, me tërë trupin dhe me fletë të tjera pune derisa të jeni të sigurt se nxënësit e kuptojnë dualitetin e një grupi.



Jepi secilit grup nga një kuti vezësh boshe me nga 12 ndarje dhe një tufë gurësh ose tapa shishesh. Lërimi të punojnë në çifte për të vendosur dy gurë ose tapa shishesh në secilën ndarje.

Mësoji klasës të shkruajë numrin 2 duke përdorur ndonjërin ose të gjitha metodat e përshkruara më lart. Merrni kohë për ta praktikuar këtë në mënyrë sistematike për t'u siguruar që nxënësit mund ta formojnë saktë numrin.



Bëni rregullisht lojëra numërimi me klasën. Për shembull, vendosi nxënësit të ulen dhe numëroni bashkërisht deri në pesë. Kur të arrijnë tek pesa, duhet të bërtasin numrin pesë dhe të ngrihen të gjithë në këmbë. Këtë mund ta shtrini edhe tek numrat më të mëdhenj, si deri në dhjetë, në fazat e mëvonshme mësimore.



Bëni një grup kartonësh me numrat 1 dhe 2 në to. Shpërndajua nxënësve të ndryshëm. Lërimi të ecin nëpër klasë dhe të emërtojnë grupe sendesh me një dhe dy përbërës. Përforcoje këtë me ushtrime praktike, ku zgjidhin grupe me nga një dhe dy sende, dhe shkruajnë numrin e elementeve në secilin grup. Po ashtu, mund t'u kërkoni nxënësve që të ngjyrosin nga një element në grupe të ndryshëm, për shembull, në një grup me tetë pika; të ngjyrosin dy me të kuqe, dy me blu, dy me të verdhë dhe dy me të gjelbër.



Nxirr para klasës katër nxënës. Ndaji në dy grupe me nga dy. Nxirr edhe një nxënës dhe shpjegoju se do të shtojnë një në njërin prej grupeve. Shpjegoju se kanë dy në njërin grup dhe një më shumë në grupin tjetër. Pyesni klasën se sa është “një më shumë” se dy – këtë mund ta zgjidhin duke numëruar nëse është e nevojshme.



Kaloni pak kohë duke shpjeguar se tre është një më shumë se dy. Kërkojuni nxënësve të bëjnë grupe me nga dy dhe më pas me një më shumë; kërkoju të formojnë grupe me nga dy dhe më pas të shtojnë një pjesëtar dhe të thonë se sa kanë tanimë.



Mësojini klasës të shkruajë numrin 3, siç bëtë edhe me numrat e tjerë.



Kërkoju nxënësve të bëjnë grupe me nga tre etj. Të shkruajnë numrin e përbërësve të grupit, t’i ngjyrosin grupet me nga tre si më parë.

Përsërisni këtë procedurë me katrën dhe pesën, duke u mësuar një më shumë se numri paraardhës. Mësoju nxënësve të shkruajnë numrin dhe ta lidhin atë me numrin e elementëve në një grup.



Pasi t’i keni mësuar të shkruajnë numrin, sigurohuni se ata dinë të lidhin numrin me shumën dhe me emrin e numrit. Mund të bëni grupe kartonësh si vijon:

*	**	***	****	*****
një	dy	tre	katër	pesë
1	2	3	4	5

Hiqi ato, përzieji dhe kërkoju nxënësve t’i riorganizojnë për të formuar grupe që përputhen. Mund të bëni edhe fletë pune ku ju plotësoni vetëm pikat, numrat ose emrat dhe të tjerat i bëjnë nxënësit.



Përsërisni numrat me një gamë ushtrimesh. Për shembull, mund t’u kërkoni nxënësve të shikojnë duart dhe të numërojnë gishtat nga një në pesë. Mund të vizatojnë pesë pemë dhe të vendosin një numër të ndryshëm frutash në to. Shkruajnë numrin e frutave poshtë secilës pemë me numra dhe me fjalë.



Që t’u kërkosh nxënësve që të bëhen më kompetent, duhet të siguroheni se ata mund të punojnë me grupet e përzier dhe të njohin numrin e elementëve në secilin grup, qofshin të shpërndarë, të sistemuar apo të grumbulluar bashkë – ky koncept i konsolidimit të numrit është shumë i rëndësishëm. Mund të bëni lojëra të tilla, si për shembull, një ku nxënësit kapin gurë me shpejtësi dhe bëjnë një grumbull dhe ju më pas i pyesni se sa gurë kanë bërë.

Vazhdoni të punoni në mënyrë konkrete me nxënësit derisa të jeni të sigurt se janë në gjendje të numërojnë me radhë, që i njohin dhe mund t’i emërtojnë numrat nga 1 në 5, që i kuptojnë këta numra dhe se janë të vetëdijshëm për të veçuar nga një grumbull objektesh 1 deri në 5 objekte.

Ushtrime me Librin e nxënësit



Nxënësit të plotësojnë faqen 13. Sigurohuni që mund ta shkruajnë numrin 1 dhe ta lidhin me emrin e tij.



Kur të keni trajtuar numrin 2, kërkohu nxënësve të plotësojnë faqen 13.



Faqja 13 duhet të plotësohet pasi t'u keni shpjeguar numrin 3.



Faqja 13 duhet të plotësohet pasi t'u keni shpjeguar numrin 4.



Faqja 13 duhet të plotësohet pasi t'u keni shpjeguar numrin 5.



Përdorni faqen 13 për të verifikuar nëse nxënësit mund të numërojnë një grup me 5, ta shkruajnë numrin dhe të zgjedhin një grup me aq objekte.



Përdorni faqen 13 për të vlerësuar që nxënësit mund të numërojnë deri në 5 dhe t'i shkruajnë këta numra.

Pyetje vlerësimi

- Cili është ky numër (duke e treguar me dorë)?
- Sa po mbaj në dorë?
- Sa është një më shumë se ...?
- Thuaj numrin pasardhës.
- Cili numër vjen pas ...?
- Cili numër është përpara ...?
- Cili është emri i këtij numri?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Është e rëndësishme të siguroheni që nxënësit të zhvillojnë kuptimin e vlerës të secilit numër. Për këtë arsye, kur jeni duke shkruar numrin, duhet të shfaqni sasinë që përfaqëson secili numër, për shembull:

*	**	***	****	*****
një	dy	tre	katër	pesë
1	2	3	4	5

Disa nxënës e kanë të vështirë t'i shkruajnë numrat sepse në përdorim një goditje për të bërë numrin 1, dy për numrin 2, e kështu me radhë. Duhet t'u shpjegoni se numrat janë një mënyrë e shkurtër për të shkruar emrat e numrave, një kod nëse preferoni.

Orientimi i numrave është i vështirë për disa nxënës. Mund të kenë vështirësi për t'i shkruar në formën e duhur. Ndërgjegjësoji për këtë dhe ndihmoji t'i bëjnë në formën e duhur.

Vlerësim

Plotësoni ushtrimet praktike për të kontrolluar nëse nxënësit janë në gjendje të:

- Identifikojnë grupin me shumë objekte dhe të thonë se sa objekte ka.
- Shfaqin sensin e konservimit të numrit duke gjetur grupe me numër të njëjtë objektësh dhe të shkruajnë numrin gjegjës.
- Zgjedhin një grup me më pak objekte se grupi i dhënë dhe të shkruajnë numrin gjegjës dhe emrin e numrit.
- Shkruajnë në radhë numrat nga 1 në 5.
- Nëse nxënësit nuk janë në gjendje të bëjnë asnjërin nga këto, kaloni kohë me ta në grupe të vogla për të përsëritur konceptet dhe për të zhvilluar njohuritë e domosdoshme.

ZERO

Libri i nxënësit faqe 15

Elementi matematikor: Numri

Temat matematikore: Numrat dhe sistemi i numrave

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të numërojmë, lexojmë dhe shkruajmë numrat deri në 20.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Koncepti i zeros prezantohet në këtë kapitull nëpërmjet zbritjes informale. Kini parasysh se zbritja nuk trajtohet këtu, por do të paraqitet më vonë. Prandaj zero përforcohet në vendndodhje në sistemin e numrave dhe numrat nga 1 në 5 përforcohen me zero.

Fjalor


Zero, asgjë, asnjëri, mbetur.


Mjetet


Numëror, ëmbëlsira, pesë objekte, si për shembull: fruta, blloqe formues, lapsa.


Ide për mësimdhënie


Ushtrime praktike


 Ndani klasën në grupe. Jepi secilit grup numrin e saktë të ëmbëlsirave, kështu që të gjithë nxënësit kanë nga një. Kërkoju nxënësve t'i ndajnë që të gjithë të kenë nga një. I pyesni se sa ëmbëlsira kanë mbetur. Prisni përgjigje si “asnjë”. Mësojuni fjalën zero. Shpjegojuni që, në Matematikë e përdorim fjalën **zero** për të treguar se nuk ka mbetur **asnjë**.

 Përsërisni ushtrimin me ndarje duke përdorur numërorët, por ndryshoje ushtrimin kur në disa raste të mos mbesë asnjë tepër dhe në disa të mbesë diçka. Gjithashtu, mund ta ndryshoni për aq sa do të marrin disa nxënës, në mënyrë që të përforconi konceptet e numrave nga 1 në 5.

 Mësojuni nxënësve të shkruajnë numrin 0 duke përdorur ushtrime të ngjashme me ato të përshkruara në faqe 15. Sigurohuni që mund të shkruajnë numrin 0 dhe fjalën zero.

 Vendosni në tavolinë grupe objektesh. Ngriji nxënësi dhe kërkoju të shkruajnë numrin e objekteve dhe të thonë emrin e numrit.

 Përsërisni disa nga ushtrimet praktike të mësimëve të mëparshme mbi ndërtimin e grupeve të numrave me një më shumë ose një më pak, për të përforcuar konceptin e numrit dhe për të përfshirë punën me zeron. Përsëriteni derisa të jeni të sigurt se nxënësit e kanë përvetësuar mësimin e zeros.

 Praktikojini duke numëruar deri në pesë, por duke filluar nga zeroja, jo nga një. Përdorni grupe të ndryshme me nga pesë objekte (pese fruta, pesë blloqe, pesë numërorë, pesë lapsa etj).

Ushtrime me Librin e nxënësit

Nxënësit ta plotësojnë vetë faqen 15. Vëzhgojini ndërsa punojnë për të qenë të sigurt se arrijnë ta bëjnë. Lejojini të përdorin numërorët për të formuar grupet.

Pyetje vlerësimi

- Sa kanë mbetur?
- Çfarë numri është ky?
- Sa po mbaj në dorë?
- Sa është një më shumë se ...?
- Sa është një më pak se ...?

- Thuaj numrin pasues.
- Çfarë numri vjen pas këtij ...?
- Çfarë numri është përpara këtij...?
- Si quhet ky numër ...?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Zero mund të jetë koncept i vështirë për nxënësit. Mund të paraqitet më mirë në një situatë të tillë, si për shembull, kur kemi dy ëmbëlsira, i kemi ngrënë të dyja dhe nuk mbetet “asnjë” ose “asgjë”. Kjo është më e kuptueshme dhe do t’i lejojë ta zhvillojnë konceptin e grupit bosh që nuk përmban asnjë element ose 0.

TRUPAT DHE FIGURAT

Libri i nxënësit faqe 21 – 22

Elementi matematikor: Forma, hapësira dhe masat

Temat matematikore: Elementët dhe vetitë e figurave

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Përdorni gjuhën e përditshme për të përshkruar karakteristikat e trupave gjeometrikë dhe figurave gjeometrike, si faqet, këndet dhe brinjët.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Nxënësit mund të luajnë me trupat në mënyrë që të njihen me karakteristikat e tyre. Objektivi që nxënësit të jenë në gjendje t’i dallojnë trupat kryesor - kubat, kuboidët, konet, cilindrat dhe sferat - në kuptimin e vetive gjeometrike të madhësisë dhe formës. Gjithashtu mësojnë të njohin faqet dhe brinjët e trupave; këndet dhe brinjët e figurave. Mbani parasysh se nuk është e nevojshme që ata të mbajnë mend emrat e saktë gjeometrikë të këtyre formave. Nxënësit mund t’i referohen ende sferave, si topa dhe kuboidëve si kuba dhe kuti.

Si fillim, do të vijojnë me aftësitë kategorizuese para – numerore për të krahasuar dhe klasifikuar trupat. Në fillim, ky klasifikim me gjasë do të bëhet mbështetur në një cilësi të trupave, madhësinë ose formën. Gjithsesi, me kalimin e kohës, do t’i klasifikojnë duke përdorur kriteret e veta dhe duke përdorur cilësi të dyfishta (formën dhe madhësinë). Më pas mësojnë se trupat gjeometrikë përbëhen nga

faqet që janë në vetvete figura. Qëllimi është të jenë të aftë të dallojnë figurat e njohura dhe të eksplorojnë vetitë e tyre (në këtë fazë nuk është e domosdoshme të njohin emrat e katrorëve, katërkëndëshave, trekëndëshave). Ata do të mësojnë edhe se si figurat mund të vendosen bashkë dhe të formojnë figura dhe imazhe të tjera.

Nxënësit do të përftojnë më shumë njohuri mbi trupat gjeometrikë teksa zhvillojnë njohuritë për figurat dhe faqet.

Fjalor

I/e rrafshët, rrumbullak, rrotulloj, e shënjuar, i/e vogël, më i/e vogël, i/e madhe, më i/e madhe, i/e hollë, më i/e hollë, i/e trashë, më i/e trashë, në krye, në fund, prapa, njësoj, i ndryshëm, njësoj si, faqe, brinjë, kënd.

Mjetet

Gogla, kuti, cilindra, kon, kartonë me imazhe të trupave gjeometrikë, materiale të tepërta dhe enë mbajtëse për të krijuar modele, plastelinë për të bërë forma, kartonë me imazhe të figurave gjeometrike, forma të prera rrathësh, trekëndëshash, katrorësh, katërkëndëshash, koleksione me objekte të mëdhenj dhe të vegjël, trupa gjeometrikë për secilin grup, prerje figurash; prerje të figurave plan, kartonë me emrat e figurave plan, materiale ngjitës për krijimin e formave.

Ide për mësimdhënie

Ushtrime praktike




Jepi secilit grup një numër goglash, kutish, konesh dhe piramidash. Lërimi nxënësit t'i klasifikojnë ato në grupe të ndryshme dhe bisedoni me ta se çfarë mund të bëjmë me objektet, si për shembull: mund t'i rrotullojmë, hedhim, ngjisim, t'i vendosim sipër njëri-tjetrit etj.





Jepi secilit nxënës pak plastelinë. Mbani në dorë një sferë. Pyeti nëse është e sheshtë apo e rrumbullakët. Nëse është e nevojshme, shpjegojua fjalët. Lërimi të përshkruajnë sferën dhe më pas ta formojnë duke përdorur plastelinën. Përsëriteni për trupat e tjerë. Kur të kenë bërë të gjithë trupat, kërkojuni të bëjnë një kullë duke i vendosur në atë formë që nuk bien.





Tregoji klasës në kartonë një numër objektesh të njohur, për shembull, një kon akulllojeje. Lërimi të zgjedhin një prej figurave të tyre që t'i përputhet objektit. Përsëriteni këtë për sende të ndryshme.


 Formoni diçka nga materialet e mbetura të paketimit. Roboti në figurën poshtë është një shembull i mirë. Pyesni nxënësit se çfarë figurash ose trupash janë përdorur për ta bërë. Nuk është e domosdoshme që të përdorin emrat formal të trupave në këtë fazë, pavarësisht se disa nxënës mund t’i dinë.


 Bëj një shfaqje të madhe dhe të vogël me klasën. Vizato një rreth të madh dhe një të vogël në një tabelë. Tregoni rrethin e madh dhe shpjego fjalën “i madh”. Përsëriteni për fjalën “i vogël”. Vendosni nxënësit të gjejnë shembuj të objekteve të lehtë për t’i gjetur që janë të mëdhenj dhe të vegjël dhe t’i vendosin në rrethin përkatës. Nëse dëshironi, vendosni në krye të secilit rreth fjalën i madh dhe i vogël.


 Jepi secilit grup një sasi materialesh të mbetur paketimi dhe lejojini të krijojnë format e veta. Nëse roboti është i vështirë, kërkojuni të bëjnë shtëpi duke përdorur forma gjeometrike.

 Kapni një prej trupave, për shembull, një sferë. Kërkoju nxënësve të gjejnë një trup tjetër si ai që po mbani në dorë. Mund ta bëjnë duke i identifikuar ato fizikisht ose nëpërmjet fotografive. Kërkoju më pas të gjejnë trupa të ndryshëm nga ai që po mban në dorë. Lëri të shpjegojnë se përse është i ndryshëm, për shembull: ky top është më i madh se ai tjetri, sepse është më i madh (madhësia); kjo kuti është e ndryshme nga ai top, sepse ka formë të ndryshme (forma); ky top ka të njëjtën formë dhe madhësi, por ka ngjyrë të ndryshme (veti).

 Tregoni se si, duke parë përreth një trupi gjeometrik, përftoni forma të ndryshme. Për shembull, duke parë përreth një kutie do të përftojme një katror, duke parë përreth një topi do të përftojme një rreth etj. Vizatoni figurat e sheshta që rezultojnë dhe shkruani emrat e tyre për krahu objekteve. Kërkojuni nxënësve të përsërisin emrat. Mos shtrëngoni nxënësit për emrat në këtë fazë.

 Jepi secilit nxënësi një kuti. Kërkoju të shohin përreth fundit dhe ta presin. Kërkoju të vizatojnë një faqe të pjesës së prerë. Më pas kërkoju që ta ngjisin faqen me ngjitës sërish në kutinë që po punonin. Shpjego se anët e trupave quhen “faqe”. Diskutoni se sa faqe ka secila kuti (gjastë). Kërkoju nxënësve të vëzhgojnë secilën faqe, ta presin atë dhe ta ngjisin sërish siç ishte. Shpjegoju se, vijat ku ngjiten faqet quhen brinjë. Kërkoju nxënësve të numërojnë brinjët në secilin trup.

 Kërkoji secilit nxënësi të nxjerrin faqet nga kutitë dhe t’i rivendosin sërish. Kërkoju t’i shkëmbejnë me nga një partner dhe t’i ringjisin në trupin gjeometrik të mëparshëm.

 Tregoji klasës faqet e trupave dhe pyeti se sa brinjë ka secila figurë. Shpjegoni se “brinja” është vija që rrethon një figurë. Gjithashtu, shpjegoni se një kënd është një pikë ku bashkohen dy brinjë. Jepu mundësinë të gjejnë brinjët dhe këndet e figurave të ndryshme dhe të numërojnë se sa kënde dhe brinjë kanë figura të ndryshme.

Ushtrime me Librin e nxënësit



Pasi të keni mbaruar punën praktike për paraqitjen e trupave, faqeve dhe këndeve, kërkoju nxënësve të plotësojnë faqen 21.



Faqja 22 mund të plotësohet pasi t’u keni dhënë nxënësve praktikën e nevojshme në identifikimin e brinjëve dhe këndeve.

Pyetje vlerësimi

- Çfarë kanë të përbashkët këta trupa?
- Çfarë kanë të ndryshme këta trupa?
- Sa faqe ka ky trup?
- Cili trup tjetër ka të njëjtin numër faqesh?
- Gjej një brinjë.
- Sa brinjë ka gjithsej ky trup?
- Çfarë figure është faqja e këtij trupi?
- Cila figurë e sheshtë përputhet me këtë faqe?
- Sa brinjë ka gjithsej kjo figurë?
- Më thoni një figurë tjetër me të njëjtin numër brinjësh?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Nxënësit mund të kenë vështirësi për të kaluar nga paraqitja konkrete e trupave gjeometrikë tek paraqitja fotografike. Duhet shumë punë praktike me objektet konkrete dhe paraqitjen e tyre fotografike për të tejkaluar këto vështirësi dhe për të zhvilluar aftësitë e tyre vizuale.

VETITË E NUMRIT DHE FORMËS

Libri i nxënësit faqe 19 – 20

Elementi matematikor: Numri

Temat matematikore: Parashikimi nga vetitë e thjeshta

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të zgjidhim problema dhe enigma, dhe të parashikojmë nëpërmjet vetive e lidhjeve të thjeshta.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Nxënësit zhvillojnë konceptin e tyre për vetinë e thjeshtë si çdo sekuencë që përfshin një numër të përsëritur, pikturë apo formë. Në këtë fazë, fokusi është në modelet që përsëriten në mënyrë të rregullt (si 1, 2, 1, 2, 1, 2...) ose modele që ndjekin një rregull të thjeshtë (1, 2, 3, 4, 5 ... ose 2, 4, 6, 8, 10 ...).

Fjalor


Përsëritet, e njëjta, përsëri, blloqe, varg.


Mjetet


Blloqe formues me ngjyra, kartonë me numra nga 0 – 9, forma të thjeshta të prera (trekëndësha, rrathë, katrorë), kopsa.

Ide për mësimdhënie

Ushtrime praktike

 Krijoni një model të thjeshtë me blloqe me ngjyra: bllok i kuq, bllok blu, bllok i kuq, bllok blu, bllok i kuq. Pyet: “Bllokun me cilën ngjyrë do të vendosë në radhë?” (Duhet të përgjigjen blu). Pyesni nxënësit të thonë si e dinë. Ata duhet të shpjegojnë modelin me fjalët e tyre.

 Kërkoji një nxënësi të ngrihet dhe të krijojë një model tjetër ngjyrash, duke përdorur dy ngjyra të ndryshme. Sërish, ngrini një nxënës që të shpjegojë modelin me fjalët e tij.

 Përsërisni ushtrimin duke përdorur tre ngjyra. Pastaj duke përdorur figurat e prera (në fillim dy figura, më pas tre). Më pas mund të bëni një ushtrim të ngjashëm duke përdorur kartonët me numra.

Ushtrime me Fletoren e Punës



Në momentin që nxënësit janë familjarë me identifikimin dhe vazhdimin e modelit, mund të plotësojnë ushtrimet në faqet 19 dhe 20.

Pyetje vlerësimi

- Cili/a figurë/numër/ngjyrë vjen më pas? Si e dini?
- Në çfarë mënyre tjetër mund t'i sistemojmë këto figura/numra/blloqe në një model të caktuar?
- Bëni një model ku përdorni të njëjtën figurë, por e ktheni në forma të ndryshme secilën herë.
- Bëni një model ku shtoni nga një te secili numër.

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Mundet që disa nxënës t'i mësojnë lehtë shumë modele, por kanë vështirësi me të tjera modele. Meqenëse modeli përfshin përsëritjen, kjo nuk do të thotë se numrat përsërisin vetveten gjithmonë. Për shembull, modeli i mëposhtëm me numra ka numra të ndryshëm në secilin vend dhe shuma që shtohet, ndryshon në secilin hap. Gjithsesi, në momentin që zbuloni rregullën që drejton modelin, bëhet më e thjeshtë për ta zgjidhur.

1 2 4 7 11 (Rregulla: Shto 1; shto 2; shto 3; kështu me radhë ...)

Si strategji për të zbuluar rregullën, nxisni nxënësit të shikojnë tre elementët e parë të vargut. “A ndryshojnë në të njëjtën mënyrë secilën herë?” Pyesni se çfarë ndryshon në secilin hap. Për modelet numerike duhet të shikojnë për mbledhje dhe zbritje, numërim përpara ose numërim pas. Në faza të mëvonshme do të punojnë me shumëzimin dhe pjesëtimin. Për modelet me figura duhet të shikojnë figurën; çfarë ndryshon dhe çfarë mbetet e njëjtë. Duhet të shikojnë ngjyrën, madhësinë dhe vendndodhjen e figurës për të pasur ide mbi rregullën e modelit.

MË SHUMË SE, MË PAK SE

Libri i nxënësit faqe 11

Elementi matematikor: Numri

Temat matematikore: Numri dhe sistemi i numrave

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të krahasojmë dhe rendisim numrat të paktën deri në 20.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Koncepti i korrespondencës dhe lidhjes një me një është thelbësore për mësimet e mëvonshme dhe për zhvillimin e koncepteve të shëndosha mbi numrat.

Nxënësit do të mësojnë në këtë kapitull të lidhin objektet e përditshmërisë mbi bazën e modelit një me një. Nëpërmjet ushtrimeve praktike, nxënësit duhet të qartësojnë idenë e një grupi të barabartë si një grup që është identik me një tjetër. Ky është një koncept themelor që ka nevojë për shumë mbështetje konkrete, në mënyrë që të formohet qartë përpara se të kalohet tek grupet e barasvlershëm. Grupet e barasvlershëm kanë të njëjtin numër elementësh, por elementet mund të jenë shumë të ndryshëm.

Pasi nxënësit të kenë mësuar grupet e barabartë dhe të barasvlershëm, do të trajtojnë grupe me përbërës të ndryshëm, duke zgjedhur me sy grupet që kanë më shumë përbërës nga dy grupe të dhënë dhe më pas do të zgjedhin grupin me më pak përbërës nga dy grupe të dhënë.


Fjalor


Mjaftueshëm, jo mjaftueshëm, shumë, shumë pak, secili një, përshtat, e majtë, e djathtë, e barabartë, e barasvlershme, më shumë se, më pak, më pak se.


Mjetet


Pesë lule dhe vazo, lapsa, shkumësa etj.; objekte që lidhen natyrshëm me njëri-tjetrin, si shkopi dhe topi, filxhani dhe pjata, lapsi dhe libri, thika dhe piruni, shishja e lëngjeve dhe pipëza, zarfi dhe pulla; kuti për të formuar grupe; objekte për të formuar grupe; figura me ngjyra.


*Ide për mësimdhënie***Ushtrime praktike**

 Përvoja e lidhjes së objekteve me njëri-tjetrin në forma të ndryshme në situata të ndryshme është e rëndësishme për formimin e konceptit të numrit. Këtë mund ta bëni në klasë në situata të ndryshme. Për shembull, duke vendosur një pipëz në shishe çdo kohë dreke, duke vendosur një laps në çdo bankë, duke i dhënë një objekt secilit nxënësi, e kështu me radhë. Ndërsa e bëni këtë, mund të zhvilloni fjalor, si: mjaftueshëm, më shumë se, më pak se, nga një secilit, shumë, jo mjaftueshëm, shumë pak.

 Zgjidhni pesë lule. Jepua ato nxënësve të ndryshëm. Vendosni në tavolinën tuaj pesë vazo ose enë të tjera. Ngrini fëmijët dhe u kërkoni të lidhin nga një lule me secilën vazo. Thekso se kemi lidhur secilën lule me nga një vazo. Vazot janë të mjaftueshme për të gjitha lulet. Jepua lulet pesë nxënësve të tjerë. Hiqni një vazo. Përsërisni ushtrimin dhe mësoju fjalën “jo mjaftueshëm”. Nuk ka vazo të mjaftueshme për të gjitha lulet. Përsëriteni disa herë në situata ku kemi më shumë vazo dhe në situata ku kemi me shumë lule.

 Vendosni të tavolinën tuaj disa objekte (ose foto objektesh). Kërkoju nxënësve të vijnë dhe të çiftojnë objektet duke i vendosur bashkë fizikisht. Përpiquni të gjeni objekte, që shkojnë natyrshëm me njëri-tjetrin, si: shkopin dhe topin, pjatën dhe filxhanin, librin dhe lapsin, thikën dhe pirunin, shishen dhe pipëzën, zarfin dhe pullën etj. Përsëriteni me numra tek dhe çift që ndonjëherë ndonjë objekt të mbetet tepër. Përdorni mundësinë për të përforcuar fjalën ‘jo mjaftueshëm’.

 Përdorni një tabaka për të formuar një grup me tre objekte. Pyesni nxënësit si mund të bëjnë një tjetër grup njëlloj si ai. Le të ngrihen me radhë duke tentuar të formojnë një grup të njëjtë në një tabaka tjetër. Mësojuni konceptin ‘i/e barabartë’. Përsëriteni këtë disa herë me objekte të ndryshëm dhe me numër të ndryshëm objektesh, derisa të jeni të sigurt se klasa e kupton konceptin e një grupi të barabartë.

 Përzgjidhni katër vajza që të dalin përpara klasës. I lini të rrinë në formë rrethore ose grumbull. Theksoni që keni bërë një grup me vajza. Bëj një rreth tjetër ngjitur me ta. Pyesni klasën si mund të bëjnë një grup tjetër me djem me numër të njëjtë me grupin e vajzave. Lëri të shtojnë djem derisa të mendojnë se grupi është i barasvlershëm. Mësojuni fjalën i ‘barasvlershëm’. Tregojni se grupet

kanë të njëjtin numër pjesëtarësh, por pjesëtarët nuk janë të njëjtë. Kujtojeni se grupi i barabartë ka numër të njëjtë elementësh identikë.



Përdorni një shportë ose tabaka për të formuar një grup me një numër të caktuar objektësh. Mos përdorni të njëjtat objekte. Kërkojuni nxënësve të bëjnë një set me të njëjtin numër objektësh. Lërimi të shtojnë objekte derisa të mendojnë vetë se kanë të njëjtin numër objektësh. Përsëriteni disa herë me grupe me numra të ndryshëm objektësh, derisa të jeni të kënaqur që nxënësit e kuptojnë konceptin e grupeve të barasvlerëshëm.



Vizatoni dy rrahe gruresh në tabelë. Vendosni një grup me figura në grupin në të majtë. Kërkoju nxënësve të bëjnë një grup me më shumë figura se ai që keni bërë ju. Mos u kërkoni me një ose më shumë objekte, pasi qëllimi në këtë rast nuk është numri, por sasia. Lërimi të shtojnë figura derisa të mendojnë se grupi në të djathtë ka më shumë figura. Përsëriteni disa herë me sasi të ndryshme dhe figura të ndryshme. Më pas bëni të njëjtën me më pak figura. Mësojuni fjalën “më pak se”.

Ushtrime me Fletoren e Punës



Në faqen 11, shtyni nxënësit të lidhin objektet një me një, në mënyrë që të shohin se çfarë objektësh mbeten tepër. Kjo e bën më të thjeshtë që ta dallojnë se cili grup ka më pak objekte.



Nxënësit vizatojnë në faqen 11 grupet e tyre. Kini parasysh se diferenca ndërmjet grupeve nuk ka rëndësi derisa grupi në të majtë që ata zgjedhin, ka më shumë elementë sesa grupi që zgjedhin në të djathtë.



Nxënësit të plotësojnë faqen 11. Kini parasysh se, secili grup që ka më pak elementë se grupi në anën tjetër është i saktë. Teknikisht, ata mund të zgjedhin nga një vrimë në secilin rast dhe kjo të jetë e saktë.

Pyetje vlerësimi

- A keni lapsa/shkumësa/etj., të mjaftueshëm për të gjithë klasën? Si mund ta zbuloni?
- A është ky grup i barabartë me këtë grup? Si mund ta kontrollojmë?
- A ka ky grup numër të njëjtë elementësh sa ai grup? Si mund të kontrollojmë?
- A ka më shumë objekte në këtë grup apo në atë set? Si mund ta kontrollojmë?
- A ka më pak objekte në këtë grup apo në atë grup? Si mund ta kontrollojmë?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Disa nxënës mund të jenë në një fazë më të hershme zhvillimi se disa të tjerë. Nëse është ky rasti, ata e kanë më të vështirë ta bëjnë në mënyrë abstrakte lidhjen një me një. Për shembull, nëse ju u hiqni pesë nxënësve lapsat dhe i vendosni në një grumbull, ata do të mendojnë se kishte më shumë lapsa sesa nxënës, pavarësisht se më parë i kishin parë të lidhur me njëri-tjetrin. Mënyra e vetme për ta tejkaluar këtë është të ofroni shumë eksperiencë praktike me lidhjet.

NUMËRIMI DERI NË 10

Libri i nxënësit faqe 14, 16.

Elementi matematikor: Numri

Temat matematikore: Numrat dhe sistemi i numrave

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të numërojmë, lexojmë dhe shkruajmë numrat deri në 20.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Nxënësit të jenë të aftë të njohin dhe shkruajnë numrat 6, 7, 8, 9 dhe 10 dhe t'i lidhin ata me emrin e saktë të numrit dhe me grupin e saktë. Ata gjithashtu duhet të jenë në gjendje të lidhin emrat e numrave gjashtë, shtatë, tetë, nëntë dhe dhjetë me grupet dhe të formojnë grupe me nga gjashtë deri në dhjetë objekte.

Formimi i numrave ka nevojë për mësimdhënie dhe udhëzime të kujdeshme – nxënësit duhet të dinë se nga t'ia nisnin kur formojnë numrin dhe si ta shkruajnë secilin. Ka metoda të ndryshme për t'ua mësuar këtë. Disa ide që mund t'ju duken të dobishme janë:

- formimi i numrave me melodi, rërë ose me ngjyra;
- përdorimi i gishtit për të dalluar një numër të madh;
- përdorimi i letrës së kalkut për të kopjuar ose gjetur numrin;
- plotësimi i fletoreve të punës me versionin e numrave me pika;
- kopjimi i vargjeve me numra;
- formimi i modeleve me numra.

Së fundmi, nxënësit duhet t'i rendisin siç duhet numrat nga 6 – 10 në raport me numrat e tjerë të mësuar, në mënyrë që të konsolidojnë vargun e numrave nga 0 - 10.

Fjalor

Gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë, zero, një, dy, tre, katër, pesë.

Mjetet

Një bosht numerik me numra të qartë nga 6 – 10, kartonë me fjalët, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë, gurë, tapa shishesh, kuti vezësh.

Ide për mësimdhënie

Ushtrime praktike



Vendosi nxënësit të qëndrojnë në fund të klasës. Thirri të vijnë përpara një nga një, duke i numëruar. Vendosi në grupe me nga dhjetë përpara klasës. Sa herë arrini tek dhjeta, nisni sërish nga një. Kërkojuni secilit grup të numërojnë veten teksa ulen nëpër banka.



Kërkojuni nxënësve të mbledhin gishtat dhe të numërojnë me ju. Sa herë thoni një numër duhet të ngrenë një gisht (filloni me gishtin e madh). Lëkundni dorën kur arrini në pesë. Filloni nga gjashtë duke përdorur dorën tjetër. Përsëriteni duke treguar numrat në boshtin numerik. Pastaj tregojini numrat, por mos i thoni ato: kërkojuni nxënësve t'i ngrenë gishtat teksa ju tregoni numrat. Bëjeni këtë disa herë.



Përdorim boshtin numerik. Tregoni me gisht cilindo numër. Zgjidhni një nxënës dhe kërkojini të duartrokasë aq herë sa numri. Pjesa tjetër e klasës duhet të numërojë duartrokitjet për të kontrolluar nëse është i/e saktë. Përsëriteni disa herë duke përdorur numra të ndryshëm.





Zgjidhni një numër nga të filloni. Një nxënës të duartrokasë aq herë sa numri. Pyesni klasën se cili është numri pasardhës. Kërkojini të gjithë klasës të duartrokasë aq herë sa numri. Përsëriteni këtë duke përdorur të gjithë numrat si numra nga ku filloni. Pastaj bëjeni me radhë nga një në dhjetë.



Mësoji klasës rimën e mëposhtme dhe përdoreni atë ose të tjera për të përsëritur numrin nga një në dhjetë:

*** ***	*** *** *	*** *** **	*** *** ***	*** *** *** *
gjashtë	shtatë	tetë	nëntë	dhjetë
6	7	8	9	10

 Bëni në klasë lojëra me numërim rregullisht. Për shembull, kërkujuni nxënësve të ulen në gjunjë dhe të këndojnë bashkërisht deri në dhjetë. Kur të mbërrijnë tek 10, të gjithë duhet të bërtasin numrin dhe të ngrihen në këmbë.

 Kalo kohë duke shpjeguar konceptin e gjashtës si një më shumë se pesa. Vendosni nxënësit të bëjnë grupe me pesë elementë dhe më pas të shtojnë një; vendosi të vizatojnë grupe me nga pesë dhe më pas të vizatojnë dhe një element e të thonë se sa kanë.




Mësoji klasës të shkruajë numrin 6, siç keni bërë me numrat e tjerë.

Vendosi nxënësit të bëjnë grupe me nga gjashtë, të shkruajnë numrin e elementëve dhe të ngjyrosin grupe me nga gjashtë si më parë.



Përsërisni këtë praktikë për numrat nga 7 – 10, duke ua mësuar si një më shumë se numri paraardhës. Mësoju nxënësve të shkruajnë numrin dhe të lidhin numrin me elementët e një grupi.


 Pasi t'u keni mësuar të gjithë numrat dhe nxënësit mund t'i shkruajnë ata, siguroheni se janë në gjendje t'i lidhin numrat me sasi të dhe me emrat e numrave. Mund të bëni grupe kartonësh si më poshtë:

*** ***	*** *** *	*** *** **	*** *** ***	*** *** *** *
gjashtë	shtatë	tetë	nëntë	dhjetë
6	7	8	9	10

Merri kartonët, përzieji dhe jepua nxënësve t'i riorganizojnë për të formuar grupe që përputhen. Mund të bëni edhe fletë pune ku të plotësoni pikat, numrat, ose emrat, dhe nxënësit plotësojnë pjesën tjetër.



Përsërisni numrat me ushtrime të ndryshme. Për shembull, mund t'i vendosni nxënësit të shohin duart dhe të numërojnë gishtat nga 1 në 10. Mund të vizatojnë pemë dhe të vendosin një numër të ndryshëm frutash në secilën pemë. Poshtë pemës shkruajnë numrin e frutave me numër dhe me fjalë.

 T'u kërkosh nxënësve të bëhen më kompetent, duhet që të siguroheni që ata mund të punojnë me grupe të përzier dhe të identifikojnë numrin e elementëve në secilin grup, qoftë i shpërndarë, i organizuar ose i grumbulluar bashkë – ky koncept i konservimit të numrit është shumë i rëndësishëm. Për shembull, mund

të luani lojëra ku nxënësit rrëmbejnë gurët dhe më pas thonë se sa kanë marrë. Mund të numërojnë për t'i kontrolluar.

Vazhdoni të punoni në mënyrë konkrete me nxënësit derisa të jeni të sigurt se janë në gjendje të numërojnë me radhë, që i njohin dhe mund t'i emërtojnë numrat nga 1 në 10, që i kuptojnë këta numra dhe se janë të vetëdijshëm për konsolidimin e këtyre numrave.

Ushtrime me Librin e nxënësit

Pasi t'ua keni mësuar numrin 6, nxënësit të plotësojnë faqen 14.

Pasi t'ua keni mësuar numrin 7, nxënësit të plotësojnë faqen 16.

Përdorni faqen 26 për të vlerësuar nëse nxënësit janë të aftë të numërojnë deri në tetë dhe për të lidhur një grup me tetë elementë me numrin 8.

Pasi t'ua keni mësuar numrin 9, nxënësit të plotësojnë faqen 16.

Nxënësit mund të plotësojnë faqen 14 pasi t'ua keni mësuar numrin 10.

Faqja 29 mund të përdoret si një faqe vlerësimi, duke përsëritur ushtrimet e mëparshme mbi më shumë se dhe më pak se, dhe duke i vendosur nxënësit të zbatojnë atë që kanë kuptuar mbi lidhjet ndërmjet numrave nga 1 në 10.

Pyetje vlerësimi

- Cili është ky numër (tregoje me gisht)?
- Sa kam në dorë?
- Sa është një më shumë se?
- Thuaj numrin pasardhës.
- Cili numër vjen pas ...?
- Cili numër është përpara ...?
- Cili është emri i këtij numri?
- Vizato këtë sasi.

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Është e rëndësishme të siguroheni që nxënësit të zhvillojnë kuptimin e vlerës të secilit numër. Për këtë arsye, kur jeni duke shkruar numrat, duhet të shfaqni edhe sasinë që përfaqësojnë numrat, siç bëtë me numrat deri në pesë.

Orientimi i numrave mund të mbetet i vështirë për disa nxënës duke i shkruar gabim. Ndërgjegjësoji për këtë dhe ndihmoji të shmangin gabimet dhe të vetëkorrigjohen.

KLASIFIKIMI

Libri i nxënësit faqe 30 – 31

Elementi matematikor: Organizimi dhe përdorimi i të dhënave

Temat matematikore: Përzgjedhja dhe klasifikimi

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të zgjidhim problema të rëndësishme duke përdorur lista të thjeshta, tabela, objekte ose fotografi, klasifikimin dhe organizimin e informacionit; të shpjegojmë metodat dhe arsyetimin.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Nxënësit në këtë kapitull do të trajtojnë konceptin e klasifikimit të objekteve nëpërmjet vetive (në këtë rast është forma me të cilën tregohet secili numër), por në të njëjtën kohë, organizimi i objekteve ofron bazën për punën e mëtejshme me piktografinë (shenjat dhe simbolet që përfaqësojnë fjalë). Duke klasifikuar objektet, nxënësit tregojnë se mund të pohojnë vetitë e përbashkëta të një objekti në një grup dhe të përcaktojnë nëse një objekt i ri i përket këtij grupi apo jo.

Procesi i vëzhgimit të të përbashkëtave tek gjërat është i dobishëm në statistikë, por edhe në fusha të tjera të Matematikës. Këto aftësi të menduari do të përdoren më vonë në zgjidhjen e problemave dhe në ushtrimet kërkimore.

Fjalor

Përzgjedh, klasifikoj, grup, më shumë, më pak.

Mjetet

Koleksione me objekte të ndryshme për ushtrime praktike klasifikimi; modele frutash.

Ide për mësimdhënie

Ushtrime praktike



Përdorni mundësitë e përditshmërisë për t'i angazhuar nxënësit për të bërë në klasë ushtrime me përzgjedhje dhe klasifikim. Për shembull:

- klasifikoni librat në raft sipas madhësisë;
- klasifikoni shkumësat sipas ngjyrave për të bërë grupe;
- klasifikoni numërorët;
- klasifikoni objektet plastike nga ngjyra dhe lloji.

I nxirrni nxënësit jashtë që të bëjnë nga një koleksion objektesh. Mund të zgjedhin gurë, gjethe ose tapa shishesh. Kërkoju që t'i bëjnë koleksionet duke pasur parasysh ngjyrën, madhësinë ose formën dhe vendosini në bankë. Tregoji klasës një numër frutash të ndryshme. Kjo varet se çfarë do të keni mundësi të gjeni. Diskutoni se si mund t'i ndani në grupe (nga lloji, ngjyra, nga ato që pëlqejmë t'i hamë etj). Kaloni pak kohë duke organizuar frutat në rreshta sipas kategorive që sugjerojnë nxënësit. Bëni pyetje mbi organizimin.

Ushtrime me Librin e nxënësit



Diskutoni ushtrimet në faqen 30, më pas kërkoju nxënësve të punojnë vetë me ta.



Ushtrimet në faqen 31 ka të bëjnë me klasifikimin e artikujve sipas ndarjes se çfarë e brendshme dhe çfarë e jashtme. Ajo që është më e rëndësishme është se ky ushtrim i njeh nxënësit me traditën e përdorimit të kolonave dhe rreshtave në tabelë dhe ofron tregues për kategoritë që lidhen. Sigurohuni që i kuptojnë mësimet, më pas kërkoju që të punojnë vetë me ushtrimin.

Pyetje vlerësimi

- Si mund t'i grupojmë frutat?
- Cilat fruta janë të rrumbullakëta? Cilat nuk janë?
- Cilat fruta kanë fara që mund t'i hani? Cilat kanë fara që s'mund t'i hani?
- Cilat fruta duhet të qërohen? Cilat nuk kanë pse të qërohen?
- Në çfarë mënyrash të tjera mund t'i klasifikojmë frutat?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Ngatërresa më e mundshme në këtë fazë ka të bëjë me gjuhën, simbolet dhe kuptimin e udhëzimeve. Për shembull, a e kuptojnë nxënësit se çfarë doni të thoni me klasifikimin (në vend të numërimit)? “Klasifikim” do të thotë të gruposh sendet në një kategori ose veti të caktuar. Kështu që, nëse i grupojmë frutat sipas madhësisë, mund të kemi dy grupe: të madh dhe të vogël. Ose mund të kemi tre grupe: të madh, mesatar dhe të vogël. Ka shumë mënyra për të grupuar çdo koleksion të veçantë artikujsh.

Nxënësit duhet të kuptojnë në faqen 30 të Fletores së Punës se figurat në kolonën e parë të secilës tabelë përfaqësojnë figurën në të cilin shfaqet secili numër. Ky është përdorim simbolik i figurës dhe duhet të kuptojnë se figura në tabelë korrespondon me figurat në secilin koleksion. Po ashtu, në faqen 31, nxënësit duhet të kuptojnë kuptimin e fjalës “jashtë” dhe “brenda” në mënyrë që të plotësojnë ushtrimin.

FLETORË PUNË 1B NUMËRIMI DHE KRAHASIMI I NUMRAVE, DHE HYRJA TEK MBLEDHJA

Libri i nxënësit faqe 42 – 43

Elementi matematikor: Numri

Temat matematikore: Numri dhe sistemi i numrave

Shkathësitë për realizimin e kompetencave: Të numërojmë, lexojmë dhe shkruajmë numrat deri në 20; të krijojmë dhe përshkruajmë modele dhe sekuenca të thjeshta numrash, duke përdorur terminologjinë matematikore; të krahasojmë dhe rendisim numrat të paktën deri në 20.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Kjo pjesë u jep nxënësve mundësinë të përsërisin numërimin deri në 10, pastaj të rishikojnë numrat nga 1 në 9 duke shqyrtuar mënyrat e formimit të këtyre numrave.

Nxënësit mund t'i dinë tashmë fjalët “edhe” ose “më shumë” dhe t'i përdorin për të folur për mbledhjen ose bashkimin e grupeve. Në matematikë, mbledhja është një veprim që kërkon bashkimin e numrave dhe tregohet nëpërmjet shenjës +.

Në një bosht numerik mund ta tregojmë mbledhjen duke numëruar në të, ose duke lëvizur përpara një numër vendesh. Nxënësit do ta përforcojnë këtë koncept nëse i vendosni jashtë të lëvizin fizikisht në një bosht numerik. Në klasë, kombinimi fizik i grupeve do të formojë bazën për të formuar dhe shkruar barazimet që përfaqësojnë veprimet me mbledhje.

Nxënësit do të mësojnë të vendosin bashkë elementët përbërës të grupeve të ndryshme për të marrë shumën. Me fjalë të tjera, ata gjejnë shumën e dy grupeve të numrave. Kjo është një hyrje informale tek mbledhja dhe gjithashtu ofron bazën për përforcuar dhe ruajtur njohuritë mbi numrin, duke i paraqitur sasi të mënyra të ndryshme. Gjithashtu, paraqet një formë të thjeshtë të tabelës pa një mësim formal mbi të dhënat.

Fjalor


Emrat e numrave nga një në dhjetë, njëlloj, gjithsej, shuma, sa shumë, mblihdh, baras, plus.


Mjetet


Kartonë me numra nga 1 – 5; numëratore për ata nxënës që e kanë të nevojshme; kuti vezësh; një kuti me gur ose numëratore të tjera; dy kapakë ose enë të cektë; zare me afishe me gjashtë numra dhe me një zero të shkruar në të; një bosht numerik i vizatuar me shkumës jashtë klasës; dy grupe kartonësh me pika dhe me numra nga një 1 në 5; kartonë me + dhe = në to; një bosht numerik për secilin nxënës.


Ide për mësimdhënie


Ushtrime praktike


 Jepi secilit nxënës një grup kartonësh me numrat nga 1 – 5. Ata duhet t'i përziejnë dhe më pas t'i rendisin sipas radhës. Nxënësit të punojnë në çift me kartonët. Njëri prej nxënësve duhet të heqë një karton pa i treguar tjetrit se cilin ka hequr. Nxënësi tjetër duhet të riorganizojë kartonët për të gjetur se cili numër mungon. Këtë mund ta shtrini më pas duke u kërkuar nxënësve të heqin dy ose tre kartonë.

 Përdorni një kuti vezësh. Vendosni nga një karton të vogël numrash në secilën ndarje të kutisë dhe kërkoju nxënësve t'i mbushin pjesët me numrin e saktë.

 Jepi secilit nxënës dy kapakë dhe pesë gurë. Dy nxënës duhet të nxitojnë të kapin disa gurë dhe t'i vendosin në kapakë. Shpjegoju se ata do t'i "mbledhin" për të gjetur se sa janë. Ata diskutojnë si ta bëjnë këtë dhe si të gjejnë mënyrën për ta gjetur se sa është shuma . Kërkojuni ta verifikojnë duke numëruar gurët një nga një.

 Nxirreni klasën jashtë që të punojnë me boshtin numerik që keni vizatuar. Le të qëndrojnë në fillim të boshtit. Hidh zaren për të marrë një numër nga 0 – 5. Kërkoju nxënësve të thonë se ku duhet të ndalojnë në bosht. Lërinin të lëvizin në bosht për ta kontrolluar këtë. Përfshini dhe zeron.

 Jepi secilit nxënësi nga pesë sende numërimi. Udhëzoni klasën të formojnë grupe. Për shembull, filloni me një numëratore. Shtoni dy të tjerë. Sa keni tani? Përsëriteni disa herë me numra të ndryshëm. Përfshini dhe zeron kur nxënësit të jenë të gatshëm.

 Jepi secilit nxënësi nga një bosht numerik nga 0 – 5. Bëni lojëra ku ju u thoni numrin e pikënisjes dhe sa herë duhet të lëvizin. Ata duhet të bërtasin kur të

arrijnë tek numri i duhur dhe të bëjnë lëvizje për ta kontrolluar. Përsëriteni këtë me pikënisje të ndryshme, duke përfshirë dhe zeron. Mund t'ju thoni të lëvizin zero vende për të paraqitur konceptin e mbledhjes së zeros.



Jepi secilit grupi një zar, disa gurë dhe dy kapakë. Ata duhet ta hedhin zarin për të marrë një numër nga 1 – 5. Më pas duhet të gjejnë një mënyrë për të formuar numrin që ka rënë me dy grupe gurësh. Për shembull, nëse hedhin 3, mund ta bëjnë me 1 dhe 2 ose 2 dhe 1.



Diskutoni në klasë se si mund ta shkruani atë që po bëni. Shkruaj një barazim, si tre plus një baras katër. Kërkoju nxënësve të formojnë dhe përziejnë grupe të ndryshme dhe të shkruajnë fjali me numra për të shënuar punën që po bëjnë.



Paraqisni shenjat + dhe =. Mësoju nxënësve se këto janë simbole matematikore që i përdorim për t'i shkruar gjërat në mënyrë të shkurtër. Jepi secilit grup nga një karton me shenjën + =. Lëroni të përdorin gurë ose numëratore të tjera për të formuar shuma. Ata duhet të vendosin vetë se ku vendosen + dhe =. Lëviz në klasë dhe kontrollo nëse po e bëjnë saktë.



Përgatitni fletë model me shenjat e plusit dhe barazimit për të përforcuar shkrimin e këtyre shenjave.



Jepu nxënësve më shumë shembuj praktik të grupeve të përzier dhe vendosini të shënojnë ushtrimet duke përdorur shenjat + dhe = në mënyrën e duhur.

Ushtrime me Fletoren e Punës



Nxënësit të punojnë vetë për të plotësuar faqen 42. Vëzhgojini se si punojnë dhe ndihmoji ata që kanë vështirësi të përdorin numëratore.



Nxënësit të punojnë në çift për të plotësuar faqen 43. Kërkoju të numërojnë se, sa nga secili send, është në grup. Pastaj duhet t'i shkruajnë numrat në radhë. Diskutoni se cilët grupe kanë më shumë elemente dhe cilët më pak.



Faqet nga 4 në 7 u japin nxënësve mundësinë të formojnë numrat 3, 4, 5 dhe 6 në mënyra të ndryshme. Pasi t'i keni plotësuar ushtrimet praktike të mësipërme, nxënësit mund të punojnë në këto faqe në mënyrë të pavarur. Lejojini nxënësit t'i formojnë grupet nëse është e domosdoshme.



Faqet nga 8 në 10 paraqesin ushtrime të ngjashme, por përfshijnë shenjën +. Kur nxënësit të ndjehen rehat me përdorimin e shenjës +, për shkak të

ushtrimeve praktike, lejojini t'i plotësojnë vetë këto ushtrime. Lejoni nxënësit të formojnë barazime me mbledhje nëse është e nevojshme.

Pyetje vlerësimi

- Sa janë aty gjithsej?
- Sa e sa bëjnë ...?
- Sa bëjnë nëse mbledh ... dhe ... bashkë?
- Sa kam tani?
- Çfarë ndodh nëse shtoj ... më shumë?
- Çfarë numri duhet të mbledh për të marrë ...?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Mund të jetë e vështirë për nxënësit të dallojnë me shikim numrin e elementëve në grupe të mëdhenj.

Për këtë arsye i kemi grupuar dhe renditur elementët e secilit grup në Fletoren e Punës; ju mund të preferoni t'i nxisni ata ta bëjnë këtë me gurët dhe numërorët e tjerë të tyre për ta bërë më të lehtë në klasë.

Për nxënësit mund të jetë e vështirë mbledhja e një numri të vogël me një numër të madh, për shembull $1 + 9$, por, nëse u bëni shumë praktikë, do të zbulojnë se është e njëjtë me $9 + 1$, që është më e lehtë. Kjo quhet “vetia e ndërrimit të mbledhjes” dhe, nëse nxënësit zbulojnë dhe e pranojnë se radha e mbledhjes nuk është e rëndësishme, do të zvogëlojnë shumë numrin e “fakteve” që duhet të mësojnë.

Nxënësit mund ta kenë të vështirë mbledhjen e zeros. Duhet ta theksoni se do të thotë të mbledhësh asgjë. Kur përgjigjja është 0, mund ta harrojnë ta shkruajnë, prandaj duhet t'i kujtoni për këtë.

MBLEDHJA DHE ZBRITJA

Libri i nxënësit faqe 64 – 67

Elementi matematikor: Numri

Temat matematikore: Numrat dhe sistemi i numrave; llogaritjet; aftësitë mendore

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të përdorim shenjën = për të paraqitur “barazimin”; të themi numrin që është 1 më pak ose më shumë se një numër tjetër; të kuptojmë mbledhjen dhe të përdorim terminologjinë; të fillojmë të kuptojmë se mbledhja mund të bëhet në çfarëdo radhe dhe se më shumë se dy numra mund të mblidhen me njëri-tjetrin; ta kuptojmë zbritjen si “heqje” e “diferencë” dhe të përdorim terminologjinë; të fillojmë të përdorim shenjat +, – dhe = për të njohur përdorimin e simboleve, si \square dhe Δ për një numër të panjohur.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Këto ushtrime zgjerojnë punën me mbledhjen dhe prezantojnë zbritjen.

Nxënësit praktikojnë heqjen e objekteve nga një grup në mënyrë fizike dhe mësojnë të punojnë në mënyrë abstrakte me zbritjen si numërim mbrapsht. Zbritja është veprim. Këtë mund ta nënvizoni duke treguar shumë shembuj praktik dhe duke e përforcuar fizikisht veprimin e zbritjes.

Gjithashtu, ka edhe ushtrime mbi formimin e numrave, duke u përqendruar në formimin e numrit 10. Kjo përgatit nxënësit të punojnë me vendvlerën.

Fjalori


Më pak, heq, lëviz, mbetet, minus, zbritje, baras, dyshish, dyfishoj.


Mjetet


Kartonë numrash nga 1 – 5; numëratore për nxënësit që kanë nevojë; kartonë me numra; kuti vezësh; një kuti me gurë ose numërues të tjerë; dy kapakë ose enë të cekëta; zare me numra mbi 6 dhe me zero të shkruar në të; një bosht numerik i vizatuar me shkumës jashtë klase; dy grupe kartonësh me pika dhe me numra nga 1 në 5; kartonë me shenjat +, – dhe =; nga një bosht numerik për secilin nxënës.


Ide për mësimdhënie


Ushtrime praktike


 Jepi nga pesë gurë secilit grup. Nxënësit duhet të marrin me shpejtësi disa gurë nga grumbulli për të bërë një grumbull të ri. Shpjegoju se janë duke e hequr këtë sasi për të gjetur se sa do të mbeten. Ata diskutojnë si ta bëjnë këtë dhe si të gjejnë mënyrën për të gjetur se sa është ndryshesa. Kërkoju të kontrollojnë duke numëruar gurët që kanë mbetur.


 Nxirreni klasën jashtë për të punuar me boshtin numerik në tokë. Kërkojuni të qëndrojnë në fund të boshtit. Shpjegoju se do të lëvizin mbrapsht në bosht. Hidhni zarin për të marrë një numër nga 0 – 5. Pyesni nxënësit të thonë se ku mendojnë se do të ndalojnë. Lëri të lëvizin aq hapa në bosht për të mbërritur tek pika. Përfshini zeron.

 Jepi secilit nxënësi nga 10 numërues. Udhëzoni klasën të bëjnë grupe. Demonstroni zbritjen, për shembull, duke filluar me pesë gurë. Hiq një. Pyetini se sa kanë mbetur. Përsëriteni disa herë me numra të ndryshëm. Përfshini zeron kur të jenë gati nxënësit.

 Jepi secilit nxënësi nga një bosht numerik nga zero në pesë. Bëni lojëra ku ju u jepni pikën e nisjes dhe sa vende duhet të lëvizë. Duhet të bërtasin kur mbërrin dhe më pas të bëjnë lëvizje për ta kontrolluar. Përsëriteni këtë disa herë me pikënisje të ndryshme duke përfshirë zeron. Mund t'u thoni të lëvizin zero vende për të shpjeguar konceptin e zbritjes me zero.

 Jepi secilit nxënësi një zar, një grumbull gurësh dhe dy kapakë. Ata duhet të hedhin zarin për të marrë një numër nga 1 – 5. Më pas duhet të bëjnë një grumbull me aq gurë sa numri që ka rënë në një kapak. Këtë e përsërisin më pas me kapakun tjetër dhe heqin numrat nga njëri-tjetri.

 Bëni një diskutim në klasë se si mund të shkruani ato që po bëni. Jepuni shembull duke shkruar një fjali me numra, si “tre heqim një baras dy”. Vendosi nxënësit të bëjnë dhe zbresin disa grupe dhe të shkruajnë barazimin me numra për të shënuar punën që po bëjnë.

 Paraqisni shenjat – dhe =. Mësojini klasës se këto janë simbole matematikore që i përdorim për t'i shkruar gjërat shkurt. Jepi secilit grup një karton me – dhe =. Lëri të përdorin gurë ose numërues të tjerë për të modeluar zbritjet. Ata duhet të përcaktojnë se ku të vendosin – dhe =. Ec nëpër klasë për të kontrolluar nëse po e bëjnë siç duhet.



Përgatitsni fletë model me shenjat e barazimit dhe zbritjes për të përforcuar shkrimin e tyre.



Jepu nxënësve më shumë shembuj praktik të grupeve të përzier dhe lërimi ta shënojnë punën e tyre duke përdorur saktë shenjat – dhe =.

Ushtrime me Fletoren e Punës



Nxënësit ta plotësojnë vetë faqen 64. Lejojini të japin shembuj për përgjigjet nëse është e nevojshme.



Nxënësit ta plotësojnë vetë faqen 65.



Përsërisni përdorimin e shenjës + përpara se nxënësit të plotësojnë problemat në faqen 79. Ata nuk do të kenë nevojë t'i modelojnë këto problema, sepse mund t'i zgjidhin duke u bazuar tek figurat.



Faqja 91 paraqet konceptin e dyfishit duke përdorur mësimet që nxënësit i kanë bërë tashmë. Ata tanimë janë praktikuar me ndërtimin e numrave të njëjtë dhe me mbledhjen. Ata mund të punojnë në këtë faqe si ushtrim shtesë. Pasi ta kenë plotësuar, mund të prezantoni fjalën “dyfish”. Shpjego se, kur i shtojmë numrit po atë numër, e quajmë “dyfishim”. Lërimi të punojnë me përgjigjet e tyre duke përdorur fjalët dyfish: “Dyfishi 2 – shit jep 4. Dyfishi i 1 – shit jep 2, e kështu me radhë.



Faqja 64 është ushtrim me zbritje që përqendrohet në lidhjen ndërmjet zbritjes me 1 dhe numërimit mbrapsht. Ju mund të preferoni t'u tregoni nxënësve një bosht numerik dhe t'i lini të praktikohen duke numëruar prapa nga një, në mënyrë që të bëjnë zbritjen. Kur të jenë familjarizuar me këtë, lejojini të plotësojnë faqen 15.



Faqja 65 është një ushtrim më i përgjithshëm me zbritje. Nxënësit nuk është e nevojshme të formojnë grupet pasi duhet të përdorin vizatimin dhe kalimin në vend të modelimit.



Faqja 17 i rikthehet numrit dhjetë si parapërgatitje për ushtrimet me vendvlerën. Nxënësit krijojnë mënyra për të ndarë numrin dhjetë duke i ngjyrosur të dhjeta pikat me një ngjyrë (për të treguar $10 + 0$); pastaj nëntë pika (për të treguar $9 + 1$), e kështu me radhë. Aftësia për ta krijuar dhe ndarë dhjetën është themelore për punën e mëvonshme me mbledhjen që tejkalon dhjetën.

Pyetje vlerësuese

- Sa kemi gjithsej?
- Sa dhe sa bëjnë ...?
- Sa bën nëse mbledh dhe gjithsej?
- Sa kam tani?
- Çfarë ndodh nëse e mbledh me ... më shumë?
- Çfarë numrash duhet të mbledh për të marrë...?
- Sa kanë mbetur?
- Sa mbeten nëse heqim ... ?
- Sa kam tani?
- Sa mbeten nëse heqim ... më shumë?
- Sa duhet të zbres për të pasur ...?
- Zbritja me ... lë ...?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Nxënësit mund të ngatërrohen nga fakti se zbritja përfshin një numër më të madh dhe një numër më të vogël dhe se ata duhet (në këtë fazë) të zbresin numrin më të vogël nga numri më i madh. Ata kanë nevojë për shumë praktikë, veçanërisht me problemat me fjalë, në mënyrë që ta bëjnë këtë lidhje.

NUMRAT DYSHIFRORË DHE VENDVLERA

Libri i nxënësit faqe 30-32

Elementi matematikor: Numri

Temat matematikore: Numrat dhe sistemi i numrave

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të numërojmë, lexojmë dhe shkruajmë numrat deri në 20; të fillojmë të mësojmë se vendndodhja e shifrës i jep asaj vlerën në raport me një numër dyshifror.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Nxënësit mund të jenë në gjendje të numërojnë deri në 20, por me shumë mundësi nuk e kuptojnë ende mënyrën se si ndërtohet një numër dyshifror. Këto faqe paraqesin konceptin e vendvlerës. Kini parasysh se nxënësit do të punojnë në

vijimësi me vendvlerën deri në klasën e gjashtë, prandaj kjo është vetëm një hyrje.

Nxënësit duhet të mësojnë të thonë përmendsh emrat e numrave deri në 15 e pastaj deri në 20. Ata duhet gjithashtu të njohin numrat dhe të jenë në gjendje të numërojnë rrjedhshëm deri në 15 dhe të lidhin numrin e elementëve në një grup me numrin dhe emrin e numrit deri në 15. Teksa po kalojmë tashmë tek dhjetëshet dhe njëshet, numrat shfaqen si grupe dhjetëshesh dhe njëshesh në mënyrë që ky koncept të jetë i qartë.

Fjalor

Dhjetëshe, njëshe, vend, plus, numrat nga një në njëzet.

Mjetet

Kartonë me kuti boshe dhjetëshesh dhe njëshesh; numëratore, gurë ose kopsa; çanta të vogla për të bërë dhjetëshet; bosht numerik nga 0 – 20; kartonë me numra deri në 20, numërues, një tufë me dhjetë shkopinj ose pipëza.

Ide për mësimdhënie

Ushtrime praktike



Vendosi të gjithë nxënësit në fund të klasës. Të vijnë përpara një nga një dhe numëroji teksa vijnë. Ndaji në grupe me nga 15 përpara klasës. Sa herë që mbërrini tek numri 15, filloni nga numri një. Kërkoju nxënësve të secilit grup të numërojnë veten teksa ulen.



Shpjego njohjen e numrave nga 11 në 15, duke përdorur boshtin numerik. Numëro disa herë para dhe prapa duke përdorur boshtin numerik.



Përdor boshtin numerik. Trego një numër çfarëdo. Përzgjidh një nxënës dhe kërkoji të duartrokasë aq herë sa numri. Pjesa tjetër e klasës duhet të numërojë duartrokitjet për të kontrolluar nëse është i saktë. Përsëriteni disa herë me numra të ndryshëm.





Zgjidhni një numër fillestar. Kërkoji një nxënësi të duartrokasë aq sa numri. Pyesni klasën se cili është numri pasardhës dhe tregojeni me gisht. Kërkoji të gjithë klasës të duartrokasë aq herë. Përsëriteni këtë duke përdorur të gjithë numrat si pikënisje. Pastaj bëjeni sërish me numrat nga 11 në 15.





Bëni në klasë rregullisht lojëra me këndim. Për shembull, vendosi nxënësit


të ulen në gjunjë dhe të thonë numrat deri në 15. Kur të arrijnë te 15 të bërtasin me të madhe dhe të ngrihen në këmbë.


 Kalo kohë duke shpjeguar konceptin e 11 si një më shumë se dhjetë. Kërkoju nxënësve të bëjnë grupe me nga pesë dhe më pas të shtojnë një më shumë; kërkoju të bëjnë grupe me dhjetë dhe më pas të shtojnë një më shumë dhe të thonë se sa kanë.

 Mësoji klasës numrat nga 11 – 15, siç keni bërë me numrat e tjerë.


 Bëni grupe për secilin numër dhe shkruani numrin e elementëve.

 Pasi t'u keni shpjeguar të gjithë numrat, nxënësit mund t'i shkruajnë numrat, sigurohuni se ata mund t'i lidhin numrat me sasishtë dhe me emrat e tyre. Mund të bëni grupe me kartonë siç bëtë me numrin dhjetë. Përzieji dhe vendosi nxënësit t'i riorganizojnë për të formuar grupe që lidhen. Mund të bëni edhe fletë pune ku ju plotësoni ose pikat, ose numrat, ose emrat, ndërsa nxënësit plotësojnë pjesën tjetër.

 Teksa nxënësit bëhen më kompetent, duhet të siguroheni se janë në gjendje të punojnë me grupe të përzier dhe të dallojnë numrin e elementëve në secilin grup, qoftë i shpërndarë, i organizuar apo i grumbulluar – ky koncept i konsolidimit të numrit është shumë i rëndësishëm. Për shembull, mund të bëni lojëra ku nxënësit bëjnë një grumbull me gurë dhe thonë se sa kanë marrë. Mund t'i numërojnë për t'i kontrolluar.

 Tregoju nxënësve grupe me objekte të organizuar në grupe me nga dhjetë dhe me nga një element dhe kërkoju të thonë se sa janë gjithsej. Për shembull, një tufë me dhjetë pipëza dhe katër pipëza të vetme, një tufë me dhjetë shkrepëse të përdorura dhe tre shkrepëse të vetme, një kullë me dhjetë blloqe dhe një bllok i vetëm, një grumbull me dhjetë gurë dhe dy gurë të vetëm. Vendose klasën të bëjë grupe me nga dhjetë elementë dhe elementë të veçuar duke përdorur pipëza dhe mjete të tjera.

Vijoni të punoni në mënyrë praktike me nxënësit derisa të jeni të sigurt se mund të numërojnë me radhë, që i njohin dhe mund t'i emërtojnë numrat nga 0 në 15, se kanë një kuptim mbi këta numra dhe se janë të vetëdijshëm për rëndësinë e konsolidimit të numrit.

 Krijoni një grup me dhjetë numërues. Numëroni me klasën me ngadalë deri në dhjetë. Trego një numërues më shumë. Pyesni: 'Çfarë ndodh nëse mbledhim nga 1 në 10?' Shkruaj numrin dhe emrin e numrit në tabelë. Bëj të njëjtën gjë me


numrat 12 dhe 13, duke i shkruar numrat poshtë njëri-tjetrit si këtu:


10


11

12

13


 Pyesni nxënësit se çfarë modeli vënë re. Ata duhet të dallojnë se secili numër ka një 1 përpara dhe më pas numrat fillojnë nga 0: 0, 1, 2, 3.


 Numëro sërish 11 numërues dhe, kur të arrini në dhjetë, vendosi në një kuti plastike boshe. Thuaj: ‘Ky është një grup me dhjetë. Tani po shtoj një tek dhjetëshja ime. Dhjetë plus një bëjnë 11. Ose 1 dhjetëshe plus 1 njëshe’.


 Tregoni një karton me vendvlerë. Vendosni kutinë me dhjetë numërues tek kolona e parë (e dhjetësheve) dhe numëruesin e vetëm tek kolona e dytë (e njësheve). Thuaj me zë të lartë: ‘Një dhjetëshe dhe një njëshe.’ Vizatoni një tabelë vendvlerash në tabelë si kjo:

dhjetëshe	njëshe
1	1

Pastaj pyet: Çfarë ndodh nëse shtojmë një më shumë. Cili numër është pas 11–ës? (12). Tregoni numrin të paraqitur në të njëjtën mënyrë: dhjetë dhe dy numërues; numrat në tabelën e vendvlerës. Shkruani sërish numrin dhe vendoseni në tabelë.

 Tregoni se si e plotësojmë tabelën e vendvlerës për secilin numër. Lërimi nxënësit të praktikohen duke plotësuar shembuj në tabelë. Kur të shihni se arrijnë të numërojnë me dhjetëshe dhe njëshe, vijoni me Përzieni kartonët me numra. Një nxënës të zgjedhë një dhe ta mbajë lart. Klasa të thotë numrin. Pyesni se cili numër vjen pas tij dhe cili qëndron para tij. Përsëriteni disa herë me nxënës të ndryshëm dhe me numra të ndryshëm me numrat deri në 20.

 Pasi të keni punuar me numrat nga 11 në 20, tregoji klasës një bosht numerik dhe lërimi nxënësit të praktikohen duke numëruar deri në 20. Jepu mundësinë të identifikojnë numra që janë më të mëdhenj ose më të vegjël se një numër i dhënë. Tregoni numrin 12 dhe pyet se cili numër është një më i vogël? (11) ‘Cili numër është një më shumë se 12?’ (13). Përsëriteni me numra të tjerë në mënyrë që nxënësit të praktikohen me krahasimin e numrave.

 Vendosini nxënësit të punojnë në çift. Jepi secilit çift një grup numëruesish

(një shumë ndërmjet 11 dhe 20). Vendosi të numërojnë numëruesit dhe t'i organizojnë në një tabelë vendvlerash për të përcaktuar numrin. Teksa secili çift e ka përcaktuar numrin, jepu një numër tjetër për të punuar.

Ushtrime me Librin e nxënësit



Faqja 47 u jep fëmijëve mundësinë për të lidhur tabelat e vendvlerës me mbledhjen e dhjetësheve dhe njësheve. Punoni bashkë me klasën për këtë faqe.



Nxënësit të punojnë vetë me faqen 19 për të plotësuar numrat dhe emrat e numrave për secilin grup. Mund të përdorin për ndihmë ushtrimet e plotësuara të faqes, por edhe ju mund t'i lini emrat e numrave të shkruar në tabelë. Me këtë faqe mund të punoni edhe ju me nxënësit, pasi ata me gjasë nuk do të jenë në gjendje të mbajnë mend të gjithë emrat e numrave deri në 20.



Faqja 20 u jep mundësi nxënësve të praktikohen me krahasimin dhe renditjen e numrave deri në 20. Sërish duhet të rrisni nivelin e vetëbesimit në klasë. Disa nxënës mund të jenë në gjendje të punojnë vetë me këtë faqe; të tjerët mund të kenë nevojë për ju.



Në momentin që nxënësit janë familjarizuar me numrat deri në 20, atëherë mund të punojnë vetë me faqen 20. Ju mund të preferoni të lini në tabelë një bosht numerik në mënyrë që ata numërojnë para dhe pas secilin numër.

Pyetje vlerësimi

- Cili numër është ky (duke e treguar me gisht)?
- Sa kam tani?
- Sa është një më shumë se . . . ?
- Thuaj numrin pasardhës.
- Thuaj numrin e mëparshëm . . . ?
- Cili numër është para . . . ?
- Si emërtohet ky numër?
- Cili numër është një më shumë se 11/12/13 . . . ?
- Cili numër është 1 më shumë se ky?
- Cili numër është një më pak se ky?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Me numrat e mëdhenj, nxënësit e kanë të vështirë të gjejnë numrin pasardhës ose numrin paraardhës pa numëruar sërish nga një. I sugjeroni të përdorin pjesë të boshtit numerik.

Kur nxënësit numërojnë shuma të mëdha, ndonjëherë nuk i prekin dhe lëvizin. Kjo ndonjëherë bëhet e ngatërruar, pasi harrojnë se cilët i kanë numëruar dhe cilët jo. Kujtojini t'i prekin objektet dhe në momentin që e kanë numëruar ta kalojnë në anën tjetër.

Në fillim, nxënësit mund ta kenë të vështirë ta kuptojnë konceptin e vendvlerës. Mund të mendojnë se 1 tek 13 përfaqëson 1 jo 10. Rikthehuni herë pas here tek tabela e vendvlerës që ta shohin se pozicionimi i numrit është i rëndësishëm.

Nxënësit mund të ngatërrohen me njëzetën, pasi nuk ndjekin të njëjtën rregull si numrat e mëparshëm: njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë etj. Jepu mundësinë të thonë emrat e numrave.

Nxënësit mund të bëjnë hamendje të çuditshme kur u kërkon të vlerësojnë shumat e mëdha. Ndhijmoji duke u dhënë numra me të cilët të punojnë. Bëj ushtrime të tilla si: 'Kam marrë më shumë se 10 gurë, por më pak se 15. Sa mendoni se kam marrë?'

MATJA E MASËS

Libri i nxënësit faqe 50–51

Elementi matematikor: Forma, hapësira dhe masat

Temat matematikore: Masat

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të krahasojmë dy ose më shumë gjatësi me krahasim të drejtpërdrejtë; të krahasojmë dhe masim objektet duke përdorur njësitet standarde dhe jostandarde.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Nxënësit mësojnë konceptet “i rëndë” dhe “i lehtë”. Më pas konsolidojnë njohuritë me matjen duke përdorur njësitet informate dhe duke krahasuar masën e objekteve.

Si me ushtrimet e tjera të matjes, është e rëndësishme të filloni me ushtrime konkrete me të cilat nxënësit i prekin fizikisht objektet për të përcaktuar nëse janë të rëndë a të lehtë, më i rëndë a më i lehtë se njëri–tjetri.

Nëse nuk keni një peshore tregtare, atëherë mund ta bëni duke përdorur një varëse palltosh, si kjo më poshtë:

Fjalor

E rëndë, e lehtë, më e rëndë se, më e lehtë se, peshon më shumë se, peshon më pak se, balancë.

Mjetet

Një çantë plastike e mbushur me rërë; pëlhura; disa gurë të ngjashëm në masë; peshore balance; lojë me rruzuj; sende për t'i matur; gota letre; rërë.

Ide për mësimdhënie

Ushtrime praktike



Zgjidh një nxënës. Kërkoji të mbajë çantën me rërë. Pyete nëse çanta me rërë është e rëndë apo e lehtë. Shkruaj fjalën e rëndë në tabelë për të përforcuar shkrimin dhe leximin. Kaloje çantën nëpër klasë, në mënyrë që ta shohin të gjithë a është e rëndë. Jepi një nxënësi tjetër një shami. Pyete nëse është e rëndë apo e lehtë. Shkruani fjalën në tabelë dhe kalojeni shaminë nëpër klasë. Diskutoni se cila është më e lehtë e cila më e rëndë.



Gjej dy gurë me masë të ngjashme, pyeti nxënësit se cili është më i rëndë dhe cili më i lehtë. Bisedoni si mund ta verifikojmë për të qenë të sigurt. Demonstroni përdorimin e peshores me balancë. Tregoni idenë se pjata e peshores që ka peshën më të rëndë ulet më poshtë.




Zgjidhni disa çifte objektesh që janë të ndryshëm në masë. Kalojeni nëpër klasë dhe u kërkonit të thonë cili është më i rëndë. Lejojini të përdorin varësen e balancës për t'i kontrolluar. Diskutoni se çfarë ndodh me varësen e balancës nëse objektet kanë të njëjtën peshë. Demonstroni këtë duke përdorur dy objekte me të njëjtën peshë.




Kërkoju nxënësve të gjejnë dhe përzgjedhin: pesë gjëra që janë më të lehta se një kuti lapsash; pesë gjëra që janë më të vogla se këpuca, por më të rënda; pesë gjëra që janë më të rënda se këpuca, por më të lehta se tulla, e kështu me radhë.





Diskutoni se si mund të krahasoni masën e dy sendeve duke përdorur goglat. Tregojeni duke përdorur varësen e balancës dhe shënoni përfundimet. Për shembull, lapsi peshon njësoj sa një gogël, topi tenisit peshon njësoj sa katër gogla. Jepu nxënësve shumë ushtrime praktike me matjen e gjërave, duke përdorur peshoren e balancës dhe goglat si mjete matëse. Lërinin të shënojnë dhe vlerësojnë masën e sendeve të ndryshëm.

 Jepi secilit grup disa sende dhe kërkoju të vlerësojnë masën e tyre me gogla dhe t'i rendisin më pas nga më i rëndi tek më i lehti duke përdorur vlerësimet e tyre. Pastaj duhet t'i masin dhe kontrollojnë.

Aktivitete ne Librin e nxënësit

 Pasi t'i keni mësuar nxënësit me rernat 'i rëndë', 'i lehtë', 'më i rëndë', 'më i lehtë', mund të punojnë me faqet 50 dhe 51

 Pasi nxënësit të kenë krijuar pak përvojë në përdorimin e peshores me balancë, mund ta plotësojnë vetë faqen 51. Ata duhet të kuptojnë se objekti më i rëndë ulet gjithnjë më poshtë se objekti më i lehtë.

 Përdorni faqen 52 për të bërë ushtrime praktike me peshoren me balancë. Nëse nuk i keni gjërat që tregohen në fotografi, lëroni nxënësit të zgjedhin çifte të tjerë objektësh në librin e tyre të ushtrimeve dhe të qarkojnë objektin më të lehtë në secilin çift.

Pyetje vlerësimi

- Cili është më i rëndë?
- Cili është më i rëndi?
- Cili është më i lehtë?
- Cili është më i lehti?
- Si mund ta kontrollojmë?
- Cili është i vogël dhe i lehtë?
- Sa gogla e bëjnë këtë balancë?
- Cili është i vogël dhe i rëndë?
- Cili është i madh dhe i lehtë?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Vlerësimi mund të jetë sërish problem. Referojuni faqes 53 të këtij libri për udhëzime.

Trajtimi i njëjësive të ndërmjetme mund të jetë ngatërrues, veçanërisht kur peshorja nuk do të balançohet.

MATJA E KOHËS

Libri i nxënësit faqe 61–63

Elementi matematikor: Forma, hapësira dhe masat

Tema matematikore: Masat

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të kuptojmë dhe të përdorim fjalorin që lidhet me kohën; të rendisim në kohë ngjarje të njohura; të mësojmë ditët e javës dhe stinët e vitit.

Koncepti dhe zhvillimi i njohurive

Koha është një masë. Gjithsesi, për fëmijët e vegjël, kjo është e vështirë të kapet dhe të shprehet me fjalë, sepse koha është koncept abstrakt dhe nuk mund ta rrokim, prekim dhe trajtojmë fizikisht. Nxënësit kanë eksperiencë me kohën, sepse lidhet me përditshmërinë e tyre dhe duhet të njohin disa fjalë që lidhen me kohën e ditës dhe natës. Disa kanë konceptin sa sa kohë kërkojnë gjërat, disa jo. Koncepti i kohëzgjatjes është i rëndësishëm sepse do të paraqitet vetëm në këtë fazë. Renditja e ngjarjeve në kohë kërkon që nxënësit të përdorin terminologjinë: para, pas, më herët dhe më vonë.

Nxënësit duhet të kuptojnë se disa aktivitete kërkojnë më shumë kohë se të tjerët. Duhet t'u bëni ushtrime praktike për të bërë krahasime në mënyrë që të kuptojnë se çfarë do më shumë kohë, çfarë më pak kohë dhe çfarë të njëjtën kohë.

Një metodë e matjes së kohëzgjatjes janë ditët. Përderisa fëmijët e vegjël i ngatërrojnë ditët e javës, i kemi paraqitur këtu.


Fjalor


Mëngjes, pasdite, mbrëmje, ditë, natë, tani, gjatë, më pas, në fillim, pastaj, kohë e gjatë, kohë e shkurtër, javë, ditë, e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte, e premte, e shtunë, e diel, sot, nesër, dje.


Mjetet


Fotografi të ditës dhe të natës, fotografi që tregojnë veprime të përditshme; matës kohe; kartonë me emrat e ditëve të javës; shirit; kalendar.


*Ide për mësimdhënie***Ushtrime praktike**


 Vendosi nxënësit të aktrojnë ngjarje që ndodhin gjatë natës ose gjatë ditës. Klasa duhet të marrë me mend se ajo që u aktrua ndodh gjatë ditës apo gjatë natës. Diskutoni për aktivitete që bëhen gjatë ditës dhe gjatë natës.


 Bëni një tabelë klase për aktivitetet e ditës dhe ato të natës. Vizato një diell në krye të tabelës së ditës dhe një hënë në krye të tabelës së natës. Kërkoji secilit nxënës të zgjedhë një aktivitet ose për ditën, ose për natën dhe vendoseni në tabelë. Përpara se të shënoni aktivitetet e ditës, diskutoni se kur ndodhin, në mëngjes apo pasdite. Vendosi në dy grupe të ndryshme në tabelë.

 Jepi secilit grup fotografi që tregojnë aktivitetin e përditshëm. Kërkoju t'i rendisin siç mendojnë se dikush do t'i bënte këto aktivitete. Lëri të bëjnë një histori me ditën e atij personi dhe t'ia tregojnë njëri-tjetrit në klasë.

 Shkruani në tabelë termat “para shkollës”, “pas shkollës” dhe “gjatë shkollës”. Kërkoju nxënësve të thonë se çfarë bëjnë gjatë secilës prej këtyre kohëve. U kërkoni të vizatojnë tre piktura ku tregohen nga një aktivitet për secilën nga këto kohë. Lëri nxënësit t'i vendosin pikturat në vendin e duhur. Tregojuni me shembull se si duhet të flasin për aktivitetet. Për shembull, përpara shkollës shkoj tek stacioni i autobusit, më pas hipi në autobus. Në shkollë luaj me shokët, pas kësaj luaj futboll.

 Nxirre klasën jashtë. Shënjo një rrugë të shkurtër. Kërkoni për vullnetarë të plotësojnë ushtrimin në rrugë: a) të vrapojnë, b) të ecin, c) të ecin mbrapsht, d) të zvarriten, e) të ecin symbyllazi. Diskutoni se sa kohë do të plotësohet secila detyrë sipas mënyrave të sipërpërmendura. Sigurohuni që nxënësit të përdorin fjalët “kohë të gjatë” dhe “kohë të shkurtër”.

 Jepu nxënësve të plotësojnë kolonat e modelit. Bëji disa të thjeshta disa të vështira. Përdorni orën me rërë. U thuaj të fillojnë dhe ndalojnë duke përdorur orën me rërë. Lëri nxënësit të thonë me fjalë se çfarë ndodh. “Ky model zgjati më shumë se ky tjetri”; “Nuk kisha kohë të mjaftueshme ta mbaroja këtë”, e kështu me radhë. Mund ta përsërisni këtë aktivitet me ushtrime të ndryshme përfshi edhe ato fizike.

 Mësoju ditët e javës duke përdorur kartonët. Jepu të radhitur duke filluar nga e hëna. Thuaj emrin e secilës ditë teksa ua jep nxënësve. Kur t'ua keni dhënë

të gjithë kartonët, kërkoju nxënësve të ndahen në grupe sipas ditës që kanë në dorë. Thuaj emrin e ditës dhe kur e thua, nxënësit e atij grupi të hidhen lart.



Kërkoji një nxënësi nga secili grup të dalë para klasës. Vendosi kartonët në tavolinë sipas rendit të saktë. Lexojini edhe një herë si klasë.



Kaloni pak kohë duke i lexuar emrat e ditëve të javës sipas radhës. Trego me gisht në tabelë ditën që jeni. Kërkoju nxënësve të thonë se çfarë dite ishte dje dhe çfarë do të jetë nesër. Kjo është praktikë e mirë edhe për punën e mëvonshme me boshtin numerik. Mund të bëni edhe pyetje, si: “Çfarë dite ishte dy ditë më parë?” etj.



Ju mund të preferoni të përgatisni një prezantim për klasën që tregon ngjarjet që ndodhin rregullisht gjatë një dite. Kërkoju nxënësve të vizatojnë piktura dhe t’i vendosin poshtë ditës përkatëse. Kjo do t’i ndihmojë të mbajnë mend emrat e ditëve.



Ju mund të bëni edhe një tabelë të ditëve të preferuara të javës për të prezantuar konceptin e tabelës me vizatime. Vizato një tabelë si kjo më poshtë në një fletë të madhe letre. Kërkoji secilit nxënës të vizatojë një pamje në njërin prej kolonave përkrah ditës së tij/saj të preferuar. Mbajeni këtë për ta përdorur më vonë gjatë vitit kur të punoni me tabelat.

Ditët tona të preferuara të javës	
E hënë	
E martë	
E mërkurë	
E enjte	
E premte	
E shtunë	
E diel	



Tregoju nxënësve një kalendar. Kërkoju të identifikojnë në kalendar muajin e ditëlindjes. Pastaj kërkoju të lexojnë me zë të lartë emrat e muajve të vitit. Diskutoni me klasën se çfarë ndodh në çdo kohë të vitit. Mund të pyesni: “Në cilin muaj të vitit filluam shkollën këtë vit?”; “Në cilin muaj të vitit ishte ditëlindja e ...?”; “Në cilin muaj të vitit do të kemi pushim për Krishtlindje, Vitin e Ri etj.?”

Ushtrime me Librin e nxënësit



Në momentin që nxënësit janë familjarizuar me termat “më parë” dhe “më pas”, punoni me ta me ushtrimin në faqen 61. Mund të punojnë me këtë ushtrim edhe në çifte ose në grupe. Duhet të shikojnë secilin grup fotografish dhe të përshkruajnë se çfarë po ndodh, e para, e dyta dhe e treta. Më pas mund ta radhisin sekuencën e ngjarjeve. Diskutoni për ushtrimin më pas me klasën dhe pyetini se nga e dinin se çfarë ndodhi e para, e dyta dhe e treta. Theksoni fjalën “më parë” dhe “më pas” teksa punoni me këtë faqe.



Diskutoni me nxënësit ditët e javës. I pyesni se çfarë dite është sot, çfarë dite ishte dje dhe çfarë do të jetë nesër. Mund të pyesni edhe: “Çfarë dite është pas . . . (E hënë/E martë etj.)?” “Çfarë dite është para . . . ?” Kur të jenë familjarë me ditët e javës, vendosini të punojnë me ushtrimin në faqen 63. Mund t’i lini emrat e ditëve të javës të shkruara në tabelë. Ndoshta duhet edhe të “ngacmoni” disa nxënës për të thënë aktivitetet që bëjnë gjatë një dite të caktuar.



Kur nxënësit të jenë familjarizuar me muajt e vitit, vendosini të plotësojnë ushtrimin në faqen 63. Ndoshta kanë nevojë për pak ndihmë që të kujtojnë se çfarë moti mbanë secili muaj. Ka mënyra të ndryshme për t’ju qasur këtij ushtrimi: për shembull, mund t’u kërkonin nxënësve që kanë ditëlindjet në muaj të ndryshëm të thonë se çfarë moti bën zakonisht në ditëlindjen e tyre. Më pas, secili duhet të vendosë simbolin e duhur. Kini parasysh se ky ushtrim i ndihmon nxënësit me traditën e paraqitjes së të dhënave me simbole në tabelë.

Pyetje vlerësimi

- Në çfarë kohe të ditës ne . . . ?
- Çfarë merr më shumë kohë: lidhja e lidhëseve të këpucëve apo ngrënia e drekës?
- Çfarë merr kohë të shkurtër?
- Çfarë merr kohë të gjatë?
- Çfarë bëtë para shkolle?
- Çfarë do të bëni pas shkolle?
- Çfarë dite është sot?
- Çfarë dite ishte dje?
- Çfarë dite do të jetë nesër?
- Çfarë dite është para së hënës?
- Çfarë dite do të jetë pas dy ditësh?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Fëmijët e vegjël mund ta kenë të vështirë ta kuptojnë se koha nuk ndalon edhe pasi ndalon aktiviteti, është shumë e rëndësishme që ta kuptojnë se matja e kohëzgjatjes së një aktiviteti është regjistrimi i kohës që duhet për të bërë diçka. Fëmijët e vegjël e kanë të vështirë të radhisin ngjarjet sipas kohës kur kanë ndodhur kur këto kanë ndodhur larg në kohë nga njëri-tjetri. Ndhimoji duke ua treguar konkretisht se ngjarjet që kanë ndodhur, për shembull, në javën e kaluar, ndodhën një javë më parë, e kështu me radhë.

Nxënësit ndonjëherë e kanë të vështirë t'i kujtojnë me radhë ditët e javës. Mund t'i ndihmoni duke ua kujtuar vazhdimisht radhën e ditëve duke përdorur këngë dhe rima të ndryshme.

KOHA NË ORË

Libri i nxënësit faqe 130 – 132

Elementi matematikor: Forma, hapësira dhe masat.

Tema matematikore: Masat

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të kuptojmë dhe përdorim fjalorin e lidhur me kohën; të rendisim në kohë ngjarjet e njohura; Të njohim ditët e javës dhe stinët e vitit; të lexojmë kohën me gjysmë ore dhe me orë në orët analoge.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Nxënësit në këtë kapitull do të mësojnë të tregojnë kohën me gjysmë ore dhe me orë nga një orë analoge.

Kapitulli ofron mundësi për të zhvilluar fjalorin e nxënësit më fjalë dhe fraza që lidhen me momente të kohës dhe me aktivitete të veçantë që bëjnë në kohë të ndryshme të ditës, javës dhe vitit.

Fjalor


Kohë, ora (mjeti), minutë, orë (koha), fiks, e gjysmë, janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor.


Mjetet

Një faqe ore analoge me akrepa të lëvizshëm.


Ide për mësimdhënie


Ushtrime praktike


 Tregojtu nxënësve pozicionin e akrepave në një orë analoge kur ora është 1 fiks, 2 fiks, deri në 12 fiks. Jepu mundësinë t'i lëvizin akrepat në kohë të ndryshme dhe të lexojnë orën kur akrepat janë lëvizur.


 Nxënësit mund të bëjnë faqe të mëdha ore (me diametër 20cm) duke përdorur:

1. një pjatë kartoni të festave ku të presin një disk rrethor;
2. një rrip kartonësh me të cilët të bëjnë akrepat;
3. kapëse letrash me të cilën të mbajnë bashkë akrepat me faqen e orës.

 Nxënësit tashmë mund ta njohin kohën në orë, por është e dobishme të shpenzoni pak kohë me ta duke punuar me kohën në orën analoge. Tregojtu nxënësve vendndodhjen e akrepave në një orë analoge kur ora shënon 1, 2 deri në 12.

 Tregojtu praktikisht nxënësve duke nisur nga 12, se duhet saktësisht një orë që akrepi i gjatë (i minutave) të bëjë rrotullim të plotë. Nxënësit duhet të jenë familjarizuar edhe me thyesën “gjysmë”. Përdoreni këtë për të prezantuar idenë se gjysmëlëvizja e akrepit të madh përbën “gjysmë ore”.

 Tregojtu nxënësve se akrepi i orës në një orë analoge bën rrotullim të plotë dy herë përgjatë një dite; një ndërmjet mesnatës dhe mesditës, dhe një tjetër ndërmjet mesditës dhe mesnatës.

 Nxënësit të punojnë në çifte. Një nxënës thotë një orar dhe nxënësi tjetër lëviz gishtat në faqen e orës për të treguar kohën me orë, orë e gjysmë, orë e një çerek dhe orë pa një çerek. Anasjelltas, një nxënës vendos orën në faqen e orës dhe tjetri duhet ta thotë se sa është ora.

Ushtrime me Librin e nxënësit



Nxënësit duhet t'i plotësojnë vetë faqet 130.

Pyetje vlerësimi

- Sa është ora kur akrepi i madh tregon 12 dhe akrepi i vogël tregon 3?
- Sa është ora kur akrepi i vogël tregon 3 dhe akrepi i madh tregon 6?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Në disa orë, është e vështirë për nxënësit të dallojnë akrepin e orës dhe akrepin e minutave. Sigurohu ta dinë se akrepi i gjatë është i minutave dhe akrepi i shkurtër është i orës.

MATJA E VËLLIMIT

Libri i nxënësit faqe 70 – 71

Elementi matematikor: Format, hapësira dhe masat

Temat matematikore: Masat

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Nxënësi krahason dy ose më shumë vëllime me krahasim të drejtpërdrejtë; të krahasojmë dhe masim objektet duke përdorur njësitë standarde dhe jostandarde.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Nxënësit i kanë eksploruar tanimë mbushjen dhe derdhjen duke përdorur enë të ndryshme. Në këtë kapitull do të mësojnë të masin vëllimin duke përdorur njësi jostandarde matëse. Ata do të duhet të kryejnë detyra praktike për të konsoliduar njohuritë e tyre dhe që të mësojnë të krahasojnë vëllimin duke përdorur terminologjinë e saktë. Përdorimi i njësive jostandarde i lejon nxënësit të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve matematikore më komplekse, si: “Sa gota të vogla nxë kjo shishe?” Kjo do t'i ndihmojë të kuptojnë nevojën për njësitë standarde.

Fjalor


Vëllim, njësi, më shumë se, më pak se, litër.


Mjetet


Enë me madhësi të ndryshme; rërë ose ujë; një shishe një-litroshe me pije të ëmbël dhe një shishe 500 ml me të njëjtën pije.


Ide për mësimdhënie


Ushtrime praktike


 Përsërisni fjalorin e vëllimit me klasën. Zgjidh dy enë dhe mbaji lart. Pyesni nxënësit se cila mendojnë se do të nxërë më shumë. Kërkoju fëmijëve të tregojnë atë që mendojnë se do të nxërë më shumë. Shpjegoju se mund ta mësojmë duke e mbushur një enë dhe duke e zbrazur tek tjetra. Mbushni enën e vogël. Trego se është “plot”. Derdheni në enën tjetër dhe tregoji klasës se nuk është “plot”. Kjo do të thotë se mund të nxërë më shumë. Nëse është e nevojshme, përsëriteni këtë disa herë me enë të ndryshme.


 Tregoni duke mbushur një enë më të madhe duke përdorur një më të vogël. Vazhdo numëro se sa enë të vogla përdor. Mund t’i kërkonit një nxënësi që të bëjë mbushjen dhe të tjerët të numërojnë. Diskutoni se cila enë nxë më shumë dhe se çfarë do të ndodhte nëse do ta derdhnin ujin nga ena më e madhe tek më e vogla. Jepu nxënësve mundësinë të mbushin enë më të mëdha dhe të shënojnë njësitë që përdorin. Lëri t’i përdorin gota më të vogla, lugë, kapakë të vegjël, shishe më të vogla etj.

 Kërkoju nxënësve të shohin në gazeta dhe revista fotografi enësh mbajtëse. Lëri t’i presin fotografitë dhe t’i rendisin sipas vëllimit që nxënë, nga më e vogla tek më e madhja dhe e anasjella. Bëni postera në klasë.

 Kërkojuni nxënësve të gjejnë tre gjëra që nxënë më pak se një gotë dhe t’i vizatojnë. Po ashtu, mund t’u kërkonit të gjejnë në shtëpi tre gjëra që nxënë më shumë se një kovë dhe t’i vizatojnë.

 Krijoni disa ushtrime praktike me matje për nxënësit. Për shembull, mund t’u kërkonit të zgjidhin gjëra, si: “Sa gota mund të mbushni me këtë shishe?”, “Sa shishe duhen për të mbushur këtë kovë?”, “Sa lugë me rërë mund të nxërë kjo kuti?” etj.

 Tregojni nxënësve shisheet që keni sjellë në klasë. Diskutoni nëse më e madhja nxë njëlloj, më shumë ose më pak se dy të tjerat. Lëri t’i sugjerojnë se si mund ta kuptojmë.

 Mbush një shishe një-litroshe dhe tregojni klasës. Shpjego se kjo sasi quhet 1 litër. Ka shumë prodhime që mund t’i blejmë me nga një litër, si: uji, pijet e ëmbla, qumështi, lëngjet e larjes, akullorja etj. Pyesni nxënësit për prodhime të tjera që i kanë parë që shiten në enë një-litroshe.



Zbrazeni ujin nga një enë një-litroshe dhe hidheni në enë të tjera. Kërkoji klasës të thonë nëse secila enë nxë më shumë, më pak apo afërsisht një litër. Ata duhet të përdorin në këtë ushtrim kuptimin që kanë për konservimin. Nëse uji mbetet në shishen një-litroshe, do të thotë se ena nxë më pak se 1 litër, sepse nuk u kalua i gjithë litri. Nëse shishja 1-litroshe zbrazet, por ena tjetër nuk është mbushur plot, e dimë se ena tjetër ka nevojë për më shumë se një litër që të mbushet. Jepu nxënësve mundësinë të praktikojnë dhe eksplorojnë konceptet e “më shumë se”, “më pak se”, dhe “pothuajse një litër” përpara se të kalojnë tek ushtrimi në faqen 71.

Ushtrime me Librin e nxënësit



Plotësoni faqen 31 si një ushtrim udhëzues.



Nxënësit mund ta plotësojnë vetë faqen 32, duke vlerësuar se cilat enë mbajnë më shumë se, më pak se, ose pothuajse një litër.

Pyetje vlerësuese

- Cila enë është më e madhja?
- Cila enë është më e vogla?
- Cila enë nxë më shumë?
- Cila enë nxë më pak?
- Cila enë nxë pak?
- Cila enë nxë shumë?
- Sa nga këto enë duhen për të mbushur këtë enë?
- Çfarë do të ndodhte nëse e zbraz këtë në enë?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Disa nxënës kanë vështirësi ta kapin konceptin e vëllimit, prandaj duhet të bëni shumë ushtrime praktike që të zbuloni keqkuptimin e tyre. Për shembull, mbush një shishe me ujë dhe më pas këtë ujë hidheni në një legen. Rimbusheni shishen me ujë dhe pyesni: “Cili ka më shumë ujë, shishja apo legeni?”. Nxënësit që e kanë kapur konceptin e vëllimit do të jenë në gjendje të përgjigjen se kanë njësoj. Ata që nuk e kanë kapur, do të thonë shishja, sepse niveli i ujit në të është më i lartë. Ata që nuk e kuptojnë vëllimin, nuk janë gati të bëjnë ushtrimet që gjejnë se cila enë nxë më shumë ose më pak, dhe kanë nevojë për më shumë praktikë në këtë fazë.

NJËSITË JOSTANDARDE TË MASËS

Libri i nxënësit faqe 103, 110

Elementi matematikor: Forma, hapësira dhe masa

Temat matematikore: Masat

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Nxënësi krahason dy ose më shumë masa nëpërmjet krahasimit të drejtpërdrejtë; të krahasojmë dhe masim objektet duke përdorur njësitë standarde dhe jostandarde.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Ky kapitull vendos bazat për matjen e masës formalisht duke prezantuar një terminologji të thjeshtë dhe duke zhvilluar një kuptim fizik të masës. Nxënësve u duhet dhënë shumë eksperiencë për të krahasuar masën e objekteve dhe për të përdorur një peshore të thjeshtë balance. Kjo formon bazën e detyrave me matje në të ardhmen.

Fjalor


I/e rëndë, i/e lehtë, më e rënda, më e lehta, sipër, poshtë, balancë, po aq e rëndë sa.

Mjetet

Objekte të ndryshme për t'u matur; një peshore e thjeshtë balance; gogla për t'u përdorur si mjete matëse; çanta plastike me sasi të ndryshme rëre; një tufë banane; disa libra; një kuti lapsash; një shishe me ujë.

Ide për mësimdhënie

Ushtrime praktike

 Shfaqni një numër të caktuar objektesh. Kërkoju nxënësve të marrin çifte objektesh dhe të thonë nëse janë të rëndë apo të lehtë. Më pas duhet të krahasojnë masën e objekteve duke i mbajtur njërin në një dorë dhe tjetrin në dorën tjetër. Shpjegoni fjalët më i rëndë dhe më i lehtë. Vlerësimin se cili objekt është më i rëndë dhe cili më i lehtë mund ta bëni në peshore. Tregoni se objekti më i rëndë bën që balanca të ulet poshtë. Shkëmbeji objektet që t'u tregoni nxënësve se ndodh e njëjta gjë, pavarësisht anës ku e vendos objektin.



Jepi secilit grup një peshore balance dhe një çift objektesh që t' i peshojnë. Ata duhet të vlerësojnë se cilët objekte në secilin çift janë më të rëndë dhe më pas t' i peshojnë për të verifikuar vlerësimin paraprak.



Nxënësit të përdorin goglat si njësi matëse. Lërinë të gjejnë sende që kanë të njëjtën masë me një gogël, dy gogla, tre gogla, e kështu me radhë.



Jepi secilit grup një numër çantash plastike që kanë sasi të ndryshme rëre. Lërinë të diskutojnë se si mund t' i rendisin nga më e rënda tek më e lehta.



Nxënësit të gjejnë 4 gjëra që janë më të rënda se një laps, një karrige, një legen etj. Përsëriteni duke gjetur katër objekte që janë më të lehtë.

Ushtrime me Librin e nxënësit

Nxënësit mund të punojnë vetë me ushtrimin në faqen 33. Diskutoni vizatimet e tyre pasi t' u keni dhënë kohën e nevojshme për t' i plotësuar ushtrimet.

Përdorni pjesërisht faqen 34 si ushtrim praktik. Nxënësit do të duhet të vendosin një koleksion sendesh në njërën anë të peshores dhe më pas të vendosin nga ana tjetër aq sende sa duhen për të barazuar peshën. Inkurajoi të mendojnë se mund ta bëjmë peshën të njëjtë në mënyra të ndryshme.

Pyetje vlerësimi

- Çfarë mund të jetë më e rëndë se kjo?
- Çfarë mund të jetë më e lehtë se kjo?
- Çfarë mund të jetë po aq e rëndë sa kjo?
- Cila është më e lehta e këtyre?
- Cila është më e rënda e këtyre?
- A janë të gjitha të rënda apo të lehta?
- Si ta kuptojë se cili objekt është më i rëndë në një peshore me balancë?
- Sa gogla janë po aq të rënda sa një laps?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme



Nxënësit mund ta kenë të vështirë ta kuptojnë se masa e objektit nuk është e lidhur me madhësinë e objektit. Bëju shumë ushtrime praktike me gjëra të vogla të rënda dhe të mëdha të lehta që të mësohen me këtë ide.



Nxënësit mund ta kenë po ashtu të vështirë ta kuptojnë se përse objektet më të lehtë ngrihen lart në peshoren me balancë. Sigurohuni që të eksperimentojnë me këtë dhe të ndërgjegjësohen se çfarë po ndodh; jepu mundësinë të flasin për atë që shohin.

NUMRAT DERI NË 30

Libri i nxënësit faqe 35 – 39

Elementi matematikor: Numri

Temat matematikore: Numri dhe sistemi i numrave

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Brenda harkut nga 0 – 30, të themi numrin që është 1 ose 10 më shumë ose më pak se një numër i dhënë; të kuptojmë dhe përdorim fjalorin e vlerësimit deri në 30 objekte; të fillojmë të lidhim ndërmjet 10 dhe 20 kur i mbledhim me një numër njëshifror.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Në këtë kapitull, nxënësit do të zgjerojnë njohuritë për mbledhjen me numra më të mëdhenj. Këtë e bëjnë në fillim duke ndarë grupet; me fjalë të tjera, duke zgjidhur kombinimet e grupeve që mund të kombinohen për të ndërtuar secilën shumë. Në të njëjtën kohë, identifikojnë numrat në boshtin numerik për të gjetur përgjigjet për shumat e gjetura. Ata llogarisin dhe numërojnë shumata deri në 30 dhe identifikojnë vendvlerën e numrave dyshifrorë, duke përdorur tabelën e vendvlerës. Konceptet nuk janë të rinj, veçse po punojnë me numra më të mëdhenj, prandaj mund të jetë më e vështirë për disa nxënës.

Fjalor


Fjali me numra, shtoj, bosht numerik, shumë, mbledhje.


Mjetet


Grup me 30 objekte për secilin nxënës; dy kapakë ose enë të tjera për secilin nxënës; bosht numerik deri në 15 për secilin nxënës; kopsa.


Ide për mësimdhënie


Ushtrime praktike


 Krijoni një grup me 18 nxënës. Ndajini në djem dhe vajza. Kërkoji klasës ta shprehin këtë si fjali me numra. Për shembull, 7 vajza dhe 11 djem janë 18 gjithsej. Diskutoni mënyra të tjera për ta ndarë këtë grup. Sigurohuni që merrni si rezultat $1 + 17$, $2 + 16$, $3 + 15$, $4 + 14$, $5 + 13$.

 Jepi secilit nxënësi një grup me 18 objekte dhe dy enë. Vendosi t'i ndajnë objektet në sa grupe të mundën dhe të shënojnë rezultatet duke përdorur shenjat plus dhe baras. Duhet të shënojnë nga e majta në të djathtë, pra regjistrojnë $8 + 10$ dhe $10 + 8$. Përsëritini këta numra me 19 dhe 20.


 Luani lojën me marrjen e objekteve me grupe deri në 20 objekte. Nxënësit të punojnë në çift. Secili duhet të marrë objektet dhe të numërojë se sa ka në dorë. Ata duhet ta gjejnë se sa kanë pa numëruar. Këtë mund ta përshtatni duke lënë një nxënës të bëjë marrjen. Para se ai ose ajo të numërojë objektet, ata duhet të marrin me mend se sa kanë. Shpjego se supozimi i numrit quhet 'llogaritje'. Nxënësi më pas numëron dhe thotë se sa ka ai apo ajo dhe shoku thotë se sa duhen për të bërë një shumë të dhënë.


 Kërkoju nxënësve të numërojnë deri në 20 dhe të thonë se sa dhjetëshe ka (2 dhjetëshe).

 Pastaj pyet: “Sa bëhet nëse shtojmë edhe një objekt më shumë?” (21). Vendosi nxënësit të sistemojnë 21 numëruesit në një kuti të vendvlerës. Pyeti se sa dhjetëshe dhe sa njëshe janë. (2 dhjetëshe dhe 1 njëshe). Pastaj pyeti se çfarë ndodh nëse mbledhim $20 + 2$ (22). Vijoni deri në 30. Shkruani secilin numër në tabelë. Thekso numrin e dhjetësheve dhe njësheve dhe jepu mundësi nxënësve të paraqesin numrat në tabelën e vendvlerës.

 Kërkoji një nxënësi të thotë një numër ndërmjet 20 dhe 30. Pastaj pyeti: Sa bëjnë 10 më pak se ai numër? Tregoji klasës një bosht numerik dhe ta gjejnë duke numëruar mbrapsht. Shkruani numrin e ri në tabelë. Tregoji klasës se numri i ri është i njëjtë si i vjetri, por me 1 jo me 2 tek vendi i dhjetësheve. Përsëriteni me numra të tjerë. Bëni të njëjtën gjë me numra ndërmjet 10 – 20, por pyesni se sa është numri me 10 më shumë. Tregoni sërish se numri i ri ka 1 dhjetëshe më shumë tek vendi i dhjetësheve. Sigurohuni se nxënësit e kuptojnë këtë parim para se të punojnë me ushtrimet në libër.

Ushtrime me Librin e nxënësit

 Pasi të keni punuar me numra deri në 30, kërkojuni nxënësve të punojnë me faqen 35 për të konsoliduar njohuritë mbi formimin e numrit nga 21 në 30 duke përdorur dhjetëshe dhe njëshe. Ata mund të kenë nevojë për ndihmë teksa punojnë me këtë faqe.

 Në momentin që nxënësit janë familjarizuar me konceptin e koleksioneve me objekte, mund t'u jepni një grup kopsash për të llogaritur dhe numëruar për ushtrimin në faqen 36.



Faqja 37 u jep mundësi nxënësve të shkruajnë numrat në tabelën e vendvlerës. Pasi të keni demonstruar një shembull ose dy në tabelë, klasa duhet të jetë në gjendje të punojë vetë me këtë ushtrim. Ata duhet të numërojnë secilin grup sendesh, të identifikojnë se sa dhjetëshe dhe njëshe kanë numëruar, më pas të shkruajnë numrin.



Faqja 38 u jep mundësi nxënësve ta paraqesin secilin numër në mënyra të ndryshme. Punoni me disa shembuj të ngjashëm në tabelë, më pas kërkoju nxënësve të punojnë vetë me këtë faqe.



Faqja 39 u jep mundësi nxënësve të gjejnë sa është 10 më pak dhe 10 më shumë se një numër i dhënë. Shpjego se një pako me ëmbëlsira ka 10 ëmbëlsira. Ëmbëlsirat e veçanta janë njëshet. Nxënësit mund të përdorin fotografitë në vend të numëruesve për të gjetur përgjigjen.

Pyetje vlerësimi

- Më jepni 2 numra shuma, e të cilëve është 22. Më jepni numra të tjerë që e kanë shumën 22.
- Sa dhjetëshe ka ky numër? Sa njëshe?
- Cili numër është 1 më pak/një më shumë se...?
- Cili numër është 10 më shumë/më pak se ...?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Disa nxënës e kanë të vështirë të vijojnë me numërimin, prandaj duhet të numërojnë grupin e parë në secilin rast. Duhet ta sugjeroni këtë kur keni të bëni me materiale konkrete duke numëruar në vijimësi prej grupit të parë që të duket si një proces natyral vijimi prej atij numri objektsh.

LIBRI I NXËNËSIT 1C

MODELET DHE FIGURAT

Libri i nxënësit faqe 128

Elementi matematikor: Numri; zgjidhja e problemave

Temat matematikore: Numrat dhe sistemi i numrave; modelimi

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Formoni dhe përshkruani modele dhe vargje të thjeshtë numrash duke përdorur terminologjinë matematikore; zgjidhni problema të thjeshta ose enigma dhe parashikoni nëpërmjet modeleve të thjeshta dhe marrëdhënieve; formo e përshkruaj modelet dhe figurat, dhe fillo të lidhësh trupat gjeometrikë me figurat e tyre.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Në Librin 1A, nxënësit plotësuan dhe krijuan modele të përsëritshëm duke përdorur paraqitjen vizuale të numrave (o pika dhe forma). Këtu e zgjerojnë këtë njohuri duke plotësuar dhe formuar modele numerike.

Fjalor


Model, përsërit, numër, një më shumë, një më pak, fillo sërish.


Mjetet


Numërotore; kartonë me numra; plastelinë; objekte nga jeta reale që janë ndërtuar me trupa gjeometrikë – tulla, blloqe, sfera; prerje katrorësh; katërkëndësha, rathë dhe trekëndësha.


Ide për mësimdhënie


Ushtrime praktike


 Krijoni një model të thjeshtë duke përdorur blloqe të ngjyrosur: bllok i kuq, bllok blu, bllok i kuq, bllok blu, bllok i kuq. Pyet: “Bllokun me cilin ngjyrë do të vendosë në vijim? (Duhet të përgjigjen blu.) Pyesni nxënësit të thonë se si e dinë këtë. Ata duhet ta shpjegojnë modelin me fjalorët e tyre.

 Kërkoji një nxënësi të dalë para klase dhe të ndërtojë një model duke përdorur blloqe me dy ngjyra. Kërkoji një nxënësi tjetër të dalë dhe ta vijojë modelin. Sërish, kërkoji nxënësit të dytë të shpjegojë modelin me fjalët e tij.


 Përsëriteni ushtrimin duke përdorur blloqe me tre ngjyra. Pastaj përsëriteni duke përdorur prerje figurash (në fillim dy figura, më pas tre). Më pas mund të bëni një ushtrim të ngjashëm duke përdorur kartonët me numra.

 Mund t'u jepni nxënësve kartonë me numra dhe t'u kërkonti t'i sistemojnë në një model të përsëritshëm. Lërimi të gjejnë mënyra për të krijuar modele të ndryshëm duke përdorur të njëjtët kartonë me numër.

 Jepu nxënësve plastelinë. Kërkoju të formojnë një formë topi. Pyeti se cilët objekte në jetën reale kanë atë formë. Pastaj tregoju një bllok. Pyeti se si mund ta bëjmë topin bllok. Lëri ta bëjnë këtë duke sheshuar një rën anë të topit dhe pastaj anën e kundërt, pastaj anët e tjera derisa të kemi gjashtë faqe katrore. Kujtoji që këto quhen “faqe” dhe lërimi t'i numërojnë. Kërkojuni të identifikojnë, si cilat figura të prera përputhen me kubin e sapo bërë? Ata duhet të identifikojnë katrorët. Zgjedhjet e tyre mund t'i kontrollojnë duke i puthitur figurat e prera më formën e plastelinës.

 Tregoju një kuti në formë kubike dhe vendosi ta bëjnë këtë trup me plastelinë. Pastaj zgjidh sërish figurat e prera për t'u përputhur me faqet. Këtë mund ta bëni edhe me një trup cilindër dhe me një prizëm trekëndor. Në këtë fazë, nxënësit nuk është e domosdoshme të dinë termat për këta trupa.

Ushtrime me Librin e nxënësit

 Faqja dy u mundëson nxënësve punën me modelet e numrave. Punoni ushtrimin e parë bashkë me ta, pastaj le t'i plotësojnë vetë. Ndoshta duhet t'i nxënësit për të formuar modelet e veta.

Faqja 3 përfshin modele figurash. Nxënësit identifikojnë se çfarë lloj figure shohin në tabelë dhe më pas vizatojnë figurën. Kini parasysh se nuk kanë pse të dinë emrat e figurave, megjithëse tani mund të jenë në gjendje të identifikojnë disa, si: katrorët, katërkëndëshat, rrathët dhe trekëndëshat.

Pyetje vlerësimi

- Blloku me cilën ngjyrë/numër/formë vjen më pas?
- Si e dini këtë?
- Në çfarë mënyre tjetër mund t'i organizojmë blloqet/ngjyrat/numrat në një model?
- Ndërtoni një model ku përdorni të njëjtin, trup por e ktheni në mënyra të ndryshme çdo herë.
- Bëni një model ku shtoni një tek secili numër.

- Bëni një model ku shtoni 2 tek secili numër.
- Bëni një model ku shtoni 3, pastaj hiqni një nga numri tjetër.
- Çfarë figure/trupi shihni në fotografi?
- A duket njësoj në jetën reale? Sa është e ngjashme/e ndryshme?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Kur nxënësit formojnë modelet e tyre, duhet t'i kontrollojnë për të parë nëse funksionojnë. Për shembull, nëse fillojnë me numrin pesë dhe përdorin një rregull të zbritjes së 2, do të mbeten me një pas vetëm dy hapash. Është shumë herët për nxënësit të fillojnë të punojnë me numrat negativë. Prandaj, nëse do të bëjnë rregulla për zbritjen, duhet të fillojnë me përgjigjen e fundit në model dhe të punojnë mbrapsht, duke e kthyer veprimin në secilën herë.

KLASIFIKIMI

Libri i nxënësit faqe 5 – 7

Elementi matematikor: Të dhënat

Temat matematikore: Listat dhe tabelat

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të zgjidhim problema të rëndësishme, duke përdorur lista dhe tabela të thjeshta, objekte dhe fotografi për t'u klasifikuar, të klasifikojmë dhe organizojmë informacionin; të shpjegojmë metodat dhe arsyetimin

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Ky ushtrim përforcon konceptet e prezantuar në faqet 30 dhe 31 të Librit 1A. Referojuni faqeve 33 – 34 të këtij Libri për më shumë informacion mbi këtë temë.

Fjalor

Mace, lepuj, peshq, zogj, kafshë, furçë, njësoj, i ndryshëm, zgjidh, rrumbullakos, i gjatë, i shtrembër, tjetër, gjethe.

Mjetet

Fotografi kafshësh; fotografi ose shembuj të ndryshëm gjethesh; disa shembuj gjërash të ndryshme veshmbathjeje.

Ide për mësimdhënie

Ushtrime praktike



Mund të përsërisni secilin nga këto ushtrime në faqet 33 – 34 të këtij libri nëse u duhet të përforconi temën.



Në përgatitje për faqen 7, tregoji klasës koleksionin e artikujve të ndryshëm të veshmbathjes. Kërkoju të identifikojnë se cilët janë për gra/burra/vajza/djem. Pastaj kërkoju të sugjerojnë mënyra të tjera se si mund t'i klasifikojmë rrobat (të sipërme; të poshtme; të ngrohta të ftohta; sportive dhe formale; sipas ngjyrave etj.).

Ushtrime me Librin e nxënësit



Nxënësit ta plotësojnë vetë faqen 5. Ata duhet të numërojnë secilin artikull ose kafshë, pastaj të plotësojnë kutizat për të përmbledhur informacionin e treguar në figura.

Faqja 6 është një ushtrim më praktik; nxënësit bëjnë koleksionin e tyre të gjetheve dhe i klasifikojnë sipas tipareve që shohin. Nëse është e nevojshme, nxënësit mund të vizatojnë një version më të madh të tabelës në fletoren e tyre të ushtrimeve, ose mund të bëjnë një poster për të futur gjethet. Ose mund të vendosni të bëni një poster të madh që do të përfshinte gjethet e të gjithë klasës. Vendosni vetë se çfarë do të ishte më tërheqëse për klasën.

Faqja 7 u jep nxënësve mundësinë të klasifikojnë dhe riklasifikojnë një koleksion në forma të ndryshme. Ndoshta do ju duhet të vizatojnë një tabelë tjetër në fletoren e ushtrimeve nëse do të duan t'i klasifikojnë veshjet në mënyra të ndryshme.

Pyetje vlerësimi

- Sa mace janë në fotografi?
- Sa lepuj/peshq/zogj?
- Sa gjethe të rrumbullakëta gjetët?
- Sa gjethe të gjata gjetët?
- Çfarë lloj gjetheje është kjo? Po kjo? Po kjo?
- Si mund ta kategorizojmë këtë gjethe (duke treguar se nuk është e rrumbullakët, as e gjatë, as e përthyer)?
- Në çfarë mënyre tjetër mund t'i grupojmë rrobat?
- A përshtaten të gjitha rrobat me këto grupe? Përse, ose përse jo?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Sigurohuni që nxënësit ta kuptojnë se jo të gjitha gjërat mund të përshtaten lehtësisht me një kategori të veçantë, dhe se ne ndoshta duhet të shpikim kategori si “të tjera” për këtë arsye.

VENDNDODHJA, LËVIZJA DHE DREJTIMI

Libri i nxënësit faqe 111– 112

Elementi matematikor: Forma, hapësira dhe masat

Temat matematikore: Vetitë e vendndodhjes dhe lëvizjes

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Përdorni gjuhën e përditshme për të përshkruar vendndodhjen, drejtimin dhe lëvizjen.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive


Nxënësit mësojnë të përshkruajnë vendndodhjen dhe të japin drejtime duke përdorur termat: “lart”, “sipër”, “afër”, “përmes”, “poshtë”.

Mjetet

Materiale të ndryshme si: tuba të mëdha plastike, kosha, kone trafiku, qese plehrash, e kështu me radhë; karrige dhe tavolina; kartonë me emrat e të gjithë objekteve të sipërpërmendur.

Ide për mësimdhënie

Ushtrime praktike

 Nxirri nxënësit jashtë. Krijoni një pistë me pengesa duke përfshirë pengesa të cilat duhet t’i kalojnë poshtë, sipër, përreth, nëpër to etj. Ndani nxënësit në dy skuadra. Një nxënës nga secila skuadër duhet të kalojnë pistën njëkohësisht. Teksa anëtari i skuadrës mbaron pistën, fillon tjetri dhe kështu gara bëhet me stafetë. Pjesa tjetër e skuadrës duhet të thotë me zë të lartë drejtimet për të ndihmuar anëtarët e skuadrës.

 Kthehuni në klasë. Vendos përpara klasës një karrige. Kërkoji dikujt të

qëndrojë në një vendndodhje që mund të jetë anës karriges. Bëj të njëjtën gjë me drejtime dhe vendndodhje të ndryshme: “poshtë karriges”, “në karrige”, “pas karriges” etj., derisa të jeni të kënaqur se nxënësit e kuptojnë fjalorin e vendndodhjes dhe drejtimit.



Ndaji nxënësit të punojnë në grupe treshe. Nxirr një grup vullnetar që të tregojë vendndodhjet dhe drejtimet. Jepu pesë nxënësve nga një karton. Kërkoju të lexojnë kartonët. Për secilën fjalë, grupi demonstrues duhet të vendoset në vendndodhjen e kërkuar. Për shembull, dikush mund të lexojë “sipër”. Grupi i demonstrimit duhet të hipë kaliç në shpinën e njëri-tjetrit dhe të thonë: «Ana do hipë sipër Borës», «Tani Bora po hipën sipër Elës», e kështu me radhë.

Ushtrime me Librin e nxënësit



Faqja 8 u jep mundësi nxënësve të përforcojnë fjalorin e vendndodhjes. Lërimi të punojnë vetë me këtë faqe.



Faqja 9 përforcon fjalorin e drejtimit. Lërimi nxënësit të punojnë në çifte dhe të bisedojnë me zë të lartë për drejtimet që duhet të ndjekë djali për të kaluar garën me pengesa.

Pyetje vlerësimi

A jam para apo pas karriges?

- Jam poshtë apo sipër karriges?
- Kush qëndron në krah të Benit?
- Kush po qëndron në krah të Mirës?
- Më tregoni një vendosje kur një person është poshtë karriges dhe një tjetër është në krah të tij.
- Më tregoni në grupin tuaj një person që po ecën rreth të tjerëve.
- Në pistën me pengesa, cilës pjesë mund t’i kaloni sipër?
- Ku duhet të kërceni?
- Ku duhet të uleni poshtë?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Vendndodhjet nuk janë absolute, janë relative. Për shembull, kur krijoni një kullë me tulla, shumica e tullave janë sipër një tulle dhe poshtë një tjetre. Prandaj është e rëndësishme të bëni gjithmonë pyetje për vendndodhjen në kontekst të caktuar, për shembull: “Çfarë ka poshtë tavolinës?», «Çfarë ka në krye të bufesë?» etj.

NUMËRIMI DHE KRAHASIMI I NUMRAVE DERI NË 30

Libri i nxënësit faqe 10 – 14

Elementi matematikor: Numri

Temat matematikore: Numrat dhe sistemi i numrave

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Ndërmjet 0 dhe 30, thuaj numrin që është 1 ose 10 më shumë ose më pak se një numër i dhënë; krahasoni dhe rendisni numrat deri të paktën 20.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Ky kapitull përforcon njohuritë me numrat me të cilët nxënësit kanë punuar tashmë dhe paraqet simbolet $>$ dhe $<$ për “më e madhe se” dhe “më e vogël se”.

Fjalor


Emrat e numrave nga një në 30, më i madh se, më i vogël se, tjetri, para, prapa, i barabartë me.


Mjetet

Numëratore, kopsa, gurë, një kukull dore me gojë të lëvizshme.


Ide për mësimdhënie

Ushtrime praktike

 Praktikoni duke numëruar me zë të lartë bashkë me klasën deri në 30 duke përdorur numëratoren. Kërkoji një nxënësi të lëvizë goglat në numëratore deri kur të arrijmë në 10; pastaj në rreshtin tjetër t’i lëvizë goglat derisa të arrijmë në 20 $<$ pastaj në rreshtin tjetër derisa të arrijmë në 30. Pyesni sa herë që plotësohet një dhjetëshe, se sa dhjetëshe keni kaluar.

 Vendosi nxënësit në një rreth. Personi që nis këtë lojë shënjon me gisht dikë në rreth dhe thotë një numër (mund të filloni me një ose me numra të tjerë në varësi të madhësisë së numrave që doni të shpjegoni). Personi që u shënjua thërret një numër tjetër dhe shënjon dikë tjetër në grup. Kur secili nga shënjesit shënjon dikë, duhet ta mbajë dorën në kokë dhe të mbajë vendndodhjen e shënjjimit teksa vazhdon loja. Kjo e ndihmon grupin të dallojë se kush e kishte

kaluar njëherë radhën. Kur të gjithë ta kenë pasur nga një herë radhën, personi i fundit i shënjuar, kthehet dhe shënjon atë që e filloi. Të gjithë duhet të kujtojnë se kush i shënjoji dhe kë shënjuan dhe t'i ulin duart në atë anë. Cikli përsëritet pa shenjim. Kjo është një lojë e mirë kujtuese.

 Paraqit shenjat $>$ dhe $<$ për të paraqitur më e madhe se dhe më e vogël se. Këtë mund ta bëni duke vendosur dy grupe objektesh: 10 dhe 15 përkatësisht. Përdorni një kukull dore. Thuaj se kukulla është e uritur. Ajo dëshiron të hajë grupin më të madh të objekteve. Cilin duhet të hajë? Kërkoju nxënësve të numërojnë grupet e objekteve dhe të thonë se cili është më i madhi. Hapi kukullës gogjen në drejtim të grupit më të madh.



Shpjego se goja e uritur hapet gjithnjë në drejtim të numrit më të madh. Vizatoje në tabelë:

$10 < 15$ 10 është më e vogël se 15

$15 > 10$ 15 është më e madhe se 10



Vendosi nxënësit të praktikohen me shenjat $<$ dhe $>$ duke përdorur objekte dhe role të caktuara me kukullën, pastaj duke shkruar fjalitë në tabelë.

Ushtrime me Librin e nxënësit



Nxënësit plotësojnë faqet 10 dhe 11 dhe praktikohen duke numëruar para dhe prapa deri në 30. Faqja 11 trajton edhe numrat 10 më shumë ose më pak se një numër i dhënë. Nëse është e nevojshme mund të vizatoni boshte numerik në tabelë për të ndihmuar nxënësit me këto ushtrime.



Faqja 12 paraqet problema me mbledhje, por koncepti kryesor i mësuar në këtë kapitull është numri. Si ushtrim shtesë, vendosi nxënësit të bëjnë 10, pastaj 20, pastaj 30 në mënyra të ndryshme me grupet me objekte, gogla apo gurë për të modeluar shumatat e tyre. Padyshim që ka më shumë se katër mënyra të mbledhuri për të gjetur shumën, kështu që është ide e mirë që nxënësit të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit, pasi kjo do t'ju japë mundësinë për të testuar shumata më të mëdha mbledhjesh dhe të kuptojnë se ka shumë mënyra për të zgjidhur një problemë të dhënë.



Faqja 13 dhe 14 u jep mundësinë nxënësve të punojnë me shenjat $<$, $>$ dhe $=$. Pasi të kenë punuar me ushtrimet praktike të mësipërme, lërin të punojnë me këto.

Pyetje vlerësimi

- Cili numër është pas ...?
- Cili numër është para...?
- Numëroni prej ...
- Numëroni pas prej ...
- Cili nga këta dy numra është më i madhi?
- Cili nga këta dy numra është më i vogli?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Përdorimi i simboleve $<$ dhe $>$ mund të jetë i ngatërruar ndonjëherë për nxënësit. Nuk keni pse të theksoni emrat e simboleve, vetëm përqendrohuni në faktin se fundi i hapur i simbolit hapet ndaj shumës më të madhe.

MBLEDHJA DHE ZBRITJA

Libri i nxënësit faqe 15 – 18

Elementi matematikor: Numri

Temat matematikore: Veprimet

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Nxënësi kupton mbledhjen dhe përdor fjalorin përkatës, kuptojmë zbritjen si heqje dhe diferencë dhe përdor fjalorin përkatës.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Nxënësit praktikohen duke shtuar apo hequr objekte fizikisht në grup apo nga një grup dhe konsolidojnë konceptin abstrakt të mbledhjes si numërim para dhe të zbritjes si numërim mbrapa. Ata përforcojnë gjithashtu kuptimin se mbledhja mund të bëhet në çfarëdo radhe dhe se kjo veti mund të përdoret për ta bërë mbledhjen më efektive – për shembull, mbledhja e një numri më të madh me një numër më të vogël na lejon shpeshherë të mbledhim më shpejt.

Zbritja është veprim. Këtë mund ta theksoni duke u treguar nxënësve shumë ushtrime praktike dhe duke e stimuluar fizikisht lëvizjen e heqjes.

Nxënësit do t'i zgjerojnë aftësitë e mbledhjes dhe zbritjes me numra më të mëdhenj dhe do të punojnë me problema me fjalë.

Fjalor


Më shumë, plus, shumë, mbledh, më pak, hiq, lëviz, mbetet, minus, zbrit, baras.


Mjetet


Gur të vegjël; numërues të vegjël; zare me numrat nga 0 deri në 6; bosht numerik nga 0 – 10; grupe kartonësh me numra nga 0 – 30; kartonë me figura; kartonë me plus, minus dhe baras; bosht numerik i vizatuar në tokë jashtë (0 – 30).


Ide për mësimdhënie


Ushtrime praktike

 Jepi secilit grup dhjetë gurë. Nxënësit duhet të rrëmbejnë disa gurë nga grumbulli për të bërë një grumbull tjetër. Shpjegoju se po “heqin” këtë sasi për të gjetur se sa do të mbeten. Nxënësit duhet të diskutojnë se si ta bëjnë këtë dhe të gjejnë mënyra për të gjetur tepricën. Vendosi të numërojnë gurët që kanë mbetur. Pastaj vendosi të përdorin të njëjtët numra për të bërë një barazim me mbledhje, për shembull, nëse gjetën $10 - 6 = 4$, mund të përdorin të njëjtët numra për të bërë një barazim me mbledhje $4 + 6 = 10$.


 Nxirreni klasën jashtë për të përdorur boshtin numerik në tokë. Lërimi të qëndrojnë në fund të boshtit ose në një numër tjetër fillestar që ua përcaktoni ju. Shpjegoju se do të lëvizin në bosht aq herë sa numri që do të bjerë nga zari. Hidhni zarin për të marrë një numër 0 – 5. Kërkoju nxënësve të thonë se ku mendojnë se do të shkojnë. Lërimi të lëvizin aq herë në bosht për ta kontrolluar. Përfshini zeron. Përsëriteni lojën, por punoni në të kundërt (zbritja).

 Jepi secilit nxënës nga një bosht numerik 0 – 10. Bëni lojëra ku ju u thoni pikën e nisjes dhe sa vende të lëvizin. Ata duhet të bërtasin kur mbërrijnë tek vendi dhe të bëjnë lëvizjet për ta vërtetuar. Përsëriteni këtë disa herë me pika të ndryshme nisjeje duke përfshirë zeron. Mund t’u thoni edhe të lëvizin zero vende, në mënyrë që të shpjegoni konceptin e zbritjes me zero.


 Jepi secilit grup një grumbull me nga dhjetë objekte. Kërkoju nxënësve të rrëmbejnë një dorë me objekte dhe t’i numërojnë. Pastaj hedhin disa dhe llogarisin sa ju kanë mbetur. Lërimi t’i numërojnë për të verifikuar nëse llogaria e tyre ishte e saktë.


 Jepi secilit nxënës një grup me kartonë fëmijësh dhe me kartonë me figura. Kërkoju nxënësve të zgjidhin nga një karton nga secili grumbull. Tani duhet të


bëjnë një histori me kartonët që u kanë rënë. Për shembull, nëse zgjedhin një karton me tre fëmijë dhe një karton me pesë Mango, mund të thonë: «Kemi pesë Mango dhe tre fëmijë, nëse i japim secilit nga një Mango, dy do të na mbesin».

 Jepi secilit çift nxënësish dy grupe me kartonë (0 deri në 10 dhe 11 deri në 20) dhe nga një karton me plus, minus dhe baras. Kërkoju të tërheqin nga një karton nga secili grumbull dhe të zgjedhin një simbol. Nëse janë duke përdorur zbritjen, duhet të dinë se cili numër mund të zbritet nga tjetri. Lërinë të bëjnë një barazim duke përdorur shenjat e veprimit. Mund t'i kopjojnë këto në fletoren e ushtrimeve dhe të shënojnë përgjigjet.

Ushtrime me Librin e nxënësit

 Për ushtrimin në faqen 15, nxënësit mbledhin bashkë pikat nga të dyja anët e gurit të dominosë. Demonstrojeni duke shkruar një barazim dhe duke mbledhur, pastaj duke shkruar të njëjtin barazim me numrat në rend të ndryshëm.

 Në faqen 16, një bosht numerik paraqitet në dy boshte, në mënyrë që të vendosen të gjithë numrat deri në 30. Numëroni në boshtin numerik. Demonstroni për nxënësit disa shembuj të mbledhjes duke numëruar në boshtin numerik.

 Nxënësit të punojnë në çift për të plotësuar faqet 17 dhe 18. Lejojini të modelojnë problemat duke përdorur numëruesit.

Pyetje vlerësimi

- Nëse mbledh ... dhe ... sa kam gjithsej?
- Nëse filloj tek 10 në boshtin numerik dhe numëroj ... ku do të mbërrijë? Kontrollloje.
- Sa kanë mbetur?
- Sa mbeten nëse heq ...?
- Sa kam tani...?
- Sa mbeten nëse heq ... më shumë?
- Sa duhet të zbres për të pasur ...?
- Sa duhen zbritur nga ... për të mbetur ...
- Sa janë gjithsej?
- Sa e sa bëjnë ...?
- Sa bëjnë gjithsej nëse mbledh... dhe ... ?
- Sa kam tani...?
- Çfarë ndodh nëse shtoj ... më shumë?
- Çfarë numrash mbledhim për të dhënë ...?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Disa nxënës mund të jenë ende konfuz për zbritjen e numrit më të vogël nga numri më i madh, dhe disa mund të jenë konfuz me mbledhjen dhe zbritjen e zeros. Referojuni pjesëve të mëparshme për ushtrime që do të sqaronin këtë çështje.

TRUPAT DHE FIGURAT

Libri i nxënësit faqe 19 – 23

Elementi matematikor: Forma, hapësira dhe masat

Temat matematikore: Modelet dhe vetitë e figurave dhe trupave

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Nxënësi përdor gjuhën e përditshme për të përshkruar vetitë e trupave dhe figurave gjeometrike të njohura, si: faqet, këndet dhe brinjët; të bëjmë dhe përshkruan modelet dhe figurat dhe të fillojnë të lidhim trupat me fotot e tyre.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Nxënësit luajnë me trupat gjeometrikë në mënyrë që të familjarizohen me vetitë e tyre. Objektivi është që nxënësit të bëjnë dallimin ndërmjet trupave kryesor – kub, kuboid, kon, cilindër dhe sferë – në kuptimin e vetive të tyre gjeometrike e madhësisë dhe formës. Ata mësojnë gjithashtu të identifikojnë faqet dhe brinjët e trupave, këndet dhe brinjët e figurave gjeometrike. Kini parasysh se nuk kanë pse të dinë emrat e saktë gjeometrikë për këto figura dhe trupa. Nxënësit mund t'u referohen ende sferave, si topa dhe kuboidëve, si kuti.

Në fillim, do të vijojnë të punojnë me njohuritë e klasifikimit para – numëror në mënyrë që të krahasojnë dhe klasifikojnë trupat gjeometrikë. Në fillim, ky klasifikim me gjasë do të bëhet mbështetur në një cilësi, përkatësisht madhësia ose forma. Gjithsesi, teksa i njohin më mirë trupat, do t'i klasifikojnë duke përdorur kriteret e veta dhe po ashtu cilësitë më vete ose së bashku (madhësinë dhe formën).

Pastaj, mësojnë se trupat përbëhen nga faqe, që në vetvete janë figura. Qëllimi është që të jenë në gjendje të dallojnë figurat e njohura (në këtë fazë nuk është e domosdoshme të dinë emrat e katrorit, katërkëndëshit, rrethit, trekëndëshit) dhe të eksplorojnë vetitë e tyre. Ata do të eksplorojnë gjithashtu se si figurat mund të vendosen bashkë për të krijuar figura të tjera.

Teksa nxënësit zhvillojnë njohuritë për faqet dhe figurat, do të përftojnë më shumë dije rreth trupave gjeometrikë.

Fjalor

I rrumbullakët, rrotulloj, i shënjuar, i vogël, më i vogël, i madh, më i madh, i hollë, më i hollë, i trashë, më i trashë, në krye, poshtë, në krah të, njësoj, i ndryshëm, njëlloj si, mbyll, lidh, i ngjashëm.

Mjetet

Gogla, kuti, cilindra, kon, materiale të tepërt dhe paketim për të bërë një model; plastelinë për të bërë trupa; kartonë me figura dhe trupa; koleksion me objekte të vegjël e të mëdhenj.

Ide për mësimdhënie

Ushtrime praktike



Shihni faqen 23 – 24 në këtë libër. Përdorni ushtrime të ngjashëm praktik në mënyrë që të përforconi vetitë e trupave gjeometrikë.



Sfidoni nxënësit që të identifikojnë trupa në mjedisin e hapur. Në fillim, kjo mund të kufizohet në klasë apo shkollë, por mund të zhvillohet edhe si detyrë shtëpie. Nxënësit duhet të pyeten të shpjegojnë format e disa gjërave.



Nxënësit mund të bëjnë një vëzhgim të shkollës për të identifikuar trupa të ndryshëm dhe për të shpjeguar se si përdoren.



Nxënësit të punojnë në çifte. Njëri nxënës përshkruan format e faqeve të një trupi dhe tjetri duhet të emërtojë trupin.



Nxënësit mund të bëjnë një fletore ku ngjisin fotot e trupave gjeometrikë, të prerë nga revistat dhe publikime të tjera. Nxënësve duhet t'u kërkohet të sjellin revistë në shkollë para këtij ushtrimi.



Nxënësit mund të presin një figurë të thjeshtë për të bërë të tjera. Për shembull, një katror mund të pritet për të bërë katër trekëndësha, një katërkëndësh mund të pritet për të bërë një katror dhe një katërkëndësh të vogël etj.



Nxënësit të presin dhe të përdorin figura të thjeshta (katrorë, katërkëndësha, trekëndësha, rathë) dhe t'i përdorin për të bërë trupa. Sfidoni secilin nxënës për të krijuar një pikturë duke përdorur vetëm këto forma dhe për t'i përdorur ato si pjesë e një shfaqjeje mbi trupat dhe figurat.

Ushtrime me Librin e nxënësit



Faqja 19 u jep mundësinë nxënësve të lidhin secilin trup gjeometrik me objekte nga jeta reale të së njëjtës formë. Ngjashmërisht, faqja 20 u kërkon nxënësve të ngjyrosin me të kuqe të gjitha sferat, konet me të verdhë, cilindrat me blu dhe kuboidët me të gjelbër. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të punojnë vetë me këto ushtrime të thjeshta. Shikojini bashkë këto ushtrime pasi t'i mbarojnë dhe bisedoni se si e gjetën se cilët trupa të lidhin.



Faqet nga 21 – 23 merren me figurat gjeometrike. Sigurohuni që nxënësit të jenë familjarizuar me emrat e figurave (katror, katërkëndësh dhe trekëndësh) përpara se të plotësojnë këto ushtrime.

Pyetje vlerësimi

- Cili objekt lidhet me këtë figurë?
- Cili objekt ka një faqe katrore?
- Cili objekt ka faqe një rreth?
- Cili objekt ka faqen një katërkëndësh?
- Cilat figura janë faqet e këtij trupi?
- Sa brinjë ka një trekëndësh/katror/katërkëndësh?
- Çfarë mund të shihni në klasë që ka formën e një katrori/katërkëndëshi?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Nxënësit mund të mendojnë se brinjët janë vetëm të drejta dhe mund të kenë vështirësi të identifikojnë brinjët e figurave të përthyer. Në fakt, një rreth ka vetëm një brinjë të përthyer.

PARATË

Libri i nxënësit faqe 24 – 26

Elementi matematikor: Paratë

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Nxënësi zgjidh problemat në kontekste të jetës reale si ato me paratë; njeh monedhat me vlera të ndryshme; di me saktësi se si të paguajmë shumën e duhur duke përdorur monedha të vogla.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Shumica e nxënësve tregojnë një kuptim të sofistikuar të parave dhe mund të jenë në gjendje të punojnë me shuma më të mëdha parash sesa mund të bëjnë me llogaritjet e zakonshme.

Trajtimi i parasë është një aftësi thelbësore në jetë; të gjithë duhet të njohim vlerën e monedhave dhe kartëmonedhave në paranë tonë. Në këtë fazë, ky është i vetmi aspekt i parave që do të trajtojmë, pavarësisht se nxënësit do të bëjnë edhe llogaritje të thjeshta me paratë.

Fjalor


Para, monedhë, vlerë, njësi, lek, qindarkë, emri i monedhave.


Mjete


Shembuj monedhash.

Ide për mësimdhënien

Ushtrime Praktike

 Inkurajoni nxënësit të tregojnë përvojat e tyre me paranë. Kjo ju mundëson të prezantoni dhe përforconi termat «monedhë» dhe të dalloni se sa shumë dinë ata tanimë. Pyetini të thonë se cila mendojnë se është një shumë e madhe parash dhe cila mendojnë se është një shumë e vogël parash.

 Merrni shembuj të të gjitha monedhave për t'ua treguar nxënësve. Kaloji monedhat nëpër klasë dhe kërkoju t'i përshkruajnë kur i kanë në dorë. Për shembull, kjo është monedhë 10L, është ngjyrë ari, ka një figurë në të. Përsëriteni këtë për të gjitha monedhat. Përdorni fjalët “qindarkë” dhe “monedhë” në mënyrë të rregullt. Sigurohuni që mund ta lexojnë fjalën qindarkë dhe lek. Bisedoni për simbolet e përdorur në monedha pasi kjo i ndihmon të njohin paratë.

 Bëj disa lojëra me fërkimin e monedhave. Vendosni një copë letër mbi monedhë dhe fërkojeni lehtë më laps. Nëse preferoni, nxënësit mund t'i presin këto dhe të bëjnë monedha të pavërteta.

VENDNDODHJA DHE LËVIZJA

Libri i nxënësit faqe 27 – 31

Elementi matematikor: Forma, hapësira dhe masat.

Temat matematikore: Vetitë e vendndodhjes dhe lëvizjes

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Nxënësi përdor gjuhën e përditshme për të përshkruar vendndodhjen, drejtimin dhe lëvizjen; kupton kthesën, gjysmë kthesën, kthesën e plotë dhe këndin e drejtë.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Nxënësit japin dhe marrin drejtime duke përdorur fjalë të posaçme drejtuese. Në këtë fazë, puna me vendndodhjen dhe me drejtimet është e bazuar në kontekste të jetës reale. Gjithsesi, formon një përgatitje të rëndësishme dhe një bazë për punën e mëtejshme gjeometrike duke përfshirë dhe transformimet: rrëshqitjen (zhvendosje) kthesat (rrotullime) rrokullisje (pasqyrime). Rrotullim i plotë përdoret në libër por në gjuhën e përditshme përdoret kthesë e plotë. Kini parasysh se termat janë të ndërkëmbyeshëm prandaj është e rëndësishme të përdoren të dy në mënyrë që nxënësit të kuptojnë se do të thonë të njëjtën gjë.

Fjalor


Kthesë, kthesë e plotë, rrotullim i plotë, gjysmë rrotullim, përreth, para, prapa, përpara, prapa, lart, poshtë, në anë të, në krye të, poshtë, sipër, anash.

Mjetet


Kartonë me fjalë drejtimi të renditura në fjalorin e mësipërm; kukulla; letra të prera; dy shirita kartoni të bashkuara me një kapëse për të treguar këndin e drejtë.


Ide për mësimdhënie


Ushtrime praktike

 Ngrini lart kartonët (ose shkruani fjalët në tabelë) për fjalët lart, poshtë, anash, përreth, përpara, prapa. Tregoji klasës një kukull. Pyesni fëmijët të përshkruajnë rrugën në të cilën po lëviz kukulla. Ngrini kukullën lart (nxënësit duhet të thonë “sipër” nëse nuk pyesin nëse kukulla po lëviz lart apo poshtë. Pastaj lëvize kukullën poshtë sërish. Përdorni kukullën për të treguar vendndodhje të ndryshme: lart, poshtë, para, prapa, anash. Pastaj përdorni kukullën për të treguar rrotullimin. Tregoni një rrotullim të plotë (360° derisa kukulla të kthehet në


vendin që ishte). Pastaj tregoni një gjysmë rrotullim (180° në mënyrë që fytyra e kukullës të mbetet në anën e kundërt).

 Dërgoji nxënësit tek disa shkallë dhe vendosi të renditen në radhë me nga dhjetë. Pyesni se cili është i pari dhe cili i fundit në secilin rresht. Përdorni një nxënës nga secili grup për të shpjeguar vendndodhjen e secilit nxënës. Kërkoju të përsërisin vendndodhjen e tyre teksa ju shpjegoni. Pastaj kërkoji klasës të thotë vendndodhjen bashkarish. Përforconi fjalorin duke u dhënë grupeve të ndryshme udhëzime duke përdorur gjuhën rendore. Për shembull, nxënësi i parë në secilin rresht të shkojë dhe të qëndrojë në shkallën e tretë. Ndoshta preferoni edhe t'u jepni mundësi nxënësve të japin ata udhëzime. Përsëriteni këtë derisa të jeni të kënaqur se nxënësit i dinë fjalët dhe mund t'i interpretojnë saktë.

 Vendosi nxënësi të punojnë në grupe me nga pesë për të bërë letra me vendndodhje: 1 – i, 2 – i, 3 – i, 4 – i, deri tek i 10 – i. Nxirrini grupet jashtë dhe bëni gara nga më të ndryshmet si për shembull, ecje mbrapsht, zvarritje, rrotullime anash, etj. Në fund të secilës garë lëri nxënësit t'i japin vetes vendndodhjen sipas rezultatit. Diskutoni vendndodhjen relative të secilit vend, për shembull, vendndodhja e tretë është ndërmjet të dytës dhe të katërtës, vendi i tretë është pas vendit të dytës dhe para vendit të katërtës, etj.

 Palos më dysh një copë letër dhe më pas më dysh sërish për të bërë një këndë të drejtë. Tregoni një këndë të drejtë dhe shpjegoji klasës se keni bërë një kënd katrori. Tregoju se ju mund të përdorni këndin tuaj për të provuar se cilët objekte në klasë kanë këndë të drejtë. Vendosni këndin katrorë në këndin e dritares. Pyetini nëse dritarja ka një kënd që është i së njëjtës formë. Hapni një libër dhe formoni një kënd më të vogël se këndi i ngushtë. Pyesni nëse ky është një kënd i drejtë. Thirrni një nxënës të mbajë librin me këndin e formuar teksa ju e provoni me këndin katrorë që krijuat. Pastaj thuaji ta hapë librin derisa këndet të përputhen. Këtë mund ta bëni edhe duke përdorur dy shirita të një kartoni të bashkuar me një kapëse ose me një tel.

Ushtrime me Librin e nxënësit

 Faqja 27 trajton rrotullimet e plota dhe gjysmë rrotullimet. Jepu nxënësve shumë praktikë duke demonstruar gjysmë rrotullimet dhe rrotullimet e plota me trupin e tyre, me kukulla, letra të prera, etj. Ata duhet të kuptojnë se një gjysmë rrotullim ndryshon drejtimin tonë: nëse jemi me fytyrë përpara, përfundojmë me fytyrë nga prapa, ose e anasjella. Një rrotullim i plotë na kthen me fytyrë ashtu siç ishim më parë. Lëri ta plotësojnë faqen në çifte pastaj kontrollo ushtrimet me ta.



Faqja 28 u jep nxënësve më shumë ushtrime praktike për drejtimin. Sërish, ata mund të punojnë në çifte. Për secilën figurë në libër duhet të diskutojnë se çfarë duhet të bëjë miu që të marrë djathin. Kini parasysh se disa çifte mund të japin zgjidhje të ndryshme. Pranoji të gjitha përgjigjet për aq sa shpjegimet e nxënësve kanë kuptim.



Nxënësit mund të punojnë me faqen 29 pasi të jenë familjarizuar me identifikimin e këndeve të drejtë.



Faqja 30 u jep nxënësve më shumë praktikë në përdorimin e termave përpara dhe prapa. Le të punojnë me këtë faqe ose në çift ose individualisht.



Faqja 31 merret sërish më vendndodhjen, por kërkon nga nxënësit të përdorin numrat rreshtorë Plotësoni disa prej ushtrimeve praktike për të përforcuar numrat rreshtorë përpara se t'i vendosni të punojnë vetë me këtë faqe.

Pyetje vlerësimi

- Kukulla po lëviz lart apo poshtë?
- Vendoseni kukullën sipër karriges.
- Vendoseni kukullën poshtë tavolinës.
- Në cilën anë duhet të shkojë miu për të marrë djathin?
- Në cilën anë po qëndrojnë përballë?
- Nëse bëj një rrotullim të plotë, në cilën anë do të jem përballë?
- Nëse bëj një gjysmë rrotullimi, në cilën anë do të jem me fytyrë?
- Kush është i pari në rresht?
- Kush është i fundit?
- Kush është i $2 - i$, $3 - i$, $4 - i$, etj.

NJËSITË STANDARDE TË GJATËSISË, MASËS DHE VËLLIMIT

Libri faqe 32 – 35

Elementi matematikor: Forma, hapësira dhe masat

Temat matematikore: Masat

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Nxënësi krahason dy ose më shumë gjatësi, masa ose vëllime me krahasim të drejtpërdrejtë; krahason dhe mat objektet duke përdorur njësitë standarde dhe jostandarde.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Në këtë kapitull nxënësit do të njihen me metrat dhe centimetrat si njësi formale të matjes së gjatësi. Ata do të llogarisin dhe verifikojnë gjatësinë duke përdorë një metër ose një vizore 30cm, dhe të po ashtu të masin dhe vizatojnë viza me gjatësi të caktuar në centimetra. Në fund do të masin me saktësi distancat duke përdorur metrin dhe centimetrin.

Koncepti i peshës është zgjeruar nga njësitë jostandarde tek njësitë standarde (kilogram i plotë dhe gjysmë kilogrami).

Koncepti i vëllimit është shtrirë në atë pikë që nxënësit të përdorin mjete matëse për të përcaktuar vëllimin e enëve të ndryshme. Në fillim nxënësit do të masin vëllimin në gota, më pas në litra.

Shumë prej përmbajtjes së këtij kapitulli është praktike.

Fjalor


Gjatësia, gjerësia, lartësia, hapësira, hapi, gjatësia e krahut, metri, centimetri, pesha, kilogram, gjysmë kilogrami, vëllimi, litri, gjysmë litër, plot, bosh.


Mjetet


Metër, shirit 10cm, vizore (15cm, 30cm); diçka për ta përdorur si njësi matëse jostandarde; peshore kuzhine e kalibruar në kilogramë; artikuj ushqimorë për t'u peshuar; grupe peshash duke përfshirë 50gr, 100gr, 200gr; rërë; bizele, peshore tualetesh, shirit matës për të matur lartësinë; enë të ndryshme si shishe të shënuara me vëllimin e tyre në litra; enë si gota pa vëllim të shënuar; tas; ujë ose rërë për t'u zbratur.


Ide për mësimdhënien


Ushtrime praktike


 Tregoju nxënësve një metër. Mbaje lart tek tabela dhe pyeti nëse tabela është më shumë apo më pak se një metër (me gjasë më shumë se një metër). Bëni të njëjtën gjë me objekte të tjera në klasë; tavolina, libra, postera, krahët dhe këmbët e nxënësve, dritaret, etj. Secilën herë nxënësit duhet ta llogarisin gjatësinë në metër: më shumë, më pak ose afërsisht një metër.


 Nxënësit duhet të përdorin njësi jostandarde (për shembull një kapëse letrash, ose një shkumës) për të llogaritur gjatësinë e artikujve të ndryshëm në klasë: një laps, një gomë, një ngjyruer, një libër, etj. Shkruani disa shembuj në tabelë për të ilustruar diversitetin e madhësisë dhe përdoreni këtë për të shpjeguar nevojën për njësi standarde matjeje.


 Shpjego që një metër përbëhet nga centimetra. Nxënësit nuk kanë punuar ende me numra deri në 100, prandaj përdorni një shirit me 10cm dhe tregoju se 10 si kjo bëjnë një metër. Kërkoju të kontrollojnë gjatësinë e një centimetri me gishtat e tyre: është pothuajse sa pjesa e fundit e gishtit të tyre. Pastaj kërkoju të llogarisin gjatësitë e objekteve në klasë me centimetra.


 Nxënësit mund të vizatojnë shumëkëndësha dhe pastaj të masin secilin nga brinjët me centimetra.


 Nxënësit mund të përdorin një shirit letre dhe një vizore për të bërë një shirit 2m të gjatë, të kalibruar në centimetër që mund të përdoret për të matur gjatësinë e nxënësve.


 Tregoni peshoren dhe shpjegoni se si matjet bëhen duke vendosur zeron në një pikë dhe duke lexuar peshoren në pikën tjetër. Nëse përdorni vizore të blera, udhëzoni nxënësit të injorojnë shkallët ndërmjet centimetrave për momentin. Të gjitha matjet duhet të merren tek centimetri më i afërt.


 Vizatoni viza të ndryshme në tabelë. Në fillim, lëroni nxënësit të llogarisin gjatësitë e tyre dhe më pas t'i kontrollojnë ato. Këtë ushtrim mund ta zgjeroni duke u kërkuar nxënësve të llogarisin dhe masin gjatësitë e objekteve në klasë.


 Tregoju nxënësve një pako një kilogramësh me oriz dhe kërkoju të marrin në dorë një artikull tjetër dhe ta krahasojnë nëse kanë një peshë të përafërt apo jo. Pyesni nxënësit se si mund ta provojmë këtë. Thekso se kur masim një gjatësi, përdorim metrin si njësi standarde. Kur masin peshën, përdorim kilogramin. Shkruani në tabelë fjalën kilogram. Pyesni nxënësit nëse e kanë parë këtë fjalë më parë, nëse po, ku. Ata mund të kenë dëgjuar kilogramë për artikujt ushqimorë dhe disa fëmijë duhet të jenë familjarë sepse janë peshuar vetë duke përdorur kilogramët si njësi standarde. Kalojeni nëpër klasë pakon 1 kilogramësh të orizit dhe lëroni nxënësit të zbulojnë se sa i rëndë është një kilogram.


 Vendosi nxënësit të bëjnë pesha 1/2kg dhe 1kg duke përdorur çantat e rërës dhe një peshore kuzhine.


 Nxënësit mund të bëjnë një balancë të thjeshtë duke lidhur çantat në secilin cep të varëses së rrobave. Balanca me varëse nuk duhet të takojë në objekte që të jetë e lirë të krijojë balancën.

 Nxënësit mund të zbulojnë se sa gramë ka një kilogramë duke përdorur një balancë të thjeshtë, 1 çantë 1 kg me rërë dhe pesha të ndryshme me gramë.


 Vendosi nxënësit të masin peshën e tyre duke përdorur një peshore tualeti dhe gjatësinë e tyre. Shënoni rezultatet në një tabelë për të gjithë klasën. Pyesni nxënësit nëse shohin ndonjë model tek rezultatet. Duhet të jetë e qartë se pesha rritet ndërsa gjatësia rritet. Bëni kujdes që nxënësit që janë jashtëzakonisht të gjatë, të shkurtër, të shëndoshë apo të dobët, të mos ndjehen të turpëruar.


 Për të paraqitur punën me vëllimin, kërkoju nxënësve të shikojnë tek emërtesat e enëve në shtëpi dhe të dallojnë përmendjen e litrit në ndonjë vend. Ata mund të raportojnë të nesërmen në klasë.


 Vendosi nxënësit të llogarisin dhe gjejnë vëllimet e enëve të ndryshme duke e mbushur një enë me ujë ose rërë duke përdorur një enë një litroshe të shënuar me shenja gjysmë litër dhe një litër.

 Përdorni gotat për të demonstruar sa gota bëjnë një litër.

Ushtrime me Librin e nxënësit

 Faqja 32 përforcon punën praktike që keni bërë me metrat duke u dhënë nxënësve mundësinë të llogarisin dhe masin artikujt me metra. Është e rëndësishme të kuptojnë se po llogarisin gjatësitë e objekteve të jetës reale.

 Përpara se të punoni me faqen 34, plotësoni ushtrimet praktike me kilogramët. Nxënësit duhet të krahasojnë peshën e artikujve të ndryshëm ushqimorë.

 Punoni me ushtrimet praktike duke paraqitur litrat dhe gotat para se të punoni me ushtrimet në faqen 35.

Pyetje vlerësimi

- Sa i gjatë është ky? Më shumë se një metër? Më pak se një metër?
- Gjej në klasë pesë objekte që janë më të shkurtër se një metër.
- Gjej pesë objekte në klasë që janë më të gjatë se një metër.
- Sa centimetër i gjatë është libri juaj?
- Vizato një vijë 9cm të gjatë.
- Sa centimetër janë të barabartë me 1m dhe 20cm?
- Çfarë peshon afërsisht një kg?
- Çfarë peshon më shumë se një kg?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Disa nxënës mund ta kenë të vështirë ta kuptojnë se sa centimetër bëjnë një metër. Në këtë fazë, Për të paraqitur punën me vëllimin, kërkoju nxënësve të shikojnë

tek emërtesat e enëve në shtëpi dhe të dallojnë përmendjen e litrit në ndonjë vend. Ata mund të raportojnë të nesërmen në klasë.

Vendosi nxënësit të llogarisin dhe gjejnë vëllimet e enëve të ndryshme duke e mbushur njërën me ujë ose rërë duke përdorur një enë një litroshe të shënuar me shenja gjysmë litër dhe një litër.

Përdorni gotat për të demonstruar sa gota bëjnë një litër

Ushtrime me Librin e nxënësit

Faqja 32 përforcon punën praktike që keni bërë me metrat duke u dhënë nxënësve mundësinë të llogarisin dhe masin artikujt me metra. Është e rëndësishme të kuptojnë se po llogarisin gjatësitë e objekteve të jetës reale.

Përpara se të punoni me faqen 34, plotësoni ushtrimet praktike me kilogramët. Nxënësit duhet të krahasojnë peshën e artikujve të ndryshëm ushqimorë.

Punoni me ushtrimet praktike duke paraqitur litrat dhe gotat para se të punoni me ushtrimet në faqen 35.

Pyetje vlerësimi

- Sa i gjatë është ky? Më shumë se një metër? Më pak se një metër?
- Gjej në klasë pesë objekte që janë më të shkurtër se një metër.
- Gjejë pesë objekte në klasë që janë më të gjatë se një metër.
- Sa centimetër i gjatë është libri juaj?
- Vizato një vijë 9cm të gjatë.
- Sa centimetër janë të barabartë me 1m dhe 20cm?
- Çfarë peshon afërsisht një kg?
- Çfarë peshon më shumë se një kg?

Gabime dhe keqkuptime të zakonshme

Disa nxënës mund ta kenë të vështirë ta kuptojnë se sa centimetër bëjnë një metër. Në këtë fazë, Nxënësit mund të shohin njësi matëse nga më të ndryshmet të përdorura në emërtesat e enëve. Mos u përpiqni t'ua shpjegoni në këtë fazë sepse do t'i ngatërroi.

KOHA

Libri faqe 36 – 39

Elementi matematikor: Forma, hapësira dhe masat

Temat matematikore: Masat

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Të kuptojmë dhe përdorim fjalorin e lidhur me kohën; të radhisim ngjarjet e njohura në kohë; të dimë ditët e javës dhe stinët e vitit; të lexojmë kohën me gjysmë ore ose orë të plota në orët analoge.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Koha është një masë. Gjithsesi është e vështirë për fëmijët e vegjël ta kapin këtë dhe ta shprehin me fjalë, sepse është koncept abstrakt. Nxënësit mund të kenë përvojë me kohën sepse lidhet me rutinën e tyre të ditës dhe ndoshta mund të dinë disa fjalë që lidhen me ditën dhe natën. Disa mund të kenë të zhvilluar konceptet se sa kohë merr diçka për t'u bërë dhe disa jo. Koncepti i kohëzgjatjes është i rëndësishëm. Radhitja e ngjarjeve në kohë kërkon që nxënësit të përdorin fjalorin përpara, pas, më herët, më vonë.

Nxënësit duhet të kuptojnë që disa ushtrime kërkojnë më shumë kohë se të tjerët. Mund të bëni shumë ushtrime që i mundësojnë ata të bëjnë krahasime të drejtpërdrejta dhe të thonë se cili do më shumë kohë e cili më pak.

Një metodë e matjes së kohëzgjatjes është dita. Përderisa nxënësit ndonjëherë i ngatërrojnë ditët e javës i kemi përsëritur këtu.

Fjalor

Mëngjes, pasdite, mbrëmje, ditë, natë, përpara, tani, gjatë, më pas, në fillim, pastaj, kohë e gjatë, kohë e shkurtër, javë, ditë, E hënë, e martë, e mërkurë, e enjte, e premte, e shtunë, e diel, sot, nesër, dje.

Mjetet

Orë analoge me akrepa të lëvizshëm; kalendar.

Ide për mësimdhënie

Ushtrime praktike

Shihni ushtrimet e mësipërme mbi kohën (faqja 48 e këtij libri)

Ushtrime me Librin e nxënësit



Faqja 36 u jep nxënësve mundësinë të rendisin aktivitetet në kohë. Mund të bëni diskutim në klasë mbi këtë faqe.



Është e rëndësishme që nxënësit të kenë një kuptim mbi orën si njësi për kohën. Ata kanë bërë ushtrime duke matur gjatësinë duke llogaritur më shumë se/më pak se 1 m, për masën duke peshuar artikujt më shumë se/më pak se 1kg. Në këtë ushtrim përdorin një parim të ngjashëm. Diferenca është gjithësesi se nuk mund ta ndjeni dhe shihni një orë në të njëjtën mënyrë që mund të shihni një metër apo ta prekni një kilogram.



Faqja 38 kombinon punën me kohën me punën me të dhënat teksa nxënësit fillojnë të punojnë me kohën të plotësuar në një orar.



Faqja 39 kombinon punën me fjalorin e lidhur me kohën. Përdorni një kalendar të madh për t'i kujtuar nxënësit për emrat e muajve dhe radhën në të cilin ndodhin.

Pyetje vlerësimi

- Çfarë bëni para se të vini në shkollë në mëngjes?
- Çfarë bëni pasi shkoni në shtëpi pasdite?
- Çfarë bëni para se të hani?
- Çfarë bëni në orën 8 të mëngjesit? Çfarë bëni në orën 10 të mëngjesit?
- Sa është ora kur akrepi i madh shënjon 12 dhe akrepi i vogël shënjon 3.
- Cili muaj është ndërmjet qershorit dhe gushtit?

ZGJIDHJA E PROBLEMAVE DHE LLOGARITJET

Fletore Pune 40 – 45

Elementi matematikor: Numri

Temat matematikore: Zgjidhja e problemave dhe enigmave

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Zgjidhni metoda llogaritëse të arsyeshme, mendore dhe me shkrim, për të zgjidhur problema me numra natyror; zgjidhni problema të thjeshtë ose enigma dhe parashikoni modele dhe marrëdhënie të thjeshta; studioni një pohim të përgjithshëm mbi një numër ose figurë të njohur duke gjetur shembuj që i përshtaten; shpjegoni me gojë metodat e arsytimit.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Ky kapitull nuk trajton njohuri të reja. Gjithsesi, nxënësit përdorin njohuritë llogaritëse që i kanë për të eksploruar marrëdhëniet ndërmjet numrave dhe shumave në mënyra të ndryshme. Për shembull, ata mësojnë se si ta bëjnë një veprim në të kundërt (zbritjen për ta kthyer në të kundërt mbledhjen dhe e anasjella).

Fjalor

e kundërt, veprim, numëro para, ndalo numërimin, shuma, ndryshesa.

Mjetet

Skema për të lidhur pikat; kuti vezësh dhe fara; monedha; grumbuj gurësh për secilin grup; bosht numerik.

Ide për mësimdhënien

Ushtrime praktike



Luani me klasën lojën e bashkimit të pikave. Krijoni modele të thjeshtë që kërkojnë nga nxënësit të bashkojnë numrat në 2 ose në 3, etj.



Jepi secilit grup një kuti vezësh me 12 nënndarje dhe një grumbull me bërthama. Udhëzohuni të numërojnë deri në 20 bërthama. Pastaj kërkoju të bëjnë grupe me nga 2, duke i vendosur dy në secilën gotë. Diskutoni se sa grupe mund të bëni. Sa kanë mbetur. Përsëriteni këtë për të gjithë numrat deri në 10.



Nxirreni klasën jashtë. Vendosni një numër në rrathët për të luajtur në tokë. Udhëzoni nxënësit se do të hidhen në rreth për të bërë një grup numrash që do t'ua thoni ju. Përcaktoni një numër fillestar. Thoni një numër, për shembull tre. Nxënësit pastaj nxitojnë për të formuar një grup me tre. Diskutoni se sa grupe janë bërë dhe sa nxënës kanë mbetur.



Jepi secilit grup nga një grumbull me gurë. Bëni një garë për të parë se sa shpejt mund të sistemohen në grupe sipas numrit që u keni dhënë ju.



Vizatoni në rërë një bosht të madh numerik. Kërkoni që nxënësit të kërcejnë tek numri që ju do të thërrisni. Sa është kërcimi më i madh që mund të bëjnë.

Ushtrime me Librin e nxënësit



Faqja 42 u kërkon nxënësve të hulumtojnë marrëdhënien ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes. Secili shirit përfaqëson një numër të përbërë nga dy numra më të vegjël, për shembull një shirit i përbërë nga 1 bllok me një ngjyrë dhe tre blloqe me ngjyrë tjetër. Nxënësit eksplorojnë se si të përdorin këto numra

për të bërë dy barazime me zbritje dhe dy barazime me mbledhje. Theksoni marrëdhënien ndërmjet dy shumave: nëse hiqni 1 nga 4, sa mbeten? Sa duhet të shtoni për t'u kthyer sërish tek 4?



Faqja 43 është vijim i ushtrimit të mëparshëm. Këtë herë, në vend vetëm të emërtimit të dy mënyrave për të formuluar secilin barazim me mbledhje, nxënësit duhet të vlerësojnë se cili mund të zgjidhet më shpejt. Parimi është se është më e lehtë të numërosh një numër më të vogël vendesh, prandaj ata duhet përgjithësisht të zgjedhin barazimin ku numri më i madh është i pari.



Faqja 44 përforcon punën me mbledhjen dhe me zbritjen në situata të jetës reale. Ndhmoni nxënësit për të lexuar problemat nëse është e nevojshme, por lejoni t'i plotësojnë ushtrimet në mënyrë të pavarur.



Faqja 45 kërkon nga nxënësit të testojnë rregullat matematikore. Inkurajojini të provojnë shembuj që testojnë secilin rregull të dhënë në kolonën e majtë.

Pyetje vlerësimi

- Numëroni me nga dy në boshtin numerik.
- Sa është dyfishi i 5? Dyfishi i 7?
- Sa është gjysma e 10? Gjysma e 12?
- Me sa duhet ta mblidhni 5 për të bërë 7?
- Shihni këto dy shuma. Cili është më i lehtë të mblidhet? Përse?

TË DHËNAT

Libri i nxënësit faqe 46 – 47

Elementi matematikor : Organizimi dhe përdorimi i të dhënave

Temat matematikore: Informacioni në tabela

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave: Nxënësi zgjedh problema të rëndësishme duke përdorur lista të thjeshta, tabela, objekte apo figura për t'u klasifikuar; shpjegon metodat dhe arsyetimin.

Zhvillimi i konceptit dhe njohurive

Në këto faqe, nxënësit punojnë me të dhënat të paraqitur në tabela të thjeshta. Ata mësojnë për të lexuar dhe interpretuar informacionin në tabela dhe gjithashtu për të mbledhur të dhëna dhe për t'i paraqitur duke përdorur tabela të thjeshta.

Në jetën e përditshme, ne përdorim simbole për të shmangur përshkrimet e gjata dhe për ta bërë më të lehtë krahasimin e gjërave, ne përdorim po ashtu tabela për të paraqitur informacionin në mënyra që e bëjnë atë të thjeshtë.

Ushtrimet në këtë fazë kërkojnë nga nxënësit të lexojnë informacionin e paraqitur në një tabelë dhe për të marrë eksperiencë që të organizojnë të dhënat në kategori të ndryshme.

Fjalor

Paraqitja, të dhënat, tabela

Mjetet

Tabela e ditës së preferuar; tabela me forma piktografike për secilin nxënës.

Ide për mësimdhënie

Ushtrime praktike

Përsërisni konceptin e përdorimit të tabelave duke përdorur tabelën e ditëve të preferuara të javës. Bëni pyetje të tilla si: “Cilën ditë preferojnë më shumë nxënësit?” “Cilën ditë preferojnë më pak nxënësit?” “Sa nxënës preferojnë të hënë?” “Sa nxënës preferojnë më shumë të martën se sa të mërkurën?”

Bëni një paraqitje horizontale në tabelë. Shkruani germet e alfabetit në një rresht horizontal përbri kokës së tabelës. Kërkoju nxënësve të ngrënë duart dhe të thonë se me çfarë germe fillon emri i tyre. Vizato një figurë poshtë germave për të përfaqësuar secilin nxënës. Bëjeni këtë në mënyrë sistematike për shembull thuaj, ‘të gjitha ata që u fillon emri me A të ngrënë duart lart.’ Ndërsa vizatoni secilin nxënës lërinë të ulen sërish. Përdorni fjalët tabelë dhe informacion në kontekst për të përforcuar kuptimin e tyre. Pyesni fëmijët për tabelën.

Përsërisni këtë lloj ushtrimi me tabela me figura të ndryshme horizontale dhe vertikale derisa të jeni të kënaqur me aftësinë e fëmijëve për të lexuar dhe kuptuar të dyja llojet e tabelave. Përsërisni përdorimin e fjalëve «rresht», «kolonë». Diskutoni vetitë e tabelave teksa i vizatoni – sigurohuni që nxënësit e kuptojnë se figurat janë të së njëjtës madhësi, që janë të baraslarguara dhe se boshti është i emërtuar.

Bëni një tabelë të përhershme për motin. Mund të duket si kjo më poshtë:

Ditët e javës	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E diel
Sot është							

Lërimi nxënësit të plotësojnë një tabelë me piktograme duke përdorur format në vend të të dhënave. Jepi secilit grup një grup figurash dhe tabelën e mëposhtme:
Emri:

1. Vizatoni figurat në kolonën e duhur për të bërë një tabelë figurash

Rreth							
Katror							
Drejtëndësh							
Trekëndësh							

2. Përgjigjuni këtyre pyetjeve për tabelën tuaj:

- Sa rrethë janë?
- Cila nga figurat është më e pakta?
- Cila figurë është më e shumta?
- Sa janë më shumë katrorë se sa drejtëndësha?
- Sa figura janë aty gjithsej?

Kërkoju nxënësve të vizatojnë një tabelë figurash që tregon përmbajtjen e sirtarit të enëve në shtëpi. Lërimi të bëjnë pyetje mbi tabelat e tyre dhe t'i shkëmbejnë me një shok për t'u përgjigjur pyetjeve të njëri-tjetrit. Përdorni tabelën e mëposhtme si shembull:

Thika	
Pirunë	
Lugë	
Lugë çaji	

Vijoni me ushtrime praktike deri sa të siguroheni që nxënësit janë në gjendje të lexojnë dhe interpretojnë tabelat, po ashtu të mbledhin dhe klasifikojnë të dhënat e tyre dhe t'i paraqesin grafikisht. Ka tema nga më të ndryshmet: ngjyra të preferuara, fruta, këngë, programe televizioni, lloje këpucësh, kosha mbeturinash në pjesë të ndryshme të shkollës, kushtet atmosferike në ditë të ndryshme, etj.

Ushtrime me Librin e nxënësit

Për faqe 46 dhe 47, lexoni udhëzimet në klasë dhe sigurohuni që nxënësit e kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë përpara se t'i lejon të punojnë me ushtrimet.

Pyetje vlerësimi

Secila nga pyetjet e sugjeruara për ushtrimet praktike të mësipërm mund të përshtatet për tabelat për të vlerësuar se sa mirë i kuptojnë nxënësit.

Matematika 1

Libër mësuësi

Përshtatur nga: Zenepe Shkoza
Diana Starja

Çmimi 500 lekë